RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Mbi
"Auditimin Financiar"

BASHKIA GRAMSH

Tiranë 2022

PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 4

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit 5

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve 5

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit 8

II. HYRJA 10

1. Objektivat e auditimit 10

2. Qëllimi i auditimit 10

3. Identifikimi i çështjes 10

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese 11

5. Përgjegjësitë e audituesve 11

6. Kriteret e vlerësimit 11

7. Standardet e auditimit 12

8. Metodologjia e auditimit 12

9. Dokumentimi i auditimit 13

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT 14

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin 14

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit 15

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm 15

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021. 22

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2020. 45

2.4 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme 61

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME 76

V. ANEKSET 85

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar me objektiv veprimtarinë ekonomike dhe financiare të Bashkisë Gramsh për aktivitetin ekonomik dhe financiar të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Rregulloren e procedurave të auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Gramsh si planifikimi, hartimi dhe realizimi i buxheteve; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore; auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore; mbajtjen e evidencës kontabël, etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Njësia e Auditit të Brendshëm nuk mbulon me auditim të gjitha fushat/sistemet e njësisë publike duke mos i dhënë prioritet fushave/sistemeve të përzgjedhura, sipas nivelit të riskut;
- Mos realizim në treguesit e buxhetit, veçanërisht për sa i përket të ardhurave vendore, mos realizim i cili ka krijuar detyrime të pa likuiduara të prapambetura ndaj të tretëve, duke paraqitur një risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore. Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2021 janë në vlerën **32,995,914 lekë**;
- 22 qiramarrës nuk kanë zbatuar kushtet e kontratave të qirasë duke mos paguar detyrimin për vitin 2021 në vlerën totale prej **7,911,120 lekë** që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh;
- Të ardhurat e munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh nga detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që taksapaguesit kanë deri më 31.12.2021 janë në vlerën **54,085,792 lekë**;
- Në Bashkinë Gramsh ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizim/licencë për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë 2 subjekte, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën **2,000,000 lekë**;
- Janë 4 operatorë ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj bashkisë për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën **203,500 lekë**;
- Të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV deri më 31.12.2021 janë në vlerën totale **3,551,600 lekë**;
- Përveç objekteve të inventarit të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 919,245,713 lekë (vlerë e kontabilizuar), ka objekte të njësive administrative të cilat nuk janë pajisur me titull pronësie dhe nuk janë kontabilizuar, konkretisht për llog 210 ñToka troje terreneò, llog. 211 ñPyje plantacioneò, llog. 212 ñNdërtesa e konstruksioneò;
- Në gjendjen e llog. 468 ñDebitorë të ndryshëmò nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën totale **60,366,677 lekë**.

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Gramsh, KLSH ka dhënë ñ*Opinion të kundërt*ò për pasqyrat financiare.

Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative dhe rekomandime për arkëtimin e të ardhurave të munguara.

1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi mbuloi çështjet kryesore të veprimtarisë së Bashkisë Gramsh si: menaxhimi financiar dhe kontrolli, auditi i brendshëm, planifikimi dhe zbatimi i buxhetit, të ardhurat, vlerësimi i pasqyrave financiare dhe zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm. Për analizimin dhe vlerësimin e aktivitetit të subjektit sipas pikave të planifikuara në programin e auditimit, grupi i auditimit vlerësoi sistemet e kontrollit të brendshëm dhe analizoi të gjitha evidencat e grumbulluara gjatë kryerjes së auditimit në terren sipas çështjeve përkatëse.

Në përfundim të punës audituese në terren, grupi i auditimit ka mbajtur dhe protokolluar në Bashkinë Gramsh 5 akt konstatime. Mbi akt konstatimet e mbajtura nga grupi i auditimit si dhe mbi projekt raportin e auditimit janë paraqitur observacione nga Bashkia Gramsh të cilat janë trajtuar në përputhjeve me përcaktimet e Rregullores së procedurave të auditimit të KLSH.

Subjekti nuk ka kërkuar organizim të takimit përmbyllës në KLSH.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Rekomandimi
1	Njësia e Auditit të Brendshëm nuk mbulon me auditim të gjitha fushat/sistemet e njësisë publike duke mos i dhënë prioritet fushave/sistemeve të përzgjedhura, sipas nivelit të riskut, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëmò *(faqe 15-22 të RPA)*	E lartë	Njësia e Auditit të Brendshëm të hartojë program pune për auditimin e fushave më me risk në veprimtarinë e institucionit.
2	Nga auditimi u konstatua mos realizim në treguesit e buxhetit, veçanërisht për sa i përket të ardhurave vendore, mos realizim i cili ka krijuar detyrime të pa likuiduara të prapambetura ndaj të tretave, duke paraqitur një risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore. Detyrimet për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2021 janë në vlerën totale 32,995,914 lekë. Veprime në kundërshtim me UMFE nr. 4 datë 25.01.2021 ñPër buxhetin e vitit 2021ò, pikat 115-125 ñDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò. *(faqe 22-45 të RPA)*	E lartë	Bashkia Gramsh, Drejtoria e Financës, të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, një material mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën **32,995,914 lekë**, të analizojë situatën dhe të ndërpresë krijimin e detyrimeve të prapambetura duke nxjerrë përgjegjësitë e të marrë masa për të mos patur angazhime të reja buxhetore pa fonde në dispozicion.
3	Nga auditimi mbi krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë Gramsh u konstatua se, janë dhënë me qira asete për të cilat nuk janë lidhur kontratat përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Përkatësisht, janë 8 subjekte/qytetarë që përdorin pasuri të bashkisë pa lidhur një kontratë qiraje, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar. *(faqe 22-45 të RPA)*	E lartë	Sektori Juridik dhe i Aseteve të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet/personat që kanë në përdorim objekte/prona/sipërfaqe në pronësi të Bashkisë Gramsh.
4	Në gjendjen e llog. 468 ñDebitorë të ndryshëmò nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa në vlerë totale 60,366,677 lekë të akumuluara në fund të vitit ushtrimor 2021, vlerë e cila nuk është kontabilizuar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018	E lartë	Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog. 468 ñdebitorë të ndryshëmò, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të

	òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22. *(faqe 45-61 të RPA)*		mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.
5	Nga auditimi ka rezultuar se, përveç objekteve të inventarit të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 919,245,713 lekë (vlerë e kontabilizuar), ka objekte të njësive administrative të cilat nuk janë pajisur me titull pronësie dhe nuk janë kontabilizuar, konkretisht për llog 210 ñToka troje terreneò, llog. 211 ñPyje plantacioneò, llog. 212 ñNdërtesa e konstruksioneò. Për rrjedhojë ka rezultuar se pasuritë e paluajtshme nuk janë kontabilizuar në aktivet afatgjata materiale, me qenë se nuk janë pajisur me një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor), në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015 ñPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorialò, Kreu VI ñTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeò. *(faqe 45-61 të RPA)*	E lartë	Bashkia Gramsh duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
6	Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezulton se, 22 qiramarrës nuk kanë zbatuar kushtet e kontratave të qirasë duke mos paguar detyrimin për vitin 2021 në vlerën totale prej **7,911,120 lekë** që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kushteve të kontratave të qirasë përkatësisht me nenin 3 ñPagesa dhe regjimi i sajò. *(faqe 22-45 të RPA)*	E lartë	Sektori Juridik dhe i Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masat dhe të ndjekin të gjitha hapat ligjorë që 22 qiramarrësit që nuk kanë zbatuar kushtet e kontratës së qirasë të paguajë detyrimet përkatëse secili që në vlerën totale janë **7,911,120 lekë.** Gjithashtu, në vijimësi Sektori Juridik dhe i Aseteve të ndjekë me përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit.
7	Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Gramsh në datën 31.12.2021 janë në vlerën **54,085,792 lekë** nga të cilat vlera prej 18,951,699 lekë i përket 62 subjekteve private, vlera prej 15,794,072 lekë i përket kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe vlera prej 19,339,941 lekë është detyrimi për taksën e tokës bujqësore, duke sjellë **të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë Gramsh. Në vitin 2021, borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale **16,363,890** lekë. Rezulton se, Bashkia Gramsh nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(faqe 22-45 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Gramsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **54,085,792 lekë**, *si më poshtë vijon*: *a-T'u dërgohen bankave* të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare. *b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit,* kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme). *c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar,* Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar. *d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas

			marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal. e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
8	Në Bashkinë Gramsh ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizim/licencë për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë 2 subjekte, përkatësisht subjekti ñG...ò dhe subjekti ñB...ò, në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20-Autorizimet pika 2, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 2,000,000 lekë.** *(faqe 22-45 të RPA)*	E lartë	Drejtoria e Shërbimeve dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa që subjektet ñG...ò dhe ñB...ò, që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë secili ndaj Bashkisë Gramsh.
9	Në Bashkinë Gramsh janë 4 operatorë ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj bashkisë për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 203,500 lekë**. Drejtoria Juridike nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre sipas përcaktimeve të paketës fiskale. Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik është në kundërshtim me përcaktimet e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në republikën e shqipërisëò, i ndryshuar, neni 43 pika 1/1, Udhëzimit të MF nr. 24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 40.1, 43.1.1 dhe VKB nr. 96 datë 30.12.2019 ñPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò në Bashkinë Gramsh. *(faqe 22-45 të RPA)*	E lartë	Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.
10	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Gramsh për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka vendosur 10 masa administrative ñ*Dënim me gjobë*ò, me vlerë totale 3,500,000 lekë. Për gjobat e vendosura në vitin 2021, janë paguar në mënyrë vullnetare 3 gjoba në vlerën totale 600,000 lekë, janë në proces gjyqësor 3 gjoba në vlerën 2,000,000 lekë dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e 4 gjobave në vlerën 900,000 lekë. Rezulton se, për vitin 2021 **të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë **në vlerën totale 2,900,000 lekë.** Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2021 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, janë në proces gjyqësor 4 gjoba me vlerë 610,000 lekë dhe për një gjobë është nënshkruar marrëveshje dhe ende mbetet për tû likuiduar vlera 41,600 lekë. Pra, gjoba të vendosura para vitit 2021 në proces gjyqësor dhe me marrëveshje të pa arkëtuara në total janë në **vlerën 651,600 lekë**. **Të ardhurat e munguara** nga	E lartë	Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **3,551,600 lekë**.

	mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV në progresiv janë **në vlerën totale 3,551,600 lekë.** *(faqe 22-45 të RPA)*		

3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

Opinion mbi pasqyrat financiare për vitin 2021:

Ne kemi qenë të angazhuar për të audituar pasqyrat financiare (PF) të Bashkisë Gramsh, për vitin 2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe paraqitjen e tyre në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

ñ*Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të kundërt për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Gramsh, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale dhe të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021, të shprehura në bazën për opinion".*

Baza për opinionin e kundërt:

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit (kap III/2.2) ku jepen përshkrimi i çështjeve për opinionin e kundërt për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga subjekti i audituar, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidencat e auditimit që kemi siguruar, janë të e mjaftueshme dhe të përshtatshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe bazë për dhënien e opinionit tonë të kundërt (ISA-700/ISSAI-1700).

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021 është **24,184,429** lekë.

Përshkrimi i çështjeve:

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

- Në gjendjen e llog. 468 ñDebitorë të ndryshëmò nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore familjare në vlerën 15,794,072 lekë, për taksa dhe tarifa e bizneseve në vlerën 18,951,699 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 108,300 lekë, taksat e tokës bujqësore në vlerën 19,339,941 lekë, subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizim/ licencë të lëshuar në vlerën 2,000,000 lekë, mos pagesa të kontratave të qirave në vlerën 1,422,665 lekë (nga diferenca midis vitit 2020 në vlerën 6,488,455 lekë (vlerë e kontabilizuar) dhe vitit 2021 progresive 7,911,120 lekë), nga operatorët ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj bashkisë Gramsh për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki në vlerën 2,750,000 lekë në total 60,366,677 lekë të akumuluara në fund të vitit ushtrimor 2021, vlerë e cila nuk është kontabilizuar.
- Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 26

ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò, gjendje kjo e nën vlerësuar me 178,620,750 lekë.
- Nga auditimi ka rezultuar se, përveç objekteve të inventarit të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 919,245,713 lekë (vlerë e kontabilizuar), ka objekte të njësive administrative të cilat nuk janë pajisur me titull pronësie dhe nuk janë kontabilizuar, konkretisht për llog. 210 ñToka troje terreneò, llog. 211 ñPyje plantacioneò, llog. 212 ñNdërtesa e konstruksioneò. Për rrjedhojë ka rezultuar se pasuritë e paluajtshme nuk janë kontabilizuar në aktivet afatgjata materiale, me qenë se nuk janë pajisur me një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor).
- Për vitin 2021 njësia nuk dispononte një regjistër analitik aktivesh sipas formatit. Nuk është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të Titullarit për ngritjen e komisionit ñPër kryerjen e procesit të inventarizimitò. Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e titullarit nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues të institucionit.

Përgjegjësia e Drejtuesve të Bashkisë Gramsh

Strukturat drejtuese të Bashkisë Gramsh, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit të raportimit financiar në fuqi, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues, është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSh-së

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH-së, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 376/1 Prot, datë 08.04.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 11.04.2022 deri në datën 13.05.2022, në subjektin Bashkia Gramsh u krye ñAuditimi Financiarò për periudhën 01.01.2021 ï 31.12.2021. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

1. E. V. ï *Përgjegjëse Grupi*
2. A. Gj. ï *Anëtar*
3. E. M. ï *Anëtare*

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar në Bashkinë Gramsh kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[1];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare mbi bazën e nivelit të materialitetit dhe vlerësimit të risqeve, si dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI;
- Hartimi i Raportit të Auditimit dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes, mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve, të cilat mbështeten mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Gramsh është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim 01.01.2021-31.12.2021, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Gramsh dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

Pika 1. Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

Pika 2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

Pika 3. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2021.

Pika 4. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

[1] Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Gramsh, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Gramsh është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Gramsh. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò;
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar;
- Ligji Nr. 137/2020, datë 16.11.2020 ñPër buxhetin e vitit 2020ò;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 ñPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendoreò;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò;
- Udhëzimi MFE nr. 2 datë 20.01.2020 ñPër zbatimin e Buxhetit të vitit 2020ò;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 ñPër nëpunësit zbatues të të gjitha niveleveò;
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò;
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, i ndryshuar;

- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeòetj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Gramsh grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 ñParimet themelore të auditimit të sektorit publikñ;
- ISSAI 200 ñParimet themelore të auditimit financiarò.
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar";
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për tõu nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Gramsh me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[2].

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për tâu audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon[3].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*; dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

[2] ISSAI 1315

[3] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Auditimi në subjektin ñBashkia Gramshò, u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tô u audituar.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve e kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, auditimeve të realizuara nga Njësia e Auditimit të Brendshëm, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave.

Bashkia Gramsh është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendoreò dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes Vendoreò.

Profili i Bashkisë Gramsh

Bashkia Gramsh kufizohet në veri me Bashkinë Elbasan, në lindje me Bashkinë Pogradec, në jug-lindje me Bashkinë Maliq, në jug me Bashkinë Skrapar dhe në perëndim me Bashkitë Berat, Kuçovë dhe Cërrik. Kryeqendra e bashkisë është qyteti i Gramshit. Sipas Censusit të vitit 2011, bashkia numëron 24,231 banorë, ndërsa sipas Regjistrit Civil ajo numëron një popullsi prej 36.305 banorësh dhe densitet 49.11 banorë për km². Bashkia ka një sipërfaqe prej 739.22 km². Bashkia Gramsh përbëhet nga 10 njësi administrative, Gramsh, Pishaj, Kodovjat, Kukur, Kushovë, Lenie, Poroçan, Skënderbegas, Sult, Tunjë dhe ka nën administrimin e saj një qytet dhe 94 fshatra. Bashkia e Gramshit shtrihet në një territor shumë malor në Shqipërinë qendrore, ku toka bujqësore është e paktë (rreth 14% e sipërfaqes) ndërsa pjesa tjetër e territorit është zonë pyjore ose kullotë. Qendra e bashkisë, Gramshi, u shpall qytet në vitin 1960 si një qendër e agro-industrisë dhe e industrisë ushtarake. Mundësitë për turizëm natyror në Gramsh janë të shumta, si Ujëvara e Sotirës, Uji i Ftohtë më malin e Lenies, Liqeni i Dushkut, Pishat e Grabovës, liqenet në malin e Rovjës, Shpellat në malin e Poroçanit, Kalaja e Tunjës etj.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm

Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK-s,
1. Mjedisi i kontrollit
1.1 Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues
Bashkia Gramsh funksionon në përputhje me ligjin nr. 152/ 2013, ñPër nëpunësin civilò i ndryshuar dhe Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Gramsh.
- Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Gramsh për vitin 2021, është miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 129, datë 30.08.2021.
Bashkia Gramsh e ka miratuar, me nr. 689/3, datë 18.02.2020, në zbatim të Ligjit nr. 9131 datë 08.09.2003 ñPër Rregullat e Etikës në Administratën Publikeò, Ligjin nr. 10296, Kreu III, neni 20 ñMjedisi i kontrollitò, pika 2/a dhe në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, të hartuar dhe miratuar nga Ministria e Financës, Kap II, pika 2.5.1 ñMjedisi i Kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë)ò.
1.2 Politika menaxheriale dhe stili i punës
Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës.
Në këto raste të ndryshimeve të emërtimeve të drejtuesve sipas strukturës Organizative, dorëzimi i detyrës si dhe marrja e saj nga persona të tjerë, nuk është bërë me akte dorëzimi dhe inventarizim përkatës, në kundërshtim me kërkesat e *VKM nr. 124, datë 17.02.2016 "Për pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil" Kreu III, pika 27 dhe VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "Për transferimin e përkohshëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil", Kreu VII, pika 49, 52, 52.*
Në Bashkinë Gramsh për vitin 2021, struktura e miratuar përbëhet nga 361 punonjës ndërsa në fakt janë 351 punonjës, 10 pozicione janë vakante deri më datë 31.12.2021. Gjatë vitit janë emëruar 81 punonjës dhe janë larguar 53 punonjës.

Për vitin 2021, numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Gramsh së bashku me njësitë e varësisë, është gjithsej 361 punonjës, nga të cilët në pozicione pune trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 ñPër nëpunësin Civilò, janë 50 punonjës dhe 311 punonjës janë me kontratë pune sipas ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 ñKodi i punës i Republikës Shqipërisëò i ndryshuar me të cilët janë lidhur kontrata pune tip.
1.3 Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit
Struktura organizative e Bashkisë Gramsh dhe njësive në varësi për vitin 2021 është miratuar me Vendimin nr. 24, datë 11.02.2021 dhe ka në përbërje të saj 361 punonjës.
Në strukturën organizative për vitet objekt auditimi është përcaktuar pozicioni i punës së *Përgjegjësit të zyrës së Burimeve Njerëzore*, ky pozicion rezulton të jetë vakant përkohësisht në fund të vitit 2021, muajin dhjetor duke qenë se punonjësja është me leje lindje.
1.4 Aftësitë profesionale të punonjësve

- Emërimet janë kryer në zbatim të Ligjit 152/2013 ñPër nëpunësin civilò, i ndryshuar, nenet 22 dhe 25, si dhe Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, ñPër pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutiveò, kreu II, III dhe VII.
- Nuk është hartuar ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò, për periudhën e auditimit, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.
- Burimet Njerëzore kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit. Në vitin 2021 kanë kryer trajnime 18 punonjës të bashkisë.
- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- Nuk ka plan- veprime vjetore për arritjen e objektivave, qëllimeve të politikave afatmesme (PBA) që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

2. Menaxhimi i riskut

Në këtë proces identifikohen situatat e mundshme që mund të kenë efekt të dëmshëm në veprimtarinë e institucionit, të cilat mund të jenë risqe të brendshme apo të jashtme. Bashkia Gramsh e ka përgatitur po nuk ka miratuar ñStrategjinë e Riskutò për vitin 2021, e cila duhet të përditësohet rregullisht (çdo 3 vite), në zbatim të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të MFK- së dhe koordinatorit të riskut në njësitë publikeò, pikën 5.3. Është ngritur GMS (Grupi menaxhimit strategjik) dhe është vendosur koordinatori i riskut, kjo detyrë i është deleguar Koordinator i Riskut A. Sh. me Urdhër nr. 142, datë 03.06.2021, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò, nenit 11, ñPërgjegjshmëria menaxheriale e menaxherëve të tjerë të njësisëò, pika 2, në Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, kapitulli III, pika 2.5.2 ñMenaxhimi i Riskutò, si dhe nenit 10 të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010. Grupit të auditimit ju vunë në dispozicion shkresat **për caktimin e Nëpunësit të Autorizuar dhe Nëpunësit Zbatues**, të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nëpunësi i Autorizuar (NA) dhe Nëpunësi Zbatues (NZ)

Nëpunës Autorizues (NA) **K. T.**	*Autorizimi për kryerjen e detyrave:* Konfirmimi NA nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar, për dijeni të Degës së Thesarit Gramsh dt. 14.08.2019, me nr. 14875/1 Prot.
Nëpunës Zbatues (NZ) **A. Sh.**	*Autorizimi për kryerjen e detyrave:* Konfirmimi NZ nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorisë së Menaxhimit dhe Harmonizimit Financiar, për dijeni të Degës së Thesarit Gramsh dt. 28.10.2019, me nr. 18867/1 Prot.

Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, në kundërshtim me ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò neni 27, me Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publikeò pika 2/2,4.

3. Aktivitetet e kontrollit

Referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, politikat dhe procedurat që vendosen, si parandaluese apo zbuluese në adresimin e risqeve sjellin arritjen e objektivave të institucionit. Bashkia Gramsh ka miratuar në strukturën e saj Auditin e Brendshëm, me 3 punonjës. Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në kundërshtim

me ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 13. Si rrjedhojë, nuk ka takime të dokumentuara midis Komitetit të Auditimit dhe drejtuesve të NJAB-së, në kundërshtim me kërkesat ligjore të cilat kanë si detyrim mbledhjen minimalisht 4 herë në vit. Ky institucion ka qenë pjesë e programit të auditit të jashtëm, si pasojë e saj ka patur mbikëqyrje nga ana e titullarit për zbatime të rekomandimeve mbi fushën e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

4. Informimi dhe komunikimi

Bashkia Gramsh disponon faqen e saj zyrtare në web, ku pasqyrohet aktiviteti i saj. Komunikimi realizohet elektronikisht, verbalisht dhe në formë shkresore. Me subjektet komunikimi kryhet nëpërmjet telefonit, postës zyrtare apo elektronike. Punonjësit komunikojnë nëpërmjet email-eve personale duke qenë se nuk funksionon email-i zyrtar.

Titullari informohet nga drejtuesit e programeve nëpërmjet mbledhjeve, raporteve dhe relacioneve të ndryshme. Në Bashkinë Gramsh punonjësit punojnë vetëm me Word dhe Excel. Punonjësit komunikojnë drejtpërdrejtë me eprorët sipas shkallës hierarkike për probleme apo parregullsi, në rrugë elektronike. Lista e njësive të vartësisë dhe shoqërive, ndërmarrjet që janë në pronësi ose me pjesëmarrje në kapital (p.sh. Sh.A.-të) nuk është publikuar në faqen e internetit si link.

5. Monitorimi

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñ*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*ò, duke u bazuar edhe në UMF nr. 28, datë 15.12.2011 ñ*Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm një njësitë publike", p*ër vitin 2021, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik. Një formë e monitorimit është deklarata e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Deklaratat i janë dorëzuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi funksionimin e sistemit të kontrollit për vitin 2021 në datën 28.02.2022 me nr. 917/2 Prot.: ñDeklaratë për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Gramshò raport mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në Bashkinë Gramshò, Pyetësor dhe Plan i veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

<u>Titulli i gjetjes 1:</u> *Zbatim jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit.*

<u>Situata:</u> Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

Mjedisi i kontrollit: Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës.

- Nuk është hartuar ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA.
- Burimet Njerëzore kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit. Në vitin 2021 kanë kryer trajnime 18 punonjës të bashkisë.
- Nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-s në fushën e Menaxhimit të Riskut.
- Në lidhje me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollit nuk janë kryer trajnime për Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS- n).
- Nuk ka plan- veprime vjetore për arritjen e objektivave, qëllimeve të politikave afatmesme (PBA) që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Menaxhimi i riskut: Bashkia Gramsh e ka përgatitur po nuk ka miratuar ñStrategjinë e Riskutò për vitin 2021. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin

Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò neni 27, me Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publikeò pika 2/2,4.
Aktivet e kontrollit: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 13 dhe si rrjedhojë, nuk ka takime të dokumentuara midis Komitetit të Auditimit dhe drejtuesve të NJAB-së.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, i ndryshuar; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Ndikimi: Zbatimi jo i plotë i kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, ka sjellë mungesë të kontrollit të brendshëm. Mos ndjekja e trajnimeve cenon cilësinë e zhvillimit profesional të punonjësve.
Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor për MFK-në
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Gramsh të merren masa për të rritur njohuritë mbi Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit si dhe për zbatimin e të gjithë komponentëve të saj. Burimet njerëzore të kenë një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve dhe një data bazë me emrat e punonjësve, të ngrihen komisione nga titullari mbi inventarizimin e dosjeve në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë, të miratohet Strategjia e Riskut për vitin 2021, të zhvillohen mbledhje të dokumentuara të GMS-së dhe të ngrihet Komiteti i Auditimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, z. K. T., Kryetar i Bashkisë Gramsh, nëpunës autorizues dhe z. A. Sh., Drejtor i Financës, nëpunës zbatues.

Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm
Nga auditimi i kryer mbi funksionimin e NJAB të Bashkisë Gramsh, rezultoi se :
- Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, ñPër miratimin e kritereve për ngritjen e NJAB në sektorin publikò, Bashkia Gramsh e ka të ngritur Njësinë e Auditit të Brendshëm. Njësia e Auditit të Brendshëm është ngritur në përputhje me ligjin. Struktura organizative e bashkisë është miratuar me vendim të titullarit, nr. 24, dt. 11.02.2021, ku pjesë e strukturës është NJAB e përbërë nga tre punonjës, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publik.ò. Njësia e Auditimit të Brendshëm funksionon në përputhje me Vendimin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 24, datë 11.02.2021, ñPër miratimin e strukturës organizative dhe nivelin e pagave të punonjësve për vitin 2021ò dhe ñRregullores së Funksionimit të Brendshëm të Administratës së Bashkisë Gramshò. Përcaktimi i detyrave dhe kompetencave të NJAB për përgjegjësin dhe specialistin janë përshkruar në rregullore.

Struktura organizative e Drejtorisë Auditimit paraqitet si më poshtë:

Nr.	AUDITUESI	Arsimimi/ Niveli i Diplomës	Vjetërsi pune	Vitet e punës në Auditin e Brendshëm	Trajnime	Certifikatë audituesi

Viti 2021	**1**	L. P. (Përgjegjës sektori)	Ekonomik (Master Shkencor)	35 vite	9 vite e 9 muaj	Po	Po, 2017
	2	S.M. (Inspektore)	Ekonomik (Master Profesional)	7 vite	2 vite e 3 muaj	Po	Po, 2021
	3	J. M. (Inspektor)	Ekonomik (Master Profesional)	2 vite	1 vit	Po	Jo

Në vitin 2021 kjo strukturë organizative përbëhet nga 3 punonjës: 1 (një) Përgjegjës sektori dhe 2 (dy) Specialist. Përgjegjës sektori znj. L. P. dhe specialisti znj. S. M., të certifikuar, në zbatim të Ligjit nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikñ, Nenit 11, Punësimi i audituesit të brendshëm, pika 2ç.

Bazuar në Manualin e Auditit të Brendshëm, planifikimi i nevojave të stafit për trajnim për vitin 2021 është planifikuar dhe identifikuar për 2 punonjës të NJAB, janë përcaktuar temat e interesuara dhe mundësitë e tyre për ndjekje.

- Komiteti i Auditit të Brendshëm: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 13 ñKomitetit të Auditimit të Brendshëmò *i cili përcakton se: "Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*

a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;

b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;

c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;

ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;

d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;

dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.

2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.

3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

- Konstatohet mungesa e dokumentimit dhe protokollimit të **raportimeve periodike menaxhimit të lartë dhe bordit** mbi qëllimin, autoritetin, përgjegjësinë dhe rezultatet e aktivitetit të Auditit Brendshëm e cila përcaktohet në Standardet 2060 të auditimit.

- Kodi i Etikës

Referuar Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò Njësia e Auditit të Brendshëm e ka hartuar dhe miratuar ñKodin e Etikësò në Bashkinë Gramsh.

- Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik

Referuar Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò ka hartuar dhe miratuar më nr. 790 Prot., datë 26.02.2021 ñKartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò në Bashkinë Gramsh.

Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

- Planet Strategjike dhe Vjetore:

Plani Strategjik i veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm për periudhën 2021- 2023, 2022- 2024, dhe Plani Vjetor i Auditimit për vitin 2021 janë miratuar dhe i janë nisur Ministrisë së Financave me nr. 3706/1 Prot., datë 15.10.2020 dhe me nr. 3392/2 Prot., datë 13.10.2021. Raporti i veprimtarisë së Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 i është nisur Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, më datë 10.02.2022, nr. 125/2 Prot., i miratuar nga titullari dhe firmosur nga drejtuesja e Njësisë së Auditit të Brendshëm.

- Realizimi i Planeve Vjetore:

Për vitin 2021 janë parashikuar gjithsej 8 (tetë) auditime dhe janë realizuar Realizimi i auditimeve për vitin 2021 është kryer në masën 87.5 %. Dëmi ekonomik i konstatuar nga Njësia e Auditit të Brendshëm llogaritet në vlerën 0 lekë për vitin 2021.

Realizimi paraqitet në tabelën e mëposhtme :

Institucioni	**Auditimet e vitit 2021**			**Llojet e auditimit Të planifikuara/ Të realizuara**	**Dëmi ekonomik i shkaktuar (000 lekë)**
	Angazhime të planifikuara	**Angazhime të realizuara**	**Niveli i riskut**		
Drejt. e të ardhurave, Detyrimet e prapambetura	1	1	I lartë	Financiare/ Të përputhshmërisë	-
Sek. Emergjencave Civile	1	1	I mesëm	Të kombinuara/ Të kombinuara	-
Njësi Administrative Kukur	1	1	I mesëm	Të kombinuara/ Të kombinuara	-
Njësi Administrative Kushove	1	1	I mesëm	Të kombinuara/ Të kombinuara	-
Njësi Administrative Lenie	1	1	I mesëm	Të kombinuara/ Të përputhshmërisë	-
Pallati i Kulturës	1	1	I mesëm	Performancë/ Performancë	-
MNZSH- ja (Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi)	1	1	I lartë	Të kombinuara/ Të kombinuara	-
Drejtoria e Infrastrukturës Rrugore	1		I lartë	Të kombinuara	-
Gjithsej	**8**	**7**			**-**

Bazuar në Urdhrin nr. 338, datë 01.12.2020, dhe programit të angazhimit të auditimit me nr. 4613/2, datë 02.12.2020 auditimi mbi Drejt. e të ardhurave, Detyrimet e prapambetura duhet të ishte mbyllur brenda vitit 2020. Projekt- raporti me nr. 4613/3 Prot., në datën 06.01.2021 dhe Raporti me nr. 4613/4 Prot, në datën 08.02.2021.

NJAB nuk mbulon me auditim të gjitha fushat/ sistemet e njësisë publike duke mos i dhënë prioritet fushave/ sistemeve të përzgjedhura, sipas nivelit të riskut, duke mos zbatuar Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëmò, Strategjinë së auditimit të brendshëm, bazuar në tre klasifikimet e mëposhtme, duhet të konsiderojë një frekuencë auditimi si vijon:
i - Fusha me risk të lartë ï e kështillueshme një herë në vit;
ii - Fusha me risk të mesëm ï e kështillueshme një herë në dy- tre vite;
iii - Fusha me risk të ulët ï e kështillueshme jo më shumë se pesë vite.

Pasqyra e praktikave të realizuara në vitet 2021

Subjekti i audituar	**Periudha e audituar**	**Afati i auditimit**	**Grupi i auditimit**	**Shënime**
Drejt. e të ardhurave, Detyrimet e prapambetura	01.01.2020-30.09.2020	02.12.2020-31.12.2020	L. P.	Përfunduar
Sek. Emergjencave Civile	01.01.2020-31.12.2020	18.05.2021-18.06.2021	L. P. J. M. S. M.	Përfunduar
Njësi Administrative Kukur	01.01.2020-30.07.2021	16.08.2021-20.09.2021	L. P.	Përfunduar
Njësi Administrative Kushove	01.01.2020-30.06.2021	01.07.2021-01.08.2021	J. M.	Përfunduar
Njësi Administrative Lenie	01.01.2020-31.08.2021	27.09.2021-27.10.2021	S. M.	Përfunduar
MNZH- ja	01.01.2020-31.12.2020	05.04.2021-07.05.2021	L. P.	Përfunduar
Pallati i Kulturës	01.01.2020-30.09.2021	08.11.2021-08.12.2021	J. M.	Përfunduar

Grupi i auditimit ka konstatuar se Drejtori i Auditit, pranë Bashkisë Gramsh edhe pse është emëruar në pozicionin drejtor, është njëkohësisht edhe auditues duke qenë se është pjesë e programeve të angazhimeve të auditimit.

- Rekomandimet

Raporti vjetor i Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm i është nisur Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me nr. 1144 Prot., datë 17.03.2022, në zbatim të nenit 24, të Ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò dhe Udhëzimit nr. 42, datë 27.10.2020 ñPër ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publikò.
Një nga drejtimet e auditimit në angazhimet e kryera është ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm nga kjo NJAB dhe nëse janë realizuar misione auditimi apo evidentime nga punonjësi i zbatimit rekomandimeve për subjektet e audituara. Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm ka ndjekur dhe vijon të ndjek ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm. Rekomandimet e dhëna janë pranuar 100 % nga

subjektet e audituara. Kjo drejtori ka lënë për për periudhën e auditimit 36 rekomandime nga të cilat 21 prej tyre janë zbatuar dhe 15 prej tyre janë në proces zbatimi.

Subjekti i audituar	Rekomandime të lëna	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime në proces
Drejt. e të ardhurave, Detyrimet e prapambetura	3	2	1
Sek. Emergjencave Civile	5	4	1
Njësi Administrative Kukur	7	3	4
Njësi Administrative Kushove	4	3	1
Njësi Administrative Lenie	6	2	4
MNZH- ja	7	5	2
Pallati i Kulturës	4	2	2
Totali	**36**	**21**	**15**

Titulli i gjetjes 2: *Mos mbulim me auditim i fushave më me rrisk në veprimtarinë e institucionit nga Njësia e Auditit të Brendshëm.*
Situata: NJAB nuk mbulon me auditim të gjitha fushat/ sistemet e njësisë publike duke mos i dhënë prioritet fushave/ sistemeve të përzgjedhura, sipas nivelit të riskut, duke mos zbatuar Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëmò, Strategjinë së auditimit të brendshëm, bazuar në tre klasifikimet e mëposhtme, duhet të konsiderojë një frekuencë auditimi si vijon:
i - Fusha me risk të lartë ï e këshillueshme një herë në vit;
ii - Fusha me risk të mesëm ï e këshillueshme një herë në dy- tre vite;
iii - Fusha me risk të ulët ï e këshillueshme jo më shumë se pesë vite.
Kriteri: Manuali i Auditit të Brendshëm të miratuar me urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò,
Ndikimi: Mungesa e mbulimit me auditim i fushave më me risk nga NJAB sjell mos përmirësim të performancës së institucionit dhe mos identifikim të parregullsive.
Shkaku: Mos ngritje të Njësisë së Auditit të Brendshëm
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm të hartojë program pune për auditimin e fushave më me risk në veprimtarinë e institucionit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, z. K. T., Kryetar i Bashkisë Gramsh dhe znj. L. P., Përgjegjëse sektori AB.

2.2 Mbi planifikimin dhe zbatimin e PBA-së dhe buxhetit vjetor për vitin 2021.

Programi buxhetor afatmesëm
-Nga Kryetari i Bashkisë Gramsh janë ngritur urdhrat e GMS (Grupit të Menaxhimit Strategjik) dhe urdhrat e EMP (Ekipet e Menaxhimit të Programeve).
-Janë miratuar hapat për përgatitjen e kalendarit të PBA-ve 2022-2024 dhe në vijim të kalendarit është proceduar për hartimin e programi buxhetor afatmesëm për njësitë shpenzuese.
-Pas miratimit të kalendarëve për hartimin e dokumenteve të PBA-së, Kryetari i Bashkisë ka dërguar në Këshillin Bashkiak, për miratim projekt-vendimet e hartuara nga GMS, për tavanet buxhetore sipas programeve.

-Pas daljes së udhëzimit për hartimin e PBA-së nga MFE, Kryetari i Bashkisë ka miratuar udhëzimin e brendshëm për PBA-të 2022-2024.

PBA 2022-2024: Me vendim nr. 53, datë 30.04.2021 janë miratuar tavanet e programeve buxhetore afatmesëm për periudhat (2022-2024), ndërsa struktura buxhetore në (16) programe buxhetimi.

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2022-2024 janë përcaktuar ñPërshkrimi i çdo programiò; ñPolitikat e programitò; ñQëllimi Politikës së programitò; ñObjektivat e politikës së programitò.

PBA	Urdhëratë GMS		Urdhëratë EMP		VKB			Nr.	
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Objekti	Nr.	Datë	Programe	shënime
2020-2022	99	11.04.2021	98	11.04.2021	miratim kalendari	-	-	16	
					miratim tavaneve të shpenzimeve	53	30.04.2021	16	në afat
					miratimi i tabelave të PBA	94	29.06.2021	16	në afat

Burimi: Drejtoria e Financës

Buxheti i vitit 2021(në planifikim)

Për hartimin e buxhetit të vitit 2021 është ndjekur baza ligjore përkatëse si dhe udhëzimi plotësues UMF nr. 4 datë 25.01.2021 ñPër përgatitjen e buxhetit vendor 2021ò.

Është ngritur urdhri për dëgjesa publike, programi i punës për të 9 (nëntë) njësitë administrative të Bashkisë Gramsh, dhe janë mbajtur proces-verbalet përkatëse për secilën njësi, duke qenë si vit me pandemi(2020), nga drejtoria e financë/buxhet, është hartuar pyetësor për dëgjesa publike.

Janë miratuar VKB përkatëse për miratimin e buxhetit 2021 dhe ndryshimet gjatë vitit ushtrimorë 2021 si në tabelën më poshtë:

Për vitin 2021, buxheti Bashkisë Gramsh është miratuar me VKB nr. 80, datë 28.12.2020 ñMbi miratimin e buxhetit vjetor 2021 të Bashkisë Gramshò dhe është konfirmuar nga institucioni i Prefektit me shkresën nr. 19/1, datë 13.01.2021.

000/lekë

Nr.	***Vendimi K.B***		***P ë r sh k r i m i***	***Të ardhura***	***Struktura shpenzimeve***	***Shpenzimet***
	Nr.	***Datë***				
	80	**VKB buxhet 28.12.2020**	**Miratim buxheti**	**674,565**	**Miratim buxheti**	**674,565**
		Ndryshimet buxhet				
1	23	30.03.2021	Prog. të ardhura	130,746	Art. 600 Paga	212,715
	55	31.05.2021	Te ardhura sponsorizim	7.152		
2	60	30.06.2021	Të ardhura te trashëguara	35,301	Art. 601 Sig. shoqërore	36,704
3	91	30.09.2021	Transferta e Pakushtëzuar	235,758	Art. 602 Shpenz. Operative	140,029
4	102	24.11.2021	Transferta e pakushtëzuar e trashëguar	7,258	Art. 230-231 Investime	266,616
5			Transferta specifike	237,360	Fondi Rezervë+Kontigj (609)	18,501
6			Transferta specifike e trashëguar	20,890	Art 231 kap 06 teknologji	

Burimi: Drejtoria e Financës

Miratimi i buxhetit nga njësia vendore për vitin 2021 është miratuar brenda afateve ligjore kjo në përputhje me ligjin nr. 68/2017 ñPër Financat e Qeverisjes Vendoreò neni 41, pika 1 dhe 3, ñ *Kryetari i njësisë të vetëqeverisjes vendore paraqet për miratim në Këshill projektbuxhetin vjetor. Jo më vonë se data 30 nëntor e vitit buxhetor. Këshilli i qeverisjes vendore jo më vonë se data 25 dhjetor miraton projektbuxhetin vendor, në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor*ò.

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2021 janë bërë si më poshtë:
-Vendim Këshilli nr. 98, datë 31.08.2021.
Në hartimin e dokumentit të buxhetit vjetor, është bërë programimi i shpenzimeve, të detajuara sipas secilit program në vlerë dhe % (*të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë për buxhetet 2021):*

000/lekë

	Shpenzimet të detajuara sipas programeve	Viti 2021	
		Vlera	%
1	Programi 1 (01110)	243,661	36.12
2	Programi 2 (03140)	4,075	0.6
3	Programi 3 (03280)	21,113	3.13
4	Programi 4 (04220)	1,620	0.24
5	Programi 5 (04240)	12,344	1.83
6	Programi 6 (04260)	17,206	2.55
7	Programi 7 (04520)	140,008	20.75
8	Programi 8 (05100)	25.676	3.81
9	Programi 9 (06260)	34,046	5.05
10	Programi 10 (06440)	6,800	1
11	Programi 11 (07220)	4,000	0.6
12	Programi 12 (08130)	11,872	1.76
13	Programi 13 (08220)	9,546	1.42
14	Programi 14 (09120)	120,172	17.82
15	Programi 15 (09230)	12,497	1.85
16	Programi 16 (10910)	9,929	1.47
	TOTALI	**674,565**	100.00

Burimi: Drejtoria e Financës

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.
Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për periudhën raportuese viti 2021 të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë:
-Ndarja e shpenzimeve sipas natyrës për periudhën raportuese ushtrimore viti (2021) në vlerë e % me të dhënat paraqiten të pasqyruara sa më poshtë:

në/000 lekë

Nr.	***Shpenzimet sipas ndarjes ekonomike***	***Viti 2021***	
		Vlera	***%***
1	Llog.(600) funk.deleguara	7,622	1.22
2	Llog.(601) funk.deleguara	937	0.15
3	Llog.(602) funk.deleguara	216	0.03
4	Llog.(604)Rindërtimi	10,567	1.68
5	Llog.(606) bonus strehimi, dhperblim lindje	2,346	0.37

6	Llog.(606) ndihma ekonomike	466,535	74.38
7	Investime të tjera	138,984	22.16
	TOTALI	**627,208**	100.00

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për periudhën janarï dhjetor 2021.

Për vitin 2021; Shpenzimet buxhetore të planifikuara në vlerë 1,301,773 mijë lekë, janë realizuar në vlerë 1,157,734 mijë lekë në masën 89%, ndërsa të detajuar sipas artikujve është:

-pagat në masën 96%; kontributet për sigurimet në masën 92%; shpenzimet operative në masën 89%, investimet në masën 66% dhe investime të deleguara në masën 97%.

në/000 lekë

Nr.	***E M E R T I M I***	***Viti 2021***		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	***Fakti progresiv viti 2021***	%
1	Llog.(600)-Paga	212,715	203,224	96%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Shënd	36,704	33,938	92%
3	Llog.(602)Shpenz.opera	140,029	124,722	89%
4	Llog.(230-231) Investime	266,616	174,815	66%
5	Llog.(604)	15,444	1,660	11%
6	Llog.(606)	2,683	2,652	99%
7	Llog.(609)	375	0	0%
8	Llog.(600) funk.deleguara	7,622	7,229	95%
9	Llog.(601) funk.deleguara	937	936	100%
10	Llog.(602) funk.deleguara	216	208	96%
11	Llog.(604) funk.deleguara	10,567	10,274	97%
12	Llog.(606) bonus strehimi	2,346	2,346	100%
13	Llog.(606) ndihmë e bursa pa	466,535	454,883	98%
14	Llog.(231) Investime	138,984	134,318	97%
15	Llog. 466 takse pulle	0	1,699	
16	Llog. 466 garanci obj. të dala	0	4,830	100%
	Totali	**1,301,773**	**1,157,734**	89%

Burimi: Drejtoria e Financës

Sipas burimeve të financimit paraqiten:

-Nga transferta e pakushtëzuar dhe transfertat specifike: treguesit e buxhetit janë të planifikuar;

- Për vitin 2021 në vlerën 531,376 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 470,299 mijë lekë, ose në masë 89%, të dhënat si më poshtë:

Viti 2021 *000/lekë*

Nr.	***Artikulli***	***Plan***	***Fakt***	***Diferenca***	
				%	***Në vlerë***
1	600	212,715	203,224	96%	9,491
2	601	36,704	33,938	92%	2,766
3	602	68,718	61,914	90%	6,804
4	604	4,214	0	0%	4,214
5	606	1058	1,027	97%	31
6	231	207,967	170,196	82%	37,771
	Totali	**531,376**	**470,299**	**95%**	**61,077**

Burimi: Drejtoria e Financës

-Të e dhënat mbi të ardhurat e planifikuara sipas buxhetit 2021 dhe të realizuara sipas akt-akordimeve vjetore me thesarin, duke përfshirë në fakt edhe të ardhurat e trashëguara rezultojnë:

000/lekë

Periudha	***Programimi, realizimi të Ardhurave***	***Diferenca***	***Planifikimi dhe përdorimi i të ardhurave në Buxhet***	**Diferenca**

	Plani	*Fakti*	*Vlerë*	*%*	*Plani fillimit Buxhetit përfshirë të trashëguara.*	*Fakti në thesar sipas realizimit përfshirë të trashëguara.*	**Vlerë**	**%**
Viti 2021	130,746	77,903	52,843	60%	130,746	70,712	60,034	54%

Përdorimi i të ardhurave sipas planifikimit në buxhetet respektive rezultojnë sa më poshtë:
- Për vitin 2021 në vlerën të planifikuara 130,746 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 70,712 mijë lekë, ose në masë 54%.

Viti 2021 *000/lekë*

Nr.	*Artikulli*	*Plan*	*Fakt*	*Diferenca*	
				%	*Në vlerë*
1	600	0	0	-	-
2	601	0	0	-	-
3	602	60,824	62808	103%	-1,984
4	604	15712	1660	11%	14,502
5	606+690	2000	1625	81%	375
6	231	52,210	4,619	9%	47,591
	Totali	**130,746**	**70,712**	**54%**	**60,0349**

Burimi: Drejtoria e Financës

Nga fondet e deleguara për vitin 2021 treguesit e buxhetit janë të planifikuar në vlerën 627,208 mijë lekë, ndërsa janë realizuar në vlerën 616,724 mijë lekë, ose në masë 98%, të dhënat si më poshtë:

Viti 2021

Nr.	*Artikulli*	*Plan*	*Fakt*	*Diferenca*	
				%	*Në vlerë*
1	Llog.(600) funk.deleguara	7,622	7,229	95%	393
2	Llog.(601) funk.deleguara	937	936	100%	1
3	Llog.(602) funk.deleguara	216	208	96%	8
4	Llog.(604) Rindërtimi	10,567	10,274	97%	293
5	Llog.(606) bonus strehimi, shperblim lindje	2,346	2,346	100%	0
6	Llog.(606) ndihma ekonomike	466,536	454,883	98%	11,653
7	Investime të tjera AKUM	138,984	134,318	97%	4,666
8	Llog 466 garanci obj të dala	0	6,530	-	-6530
	Totali	**627,208**	**616,724**	**98%**	**10,484**

Titulli i gjetjes 3: *Mbi përdorimin e fondit rezervë*
Situata: Referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak (VKB) nr. 80 datë 28.12.2020,ò*Për miratimin e programit buxhetor për vitin 2021*ò është planifikuar fondi rezervë në shumën 2,000,000 lekë. Nga auditimi rezultoi se ky fond është përdorur për ndihma dhe shpërblime ndaj qytetarëve të ndryshëm të Bashkisë Gramsh, të cilët kanë paraqitur kërkesa për ndihmë dhe mbështetje. Përkatësisht gjatë vitit 2021 Këshilli Bashkiak ka miratuar 32 vendime me objekt dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për probleme të ndryshme të cilat arrijnë vlerën totale **2,000,000 lekë**. Nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Gramsh janë likuiduar gjatë vitit 2021 gjithsej 29 vendime, të miratuara nga Këshilli Bashkiak Gramsh në vlerën totale **1,775,000 lekë**.
Sa më sipër, u audituan dosjet e të gjithë përfituesve nga fondi rezervë dhe rezultojë se:
- Nga 32 praktika, vetëm 2 praktika kanë relacione shpjeguese që justifikojnë marrjen e vendimit;

- Pothuajse në të gjitha praktikat nuk ka dokumentacion justifikues që të vërtetojë që kërkuesit e ndihmës janë në pamundësi ekonomike apo trajtohen me ndihmë ekonomike;
- Në 3 praktika dhënia e ndihmës është miratuar vetëm duke paraqitur një kërkesë dhe asnjë dokumentacion tjetër;
- Në 1 rast është dhënë ndihmë për një biznes privat i cili është dëmtuar nga zjarri pa patur aktin e ekspertimit të zjarrit.

Veprimet e mësipërme të marra nga KB Gramsh janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar neni 6 ñ*Fondi rezervë përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen ose janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Përdorimi i tij bëhet me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore*ò, ligjin nr. 137/2020 datë 16.11.2020 ñPër buxhetin e vitit 2021ò, Aneksi nr. 2 ñ*Kriteret e Shpërndarjes së Fondit Rezervë Nivelet e Pushtetit Vendor Kriteret: Për bashkitë kompensim për ndonjë gabim në përllogaritjen e kritereve të formulës së shpërndarjes së transfertës së pakushtëzuar për vitin 2021. Për funksionet e reja të transferuara në bashkitë që nga viti 2016. Për shpenzime të shërbimeve të shkaktuara nga Covid-19 Për nevoja të ndryshme financiare të bashkive",* Udhëzimin nr. 4 datë 25.01.2021 *"Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021",* pika 108 *"Fondi rezervë përdoret sipas kritereve të përcaktuara në Aneksin nr. 2 të ligjit nr. 137/2020 "Për buxhetin e vitit 2021". Njësitë e vetëqeverisjes vendore sipas kritereve të këtij aneksi i drejtohen Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë vlerëson kërkesën e tyre. Nëse fondi rezervë nuk përdoret brenda vitit 2021, ai trashëgohet si transfertë e pakushtëzuar për vitin 2022".*

Kriteri: Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar neni 6. Ligji nr. 137/2020 datë 16.11.2020 ñPër buxhetin e vitit 2021ò, Aneksi nr. 2. Udhëzimi nr. 4 datë 25.01.2021 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ò, pika 108.

Ndikimi: Përdorimi i fondit rezervë të bashkisë, jashtë kritereve, ka sjell një efekt negativ për buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjor nga ana e Bashkisë dhe e Këshillit Bashkiak në përdorimin e fondit rezervë.

Rekomandim 1: Kryetari i Bashkisë Gramsh nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masat që për çdo kërkesë të paraqitur për ndihmë dhe mbështetje financiare pranë bashkisë, të bëhen verifikimet e duhura dhe të plotësohet dokumentacioni që argumenton nevojën dhe pamundësinë financiare të qytetarëve përpara se dosja të dërgohet për miratim në Këshillin Bashkiak. Drejtoria e Financës të ndërpresë likuidimin e praktikave që nuk kanë dokumentacionin e plotë dhe të duhur, si dhe gjatë përdorimit të fondit rezervë të vlerësojë nevojën reale për përdorimin e tij me qëllim që të mos ketë efekte negative në buxhetin e bashkisë.

Rekomandim 2: Këshilli Bashkiak Gramsh të ndërpresë marrjen e vendimeve me efekte financiare në buxhetin e bashkisë në rastet kur kërkesa për ndihmë dhe mbështetje financiare nuk shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e duhur. Këshilli Bashkiak përpara marrjes së vendimeve për ndihmë dhe mbështetje financiare ndaj qytetarëve në nevojë, të shqyrtojë me korrektësi dokumentacionin e dosjeve dhe në rastet kur dokumentacioni nuk është i plotë dhe i besueshëm të kthejë praktikat në strukturat përkatëse të bashkisë për plotësim.

Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Nga Kryetari Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore në zbatim të detyrimeve ligjore për monitorimin e zbatimit të buxhetit janë bërë raportet periodike si vijon:
Në zbatim të kërkesave të nenit 44 ñRaporti vjetorò, të ligjit nr. 139/2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, ku kërkohet që ñ*Kryetari njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim te këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës*ò, nenit 54, të ligjit nr. 68/2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, si kërkesë ligjore e udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018 ñPër procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetë qeverisjes vendoreò.

Viti 2021

- Për vitin 2021 janë bërë 2 raporte të monitorimit të zbatimit buxhetit dhe respektivisht janë dërguar në këshillin bashkiak me shkresën nr. 1985/1 Prot., datë 31.05.2021, katër mujori i parë, me shkresën nr. 1985/1 Prot., datë 31.05.2021 dhe në MFE me shkresën nr. 2125 Prot., datë 31.05.2021, katër mujori i dytë, me shkresën nr. 1985/1 Prot., datë 31.05.2021 në këshillin bashkiak dhe në MFE me shkresën nr. 3732 Prot., datë 29.09.2021, ndërsa raporti tretë është në vazhdim pasi ka afat dorëzimi sipas udhëzimit nr. 22, brenda muajit shkurt të vitit pasardhës. Gjithashtu raportet 4 mujore i janë dërguar me shkresë zyrtare Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për zbatimin e buxhetit vjetor të vitit 2021 është hartuar raport monitorimi (analizë vjetore) nga titullari i njësisë vendore, si analizë vjetore për secilin vit dhe është dërguar për miratim në këshillin bashkiak.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vënë në dispozicion mbi plan buxhetin dhe detajimi e tyre në nivel Titull; Kapitull; Artikull; Nën/artikull u konstatua se, në të gjitha rastet është respektuar disiplina buxhetore të pasqyruara në Aneksin nr. 2.

Realizimi fondit të pagave, sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si edhe e numrit të punonjësve në plan dhe fakt për periudhën objekt i auditimit paraqiten me të dhënat si më poshtë:

Periudha	Paga (600)		Sigurime (601)		Numri i punonjësve	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plani	Fakti
Viti 2021	220,337	210,452	37,641	34,874	361	355

Burimi: Drejtoria e Financës

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve etj.

Për periudhën raportuese ushtrimore viti 2021:

Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Gramsh, objekt i procesit të auditimit sipas zërave në (shpenzime për investime, mallra e shërbime dhe vendime gjyqësore), në fund të periudhës në datë 31.12.2021 gjendja paraqitet në vlerën totale prej 32,995,914 lekë.

Bashkia Gramsh për vitin 2021 ka akt-rakordimi me degën e thesarit Gramsh për detyrimet e prapambetura.

Bazuar në listën analitike që administrohet nga sektori i financës vlera e detyrimeve të prapambetura për Bashkinë Gramsh në datën 31.12.2021 është 32,995,914 lekë, e cila sipas natyrës së detyrimit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

Nr.	Emërtimi i natyrës së detyrimit	Vlera e detyrimit më 31.12.2021
1	Detyrim për investime	21,665,536

2	Detyrim për vendimet gjyqësore	0
3	Detyrim për mallra dhe shërbime	11,330,378
	Total	**32,995,914**

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se detyrimet për investime zënë pjesën më të madhe të detyrimeve të prapambetura 66% të vlerës së detyrimeve totale. Këtu sqarojmë se në detyrimet e investimeve është përfshirë edhe investimi e kryera në periudhën dhjetor 2021, në vlerën 19,024,060 lekë.

Vlera detyrimeve për investime të prapambetura nga vitet e mëparshme është 2,641,474 lekë, dhe vlera totale e detyrimeve të mbartura nga vitet e kaluara është (32,995,914-19,024,060)=**13,971,854 lekë.**

Lista analitike e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2021, paraqitet në rubrikën e anekseve, anekset nr. 4, 5 dhe 6 bashkëlidhur.

Nga auditimi pasqyrave financiare të vitit 2021 konstatohet se vlera e llogarisë 520 ï Disponibilitete në thesar (e cila tregon fondet e pa shpenzuara gjatë vitit 2021, të cilat kalojnë për përdorim në vitin 2022), ka vlerën 94,038,064 lekë.

Tabela në vijim:

Subjekti	Vlera e kredisë (detyrimit) më 31.12.2021	Fondet e trashëguara në 31.12.2021për vitin 2022 (Llog. 520 në bilanc)	Diferenca fonde të trashëguara (Llog. 520 në bilanc) me vlerën e detyrimit në fund të vitit
Bashkia Gramsh	32,995,914	94,038,064	61,042,150

Burimi: Drejtoria Financës dhe Buxhetit Bashkia Gramsh

Nga auditimi konstatohet se fondet e trashëguara janë në vlerë shumë të lartë në krahasim me detyrimet.

Faturat e pa likuiduara

-Sipas të dhënave të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2021, konstatohet se vlera e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën **32,995,914** lekë dhe përbëhet nga vlera prej 4,500,000 lekë, detyrim për zbatimin e vendimeve gjyqësore, vlera prej 5,953,124 lekë detyrim për shërbime të ndryshme, vlera prej 19,901,314 lekë detyrime për investime, si dhe vlera prej 2,641,476 lekë investime detyrim nga FZHR.

Vlera **32,995,914 lekë** është e trashëguar sipas periudhave si në vijim:

-mbartur nga vitet 2010-2015, vlera 10,372,922 lekë,

-krijuar në vitet 2016-2018, vlera 2,139,549 lekë dhe vlera 2,641,476 lekë detyrim nga FZHR

-krijuar gjatë viti 2021, vlera 19,901,314 lekë.

Konstatohet se faturat e pa likuiduara brenda një viti buxhetor, edhe pse kanë qenë të mbuluara me vlerën e të ardhurave të trashëguara për vitin pasues buxhetor, këto fatura nuk janë likuiduar të gjitha në vitin e ardhshëm, pasi disponibilitetet në thesar në fund të vitit buxhetor nuk janë përdorur të gjitha në funksion të likuidimit të faturave të prapambetura vjetore, por një pjesë e tyre janë përdorur për buxhetin e ri vjetor.

Nga ballafaqimi për verifikimi i faturave të pa likuiduara (stoku) vihet re që likuidimet nuk janë kryer duke nisur nga detyrimi më i vjetër, pra sipas maturimit të tyre dhe shkak për këtë gjë janë bërë arsyet e mëposhtme:

-39 fatura të pa likuiduara kanë mungesë dokumentacioni justifikues në vlerën 5,616,134 lekë (mungon urdhri i prokurimit ose procesverbalet e komisioneve për procedurën e ndjekur për

blerjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve. Pjesa më e madhe e tyre ka vetëm faturën tatimore për likuidim dhe asnjë dokument tjetër justifikues)
-2 fatura i përkasin subjekteve në vlerën 73,840 lekë që aktualisht janë mbyllur në QKB dhe nuk operojnë më si biznese.

Efektet e zbatimit të vendimeve gjyqësore në buxhet.
-Bashkia Gramsh ka administruar 1 rast detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit. Ky detyrim i përket Vendimit nr. 883 datë 17.10.2016, janë likuiduar gjatë vitit 2021 në shumën 3,500,000 lekë dhe ka mbetur për tu likuiduar **4,500,000 lekë**.
Përpara zbatimit të vendimit gjyqësor, nga titullari nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative dhe nuk është nxjerrë akti që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi, në kundërshtim me kërkesat e pikës 62 të udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò ñ*Të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme janë përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë në ngarkim të tyre, brenda buxhetit vjetor të miratuar. Titullarët e njësive të qeverisjes së përgjithshme analizojnë të gjitha vendimet gjyqësore dhe kërkojnë nxjerrjen e përgjegjësive administrative. Vendimi gjyqësor nuk likuidohet pa aktin e titullarit që provon gjurmën e auditimit të këtij procesi".*

<u>Titulli i Gjetjes 4:</u> *Mos marrja e masave të duhura për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura.*
<u>Situata:</u> Nga Bashkia Gramsh nuk janë marrë masa të plota për uljen e vlerës së detyrimeve të prapambetura;
Sipas të dhënave të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të vitit ushtrimor 2021, konstatohet se vlera e detyrimeve të prapambetura në datën 31.12.2021, paraqitet në vlerën **32,995,914** lekë dhe përbëhet nga vlera prej 4,500,000 lekë, detyrim për zbatimin e vendimeve gjyqësore, vlera prej 5,953,124 lekë detyrim për shërbime të ndryshme, vlera prej 19,901,314 lekë detyrime për investime, si dhe vlera prej 2,641,476 lekë investime detyrim nga FZHR.
Vlera **32,995,914 lekë** është e trashëguar sipas periudhave si në vijim:
- mbartur nga vitet 2010-2015, vlera 10,372,922 lekë,
- krijuar në vitet 2016-2018, vlera 2,139,549 lekë dhe vlera 2,641,476 lekë detyrim nga FZHR
- krijuar gjatë vitit 2021, vlera 19,901,314 lekë.

Konstatohet se faturat e pa likuiduara brenda një viti buxhetor, edhe pse kanë qenë të mbuluara me vlerën e të ardhurave të trashëguara për vitin pasues buxhetor, këto fatura nuk janë likuiduar të gjitha në vitin e ardhshëm, pasi disponibilitetet në thesar në fund të vitit buxhetor nuk janë përdorur të gjitha në funksion të likuidimit të faturave të prapambetura vjetore, por një pjesë e tyre janë përdorur për buxhetin e ri vjetor.
Nga ballafaqimi për verifikimi i faturave të pa likuiduara (stoku) vihet re që likuidimet nuk janë kryer duke nisur nga detyrimi më i vjetër, pra sipas maturimit të tyre dhe shkak për këtë gjë janë bërë arsyet e mëposhtme:
- 39 fatura të pa likuiduara kanë mungesë dokumentacioni justifikues në vlerën 5,616,134 lekë (mungon urdhri i prokurimit ose procesverbalet e komisioneve për procedurën e ndjekur për blerjen e mallrave apo kryerjen e shërbimeve. Pjesa më e madhe e tyre ka vetëm faturën tatimore për likuidim dhe asnjë dokument tjetër justifikues);
- 2 fatura i përkasin subjekteve në vlerën 73,840 lekë që aktualisht janë mbyllur në QKB dhe nuk operojnë më si biznese;

Efektet e zbatimit të vendimeve gjyqësore në buxhet.

Bashkia Gramsh ka administruar në 1 rast detyrime për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, vendime të mbartura dhe gjatë periudhës së auditimit. Ky detyrim i përket Vendimit nr. 883 datë 17.10.2016, janë likuiduar gjatë vitit 2021 në shumën 3,500,000 lekë dhe ka mbetur për tâu likuiduar vlera 4,500,000 lekë.
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 50, nenin 52, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 56, ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, pika 62, UMFE nr. 2 datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò; UMF nr. 5 datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, UMFE nr. 4 datë 25.01.2021 ñPër buxhetin e vitit 2021ò, pikat 115-125 ñDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò.

Kriteri: UMF nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, Udhëzimi MFE nr. 4, datë 25.01.2021 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ò si dhe neni 52 i ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar.
Ndikimi: Likuidimi jo në kohë të detyrimeve të prapambetura, përveçse është moszbatim i kuadrit rregullator në fuqi, e vë njësinë vendore në kushtet e palës përgjegjëse ndaj kreditorëve. Ndodhur në kushtet kur shkelur marrëveshja e përcaktuar në kontratë me kreditorët për afatin e kryerjes së këtyre pagesave, krijohen premisa që kreditorët nëpërmjet proceseve gjyqësore, përveç vlerës së detyrimit sipas situacionit dhe kontratës, të kërkojnë edhe përqindje të interesave etj., gjë e cila rrit kostot financiare në mënyrë artificiale.
Shkaku: Mos vendosja e fondeve buxhetor në masën e duhur në likuidimin e detyrimeve të prapambetura, si dhe krijimi i detyrimeve të reja gjatë vitit buxhetor.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financës, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, ku mos shlyerja në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve paraqet rriskë për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, pasi një pjesë e buxhetit të kësaj njësie do të përdoret jo për të financuar nevojat reale të vitit buxhetor, por për të likuiduar detyrimet e prapambetura, duke zvogëluar fondet në dispozicion për investime dhe shpenzime të tjera në interes të komunitetit.

Për mos marrjen e masave për likuidimin e detyrimeve të prapambetura dhe krijimin e detyrimeve të reja për periudhën 01.01.2021 - 31.12.2021, ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Gramsh z. K. T., në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe z. A. Sh., me detyrë, Drejtorë i Financës & Buxhetit.

Burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre dhe borxhi tatimor.
Struktura e Bashkisë Gramsh për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore
Për vitin 2021, Struktura organizative e Bashkisë Gramsh është miratuar me VKB nr. 115 datë 01.07.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 37/1 datë 15.01.2021. Referuar këtij vendimi Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka patur në përbërjen e saj 5 punonjës në vitin 2021, konkretisht 1 Drejtor Drejtorie, 1 Përgjegjës Sektori dhe 3 inspektor për tatim taksa vendore të Bashkisë Gramsh.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2021 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Gramsh është miratuar me VKB nr. 96 datë 30.12.2019 ñPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò në Bashkinë Gramsh, dhe niveli i realizimit të tyre paraqitet në tabelën në vijim.

Tabela nr. 1: Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave në Bashkinë Gramsh, viti 2021 në mijë lekë

Nr.	Lloji i Taksës	Plani	Fakti	%
	I. Të ardhura nga taksat vendore			
1	Taksë mbi biznesin vogël	10	326	3260
2	Taksa mbi pasurinë ndërtesë	6,643	5,343	80.4
3	Taksë kalim pronësie	300	42	14
4	Taksë regj mjet .Trasporti	5,000	7,618	152.4
5	Taksë tregu zënie vendi	711	504	71
6	Taksë tabele + reklame	811	169	21
7	Taksa e rentës minerale	0	0	0
8	Taksa hapsire publike	822	610	74
9	Taksë ndërtime të reja	32,000	6,703	21
10	Taksë infastrukture	500	9,795	1959
11	Taksë fjetje hotel	70	0	0
12	Taksë e Tokës	4,109	3,404	83
13	Taksë Trualli	1,009	803	80
14	Taksë pulle	25	90	360
15	Taksë Blektorie	1,378	978	71
	SHUMA I	**53,388**	**36,394**	**68**
	II. Të ardhura jo tatimore			
1	Tarifë pastrimi	9,004	8,813	98
2	Tarifë gjelbërimi	2,106	2,007	95.3
3	Tarifë ndricimi	2,856	2,552	89.4
5	Tarifë parkimi	642	707	110
6	Tarifë bagëtie	500	358	72
7	Tarifë shërbimi (vërtetime)	723	354	49
8	Tarifë leje transporti+shërb etj	650	503	77.4
9	Tarifa urbanistike	850	809	95.2
10	Tarifë e ujit të perdorur	1,180	1,006	85.3
11	Tarifë lënde dru-zjarri	7,447	6,948	93.3
12	Tarifa për Pyje e Kullota	5,000	875	17.5
13	Tarifë për bimë medicinale	500	0	0
14	Koncesione dhe fond pyjor	3,000	0	0
15	Tarifë vaditje	260	0	0
17	Tarifë shërbime të ndryshme	2,500	2,413	96.5
18	Tarifë rregjistrimi konvikt	850	643	76
19	Të ardhura nga gjoba,insp.ndërt	700	803	115
20	Të ardh. Kopësht+çerdhe	1,200	1,963	164
21	Të ardhura nga shitja materiale	200	0	0
22	Të ardhura 2% i TAP-it	500	0	0
23	Tarifë për hidrocentralet	314	4,814	1533
24	Tarifë linja ajrore	100	82	82
25	Tarifë e përkohshme arsimore	2,500	1,435	57.4
26	Të ardhura nga debitorë	11,409	729	6.4
	SHUMA II	**54,991**	**37,814**	**69**
	III. Të Ardhura nga pronat			
26	Qira trualli	0	2	0
27	Qira objekti	4,235	2,791	66
28	Qira toke	8,082	649	8
29	Qira Makine	50	0	0
30	Të ardhura privatizimi	10,000	855	8.5
	SHUMA III	**22,367**	**4,296**	**19.2**
	SHUMA TOTALE I+II+III	**130,746**	**78,504**	**60**

Burimi: Bashkia Gramsh, përpunoi grupi i auditimit

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Gramsh paraqitet në masën 60%, nga 130,746 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 78,504 mijë lekë (minus 52,242 mijë lekë).
Konstatohen se niveli i realizimit të disa taksave dhe tarifave ka ndikuar në nivelin e realizimit të të ardhurave për vitin 2021 në Bashkisë Gramsh si për shembull:
-Taksa e ndërtesës ka një mos realizim prej 1,300 mijë lekë, si rezultat të numrit të familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, me status invalid apo pensionist të cilët përjashtohen nga taksa e ndërtesës;
-Taksa e tokës ka një mos realizim prej 707 mijë lekë dhe truallit prej 205 mijë lekë, si rezultat i largimit të banorëve nga fshatrat;
-Taksa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit kanë një mos realizim 593 mijë lekë, kjo nga ardhur si rezultat i largimit të familjeve dhe bizneseve debitor.
-Vështirësi haset në vjeljen e taksës së tokës bujqësore ndaj fermerëve për shkak të mos organizimit të duhur të punës për vjeljen e taksës. Kjo sjell të ardhura të munguara nga viti në vit në buxhetin e bashkisë.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar , neni 9, pika 3/c[4] dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 ñPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò, pika 5[5].
Në Bashkinë Gramsh struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZhT).
Titulli i gjetjes 5: *Mos arkëtim i taksës së ndërtimeve të reja që pajisen me certifikatën e pronësisë (taksa e legalizimeve)*
Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, për vitin 2021 ASHK ka dërguar informacion në Bashkinë Gramsh për 56 qytetarë që kanë kryer legalizimet e banesave të tyre. Bashkia ka llogaritur taksën e ndikimit në infrastrukturë për secilin nga qytetarët duke dërguar edhe njoftimet përkatëse. Vlera totale e detyrimit është 1,302,359 lekë. Kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë 55 qytetarë në vlerën 1,194,059 lekë dhe nuk ka paguar taksën një qytetar (Xh. D.) në vlerën 108,300 lekë duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 108,300 lekë.**

[4]Ligji nr. 95/2018 ñ për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c ñpër ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesiò.
[5]VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: ñTaksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimiò.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27.
Ligji nr. 95/2018 ñpër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c.
Ligji nr. 98/2020 ñpër disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 1, ñnë nenin 27, pika 3, shkronja ñcò.
VKM nr. 860, datë 10.12.2014 ñ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò pika 5.
VKB nr. 96 datë 30.12.2019 ñPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò në Bashkinë Gramsh.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Gramsh, nga mos arkëtimi i vlerës prej **108,300 lekë** për ndërtimet e reja që legalizohen.
Shkaku: Mos marrje e masave efektive nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për të bërë të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për ñTaksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimetò dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga z. Xh. D. në vlerën **108,300 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Gramsh të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore
Titulli i gjetjes 6: *Mbi administrimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Gramsh.*
Situata: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Gramsh kryhet në programin Excel. DTTV nuk kryen regjistrim manual të të dhënave (nuk ka regjistra fizik) çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Gramsh i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Të dhënat janë regjistra në formë tabelare dhe sipas rasteve me aplikim të formulave për llogaritjen e shumave dhe përqindjeve.
Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV duke rezultuar në gabime në llogaritjen e detyrimeve apo kamatë vonesave. Regjistrimi, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave vetëm në programin Excel paraqet një risk të lartë edhe ndaj defekteve të ndryshme teknike të kompjuterave me pasojë humbjen e të dhënave të DTTV. Gjithashtu, administrimi i taksave dhe tarifave vendore është edhe detyrim i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7. ñPranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorëò.
Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Gramsh:

Tabela nr.2: Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Gramsh viti 2021

Nr	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të Reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja
1	Biznesi Vogël	2021	478	12	9	481
2	Biznesi Madh	2021	72	2	4	70
	Gjithsej	2021	550	14	13	551

Burimi: Bashkia Gramsh
Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7.
Ndikimi: Mungesa e një sistemi të mirëfilltë për menaxhimin e taksave dhe tarifave vendore ka efekt të drejtpërdrejtë në saktësinë e informacionit që përpunojnë punonjësit e DTTV.
Shkaku: Mos angazhim i nivelit drejtues për të vendosur në objektivat e bashkisë krijimin e një sistemi për administrimin e taksave dhe tarifave vendore.
Rëndësia: E mesme
Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Të ardhurat nga asetet e dhëna me qira
Në kuadër të auditimit të të ardhurave të Bashkisë Gramsh u auditua realizimi i të ardhurave nga asetet e bashkisë të dhëna me qira. Në këtë aspekt u auditua vetëm zbatimi i kushteve të kontratave lidhur me pagesat në afat të detyrimeve të qirasë vjetore për sipërfaqen e marrë me qira dhe jo kushtet e hartimit të kontratave.
Dhënia e aseteve të bashkisë me qira bëhet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840;
- Ligjin nr. 139/2015, ñPër Vetëqeverisjen Vendore;
- VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar;
- VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò.

Titulli i gjetjes 7: *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.*
Situata: Bashkia Gramsh në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi[6] për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 68 kontrata për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1-99 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet bujqësor, objekte banimi etj.
Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezulton se 46 qiramarrës kanë paguar rregullisht detyrimin ndaj bashkisë ndërsa 22 qiramarrës paraqitur në tabelën në vijim nuk kanë paguar detyrimin për vitin 2021 në vlerën **7,911,120 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh.**

Tabela nr. 3: Pagesa e kontratave për asetet e dhëna me qira

Nr.	Subjekti	Kontrata datë	Sip m2	Të mbartura	Paguar 2021	Detyrime të vitit 2021	Debitorë 31.12.2021

[6] Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, ligjin nr. 139/2015, ñPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar, VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò.

1	A. B.	21.04.2022	100	60,000	60,000	90,000	90,000
2	G. K.	07.2.2022	72	170,400	10,000	64,800	225,200
3	E. B.	pa kontratë	120	746,000		108,000	854,000
4	S. Xh.	01.3.2022	100	474,000		90,000	564,000
5	A. Xh.	19.04.2022	112	645,600	5,000	100,800	741,400
6	K. K.	pa kontratë	120	294,000		108,000	402,000
7	P. R.	28.01.2020	200	396,000	135,000	180,000	441,000
8	O. T.	25.3.2022	108	552,300	3,000	97,200	649,500
9	E. L.	pa kontratë	108	648,400		97,200	745,600
10	A. Xh.	11.04.2022	144	759,200	5,000	129,600	883,800
11	A. Xh.	28.01.2020	112	75,600	8,400	100,800	168, 000
12	T. Z.	7.3.2022	110	107,750	24,750	99,000	182,000
13	V. B.	16.06.2020	45	91,125	3,375	40,500	128,250
14	H. P.	21.04.2022	200	60,000	90,000	180,000	150,000
15	A. Ç.	28.1.2022	110	198,000	41,250	99,000	252,750
16	B. Ç.	28.01.2022	128	11,5200	38,400	115,200	192,000
17	D. Ll.	pa kontratë	57,6	146,880		51,840	198,640
18	G. Q.	pa kontratë	45	138,000	24,000	40,500	154,500
19	R. H.	pa kontratë	36	123,000	2,000	32,400	153,400
20	A. B.	08.01.2020	100	82,500	82,500	90,000	90,000
21	Sh. B.	pa kontratë	100	16,5000		90,000	255,000
22	D. O.	pa kontratë	50	345,000		45,000	390,000
	Totali				**532,675**	**2,049,840**	**7,911,040**

Burimi: Bashkia Gramsh

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër rezulton se, nga 22 qiramarrës debitorë janë 8 qiramarrës që përdorin asete të Bashkisë Gramsh pa lidhur një kontratë me bashkinë për marrjen në përdorim/qira të tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kushteve të kontratave të qirasë përkatësisht me nenin 3 ñPagesa dhe regjimi i sajò.

Kriteri: Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840.

Ligji nr. 139/2015 ñPër Vetëqeverisjen Vendore, neni 36.

VKM nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar.

VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 ñPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Gramsh nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit.

Shkaku: Strukturat e Bashkisë Gramsh nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim 1: Sektori Juridik dhe i Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masat dhe të ndjekin të gjitha hapat ligjorë që 22 qiramarrësit që nuk kanë zbatuar kushtet e kontratës së qirasë të paguajë detyrimet përkatëse secili që në vlerën totale janë **7,911,120 lekë.** Gjithashtu, në vijimësi Sektori Juridik dhe i Aseteve të ndjekë me përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit.

Rekomandim 2: Sektori Juridik dhe i Aseteve të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet/personat që kanë në përdorim objekte/prona/sipërfaqe në pronësi të Bashkisë Gramsh.

Menaxhimi i borxhit

Nga auditimi i dokumentacionit të Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore u konstatua se subjektet janë njoftuar periodikisht për detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, si dhe janë rinjoftuar në rastet e vonesave në pagesat e detyrimeve vendore. Gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik dhe për debitorët familjarë për vitin 2021 paraqitet në vijim.

Titulli i gjetjes 8: *Mbi nivelin e borxhit tatimor në Bashkinë Gramsh dhe masat e marra për uljen e tij.*

Situata:

Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 23[7] të VKB-së nr. 96, datë 30.12.2019 për paketën fiskale dhe është e ndarë në 10 kategori që kanë nivele të ndryshme takse për ha/vit.

Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, Bashkia Gramsh klasifikohet në kategorinë e katërt ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 4: Vlera e taksës së tokës së tokës bujqësore në lekë/hektar/vit

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	1,400
II	1,200
III	1,100
IV	1,000
V	900
VI	800
VII-X	700

Tabela nr. 5: Debitorët sipas Njësive Administrative për taksën e tokës në mënyrë progresive

Nr.	Njësia Admistrative	Nr. Familjeve Gjithsej	Nga të cilat						
			Debitorë	Paguar	Pjesërisht	Nuk kanë paguar		Debitorë	Vlera debitore
						Persona	Arkëtuar		
	Nj. A. Pishaj	1,668	640	1,028	0	640	1,028	640	5,310,368
	Nj. A. Kodovjat	1,097	249	848	0	249	848	249	1,410,035
	Nj. A. Skenderbegas	682	343	339	0	343	339	343	3,828,152
	Nj. A. Kukur	1,192	748	444	0	748	444	748	2,328,752
	Nj. A . Poroçan	597	255	342	0	255	342	255	811,898
	Nj. A. Lenie	691	328	363	0	328	363	328	1,003,338
	Nj. A. Kushove	478	168	310	0	168	310	168	1,218,180
	Nj. A. Tunje	779	330	449	0	330	449	330	2,252,775
	Nj. A. Sult	437	111	326	0	111	326	111	1,176,443
	Totali	**7,621**	**3,172**	**4,449**		**3,172**	**4,449**	**3,172**	**19,339,941**

Burimi: Bashkia Gramsh

Referuar të dhënave të tabelës më sipër në Bashkinë Gramsh për taksën e tokës bujqësore më datë 31.12.2021 **janë debitore 3172 familjeve me vlerë të detyrimit 19,339,941 lekë**.

[7] Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 23, pika 1, ankesi 1.

Taksat dhe tarifat familjare
Në Bashkinë Gramsh familjarët ngarkohen me detyrime vendore për taksën e tokës, taksën e ndërtesës, taksën e truallit, tarifat e pastrimit, ndriçimit dhe të gjelbërimit. Gjatë vitit 2021nga familjet janë krijuar detyrime për taksat dhe tarifat vendore në vlerë 11,022,712 lekë.
Nga auditimi rezulton se, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në Bashkinë Gramsh paraqitet:

Për vitin 2020
Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën **4,422,021 lekë**;
Detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare janë në shumën **14,433,781 lekë**;
Detyrimet nga taksa e tokës bujqësore në shumën **18,203,801 lekë.**
Vlera e borxhit e krijuar gjatë vitit 2021 është 16,363,890 lekë nga të cilat:
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 11,022,712 lekë;
- Detyrimet nga taksa e tokës bujqësore në shumën 2,533,404 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare janë në shumën 2,807,774 lekë.

Për vitin 2021
Detyrimet nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën **18,951,699 lekë** (18,426,094+525,605 kamatëvonesa) për 62 subjekte;
Detyrimi për taksën e tokës bujqësore në vlerën **19,339,941 lekë** për 3,172 familje;
Detyrimet nga taksat dhe tarifat familjare janë në shumën **15,794,072 lekë**;
Në total borxhi tatimor në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën **54,085,792 lekë.**
Informacion më i detajuar lidhur me detyrimet e familjeve sipas taksave dhe tarifave paraqitet në anekset nr. 7, nr. 8 bashkëlidhur.

Në fund të vitit 2021 gjendja e debitorëve progresiv për subjektet fizik/juridik është **18,951,699 lekë** për 62 subjekte**, 15,794,072 lekë** për taksat dhe tarifat familjare**, 19,339,941 lekë** për taksën e tokës bujqësore vlerë kjo që sjell **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në total 54,085,792 lekë.**

Masat e marra për uljen e borxhit
Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Gramsh është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:[8]

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Sekuestrimi i pasurisë.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore. Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet ndaj bashkisë, janë nxjerrë shkresat përkatëse për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar. Përkatësisht janë nxjerrë urdhrat nr. 135 datë

[8]Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 89,90,91,93.

01.02.2022, dhe nr. 654 datë 16.02.2022 drejtuar tre bankave të nivelit të dytë për bllokim të llogarive bankare ndaj 21 subjekteve debitore.
Gjithashtu, Bashkia Gramsh është në proces gjyqësor me subjektin ñD... Hydropowerò Sh.A i cili ka detyrime ndaj Bashkisë Gramsh në vlerën 14,364,583 lekë.
Referuar dokumentacionit të paraqitur nga DTTV dhe audituar nga grupi i auditimit rezulton se me shkresat e sipërcituara janë njoftuar 21 subjekte debitorë progresiv në vlerë totale detyrimi ndaj bashkisë **960,396 lekë** për bllokimin e aktivitetit në rast të mos pagimit të detyrimeve. Si rezultat i këtyre masave kanë paguar detyrimet ndaj bashkisë 10 subjekte me vlerë **331,802 lekë.**
Nga auditimi rezulton që për periudhën objekt auditimi Bashkia Gramsh nuk ka aplikuar masat ñBllokim të llogarive bankare të tatimpaguesveò, ñSigurimi i detyrimit tatimorò apo ñSekuestrim i pasurisëò për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore ndaj bashkisë veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 90, pika 1 ñ*Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore, nëpërmjet një urdhri me shkrim, të lëshuar nga drejtori i drejtorisë rajonale apo drejtuesi i njësisë së ngjashme me të, apo titullari i zyrës tatimore të qeverisjes vendore, i kërkon çdo banke, ku tatimpaguesi ka llogari në emër të vet, të bllokojë një shumë, e cila duhet të jetë më e vogla ndërmjet: a) shumës që kërkohet të mbahet; b) shumës, që rezulton në atë çast në llogarinë bankare të tatimpaguesit*ò, neni 91 ñ*Nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij.....*ò dhe neni 93 ñ*Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit.....* ò.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. A. J. me Detyrë Drejtori i Drejtorisë së Tatim Taksave, z. A. N. me detyrë Përgjegjës Sektori i Tatim Taksave (N/C), z. J. H. me detyrë Inspektor i taksave të tregjeve (N/C) dhe z. F. B. me detyrë Inspektor për taksat familjare (N/C).

Kriteri: Ligji Nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Gramsh.
Shkaku: Mos zbatimi efektiv i kërkesave ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore nga debitorët.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Gramsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **54,085,792 lekë**, *si më poshtë vijon*:
a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të marren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve
Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:
- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñpër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;
- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, pika2/9 ñ*Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera*".

Titulli i gjetjes 9: *Ushtrimi i aktivitetit në shkelje të dispozitave ligjore nga subjektet që tregtojnë lëndëve djegëse.*
Situata: Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Gramsh për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 6 subjekte të paraqitura në tabelën në vijim.
Tabela nr. 6: Subjektet që ushtrojnë aktivitet në shitjen e lëndëve djegëse me pakicë

Nr	Subjekti	Vendndodhja	Autorizimi
1	ñK...ò	Pishaj-Gramsh	04.07.2017-03.07.2022
2	ñK...ò	Holta - Gramsh	09.09.2021- 08.09.2022
3	ñS...ò	Pishaj -Gramsh	24.10.2017-23.10.2022
4	ñS...ò	Koçaj- Gramsh	11.12.2020-10.12.2025
5	ñG...ò	Gramsh	
6	ñB...ò	Pishaj -Gramsh	

Burimi: Bashkia Gramsh

Nga auditimi rezulton se, në Bashkinë Gramsh ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizim/licencë për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë 2 subjekte, përkatësisht subjekti ñG...ò dhe subjekti ñB...ò, në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:
- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4 ñ*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit,*

*transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*ò, neni 15 *"...Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji...",* neni 20-Autorizimet pika 2, ñ*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11*[9]*, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritje*jeò;

- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò, kreu II, pika 3 ñ*Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore*ò.

Ushtrimi i aktivitetit i pa pajisur me autorizim/licencë të lëshuar nga bashkia ka sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 2,000,000 lekë.**

Lidhur me subjektet që ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me licencë Bashkia Gramsh nuk ka marrë masa për të njoftuar Inspektoratin Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 344, datë 19.4.2017 ñPër disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, ...ò, pika 15.1 dhe 15.2 ñ *15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përgjegjës dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët fundorë, pika 15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e pikave të depozitimit apo të." tregtimit, në mënyrë që këto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi".*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, Znj. L. Z. me detyrë Drejtore e Shërbimeve të Sipërmarrjes (KP).

Kriteri: Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñpër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Gramsh.

Shkaku: Puna jo efektive e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Sipërmarrjes si dhe Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim.

Rëndësia: E lartë

[9]Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar, neni 11-Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundoreò.

Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa që subjektet ñG...ò dhe ñB...ò, që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë secili ndaj Bashkisë Gramsh.

Mbi pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh

Lidhur me subjektet që janë shpallur fitues nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke fituar të drejtën të kryejnë punime në territorin e Bashkisë Gramsh dhe Njësive Administrative në vartësi për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 grupi i auditimit auditoi dokumentacionin mbi pagesën e detyrimeve të këtyre subjekteve për taksat dhe tarifat vendore për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar dhe VKB-së nr. 96 datë 30.12.2019 ñPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò.

Bazuar në evidencën e prokurimeve për vitin 2021 janë 5 subjekte që janë kualifikuar si oferta të vlefshme dhe kanë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve në territorin e Bashkisë Gramsh referuar tabelës në vijim.

Tabela nr.7: Subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh për periudhën 01.07.2020-31.12.2021.

Nr.	Subjekti	Vlera e Kontratës pa TVSh	Afati i kontratës	Detyrimi (Pastrim-Gjelbërim-Ndriçim) Vjetor	Detyrimi për periudhën e kontratës
1	ñB...-N & G... Z... Shpkò	95,979,232	6 muaj	147,000	73,500
2	ñV... Construksion Shpkò	96,995,778	6 muaj	123,000	65,000
3	V... Construksion & G.. Z...	12,793,409	3 muaj	123,000	32,500
4	V... Construksion & G... Z...	9,985,774	3 muaj	123,000	32,500
	Totali				**203,500**

Burimi: Bashkia Gramsh

Titulli i gjetjes 10: *Mbi pagesën e detyrimeve vendore nga subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh.*

Situata: Nga auditimi rezultoi se, janë 4 operatorë ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj Bashkisë Gramsh për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë në vlerën 203,500 lekë**.

Drejtoria Juridike nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre për periudhën e kontratës.

Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik të listuar në tabelën e mësipërme është në kundërshtim me përcaktimet e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në republikën e shqipërisëò, i ndryshuar, neni 43 pika 1/1*"....Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë,*

me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm....” Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 40.1, 43.1.1 dhe VKB nr. 96 datë 30.12.2019 ñ*Për Miratimin e Paketës Fiskale Vendore*ò në Bashkinë Gramsh.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi, z. A. J. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe z. A. N. me detyrë Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore nga data 20.09.2021 e në vijim.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në republikën e shqipërisëò, i ndryshuar, neni 43 pika 1/1.
Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 40.1, 43.1.1.
VKB nr. 96 datë 30.12.2019 ñPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò në Bashkinë Gramsh.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën **203,500 lekë**.
Shkaku: Mos ndjekja e hapave ligjore për subjektet që janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh për pagesën e taksave dhe tarifave vendore.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

Mbi realizimit e të ardhurave nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Gramsh
Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Gramsh është ngritur dhe funksionon në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, i ndryshuar, neni 4. IMTV ushtron aktivitet bazuar në kuadrin ligjor si më poshtë:

- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 ñPër Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshmeò, i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 ñPër unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendoreò;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabëlò.

Për vitin 2021, Struktura organizative e Bashkisë Gramsh është miratuar me VKB nr. 115 të datë 01.07.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 37/1 të datës 15.01.2021 ñPër miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Gramshò.
Referuar urdhrit të sipër cituar konstatohet se për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, se IMTV ka patur në strukturë 2 punonjës (1 Kryeinspektor dhe 1 Inspektor).
Titulli i gjetjes 11: *Mbi mos arkëtimin e gjobave të vendosura nga Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Gramsh.*

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit që administron IMTV-ja në Bashkinë Gramsh u konstatua se për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 janë mbajtur në total 10 proces verbale për konstatimin e kundërvajtjes në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 ñPër inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshmeò, i ndryshuar, neni 12.
Për këto 10 kundërvajtje janë dhënë 10 masa ñ*Dënim me gjobë*ò referuar përcaktimeve të ligjit nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò neni 52. **Vlera totale e gjobave të vendosura për vitin 2021 është 3,500,000 lekë,** e paraqitur në mënyrë të detajuar në tabelën në vijim:

Tabela nr.8: Proces verbalet e mbajtura dhe gjobat e vendosura nga IMTV për periudhën 01.01.2021-31.12.2021

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i shkeljes	Proces verbali	Penalitete	Baza ligjore 107/2014
1	A. B.	Shtesë muri	Nr. 53 datë 18.1.21	50,000	Neni 52 pika d
2	K... Shpk	Çarje tubi ujësjellsi	Nr. 54 datë 6.3.21	500,000	Neni 52 pika 1 germa ñeò
3	A... Shpk	Instalim shtyllash	Nr. 55 datë 30.4.21	500,000	Neni 52 pika 1 germa ñeò
4	A. K.	Objek 1 katësh	Nr. 56 datë 9.6.21	50,000	Neni 52 pika 1 germa ñdò
5	L. T.	Objekt 1 kat	Nr. 57 datë 15.7.21	50,000	Neni 52 pika 1 germa ñdò
6	Xh. H.	Objekt kasolle	Nr. 58 datë 15.7.21	50,000	Neni 52 pika 1 germa ñdò
7	K...	Dëmtim tortuari	Nr. 59 datë 21.10.21	500,000	Neni 52 pika 1 germa ñeò
8	R... Shpk	Punime ndërtimi	Nr. 60 datë 22.11.21	1,000,000	Ligj 120/2020 neni 15 pika 1
9	E. S.	Ndërtim	Nr. 61 datë 2.12.21	500,000	Neni 52 pika 1 germa ñeò
10	P. Q.	Ndërtim shkelje leje	Nr. 62 datë 25.10.21	300,000	Neni 52 pika 1 germa ñëò
				3,500,000	

Burimi: Bashkia Gramsh, IMTV

Nga auditimi rezulton se, për gjobat e vendosura në vitin 2021 janë paguar në mënyrë vullnetare 3 gjoba në vlerën totale të arkëtimeve 600,000 lekë, janë në proces gjyqësor 3 gjoba në vlerën 2,000,000 lekë dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e 4 gjobave në vlerën 900,000 lekë. Rezulton se, **për vitin 2021 të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë në vlerën totale 2,900,000 lekë.**

Për gjobat e vendosura dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV ka dërguar në gjykatë vendimet për të nxjerrë Urdhrin e Ekzekutimit për secilën gjobë, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò, neni 30, pika 4[10], por nuk ka ndjekur hapat e tjera të parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë, neni 9 ñ*Ekzekutimi i kundërvajtjeve administrative "Vendimi për kundërvajtjen administrative, sipas këtij ligji, bëhet i ekzekutueshëm nga organi administrativ që e ka nxjerrë atë. Kur organi administrativ që ka nxjerrë vendimin e kundërvajtjes administrative, i cili është bërë i ekzekutueshëm, nuk ka në përbërjen e tij struktura të ekzekutimit me forcë të detyrimeve, për ekzekutimin e vendimit të kundërvajtjes administrative ngarkohet shërbimi përmbarimor, sipas këtij ligji", neni 22, pika 1, "Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga organet administrative të përmendura në nenin 20 të këtij ligji, si dhe vendimet e parashikuara në nenin 21 të këtij ligji, përbëjnë titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor ose/dhe organet e përcaktuara në kreun V të këtij ligji", neni 3, pika 5 "Kur gjoba dhe detyrimet e tjera të parashikuara në vendimin për kundërvajtjen administrative nuk paguhen*

[10] Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò neni 30-Arkëtimi i shumave të detyrimeve pika 4,ñ Kërkesa për të nxjerrë urdhrin e ekzekutimit bëhet në gjykatë përkatësisht nga: b) titullari i organit, që ka nxjerrë vendimin për kundërvajtjen administrative.

*ose nuk nxirren dot nga paga, ato nxirren duke vënë sekuestro mbi pasurinë e të dënuarit për kundërvajtje administrative, qoftë edhe sikur ajo të ndodhet në dorën e personave të tjerë*ò.
Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2021 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, janë në proces gjyqësor 4 gjoba (Sh. T., H. P., O. Ç., H. L.) me vlerë 610,000 lekë dhe për një gjobë (Z. G.) është nënshkruar marrëveshje dhe ende mbetet për tû likuiduar vlera 41,600 lekë. Pra, gjoba në proces gjyqësor dhe me marrëveshje të pa arkëtuara në total janë në vlerën 651,600 lekë.
Në tabelën në vijim paraqitet ecuria e gjobave në mënyrë progresive

Tabela nr.9: Pasqyra e gjobave të IMTV-së progresive 31.12.2021

Nr.	Emër Mbiemër	Lloji i objektit	Gjoba vendosur	Pr.Gjyqësor
1	Sh. T.	Rritje e lartësisë së murit	10,000	Pr.Gjyqësor
2	H. P.	Punime rikonstruksioni	50,000	Pr.Gjyqësor
3	O. Ç.	Ndërtim 3 faqe muri	50,000	Pr.Gjyqësor
4	H. L.	Objekt pa leje	500,000	Pr.Gjyqësor
5	Z. G.	Mos deklarim punimesh	41,600	Marrëveshje
6	P. Q.	Ndërtim shkelje leje	300,000	-
7	K... Shpk	Çarje tubi ujësjellsi	500,000	Pr.Gjyqësor
8	K... Shpk	Instalim fibrave optik	500,000	Pr.Gjyqësor
9	R... Shpk	Punime ndërtimi	1,000,000	Pr.Gjyqësor
10	E. S.	Ndërtim	500,000	-
11	A. B.	Shtesë muri	50,000	-
12	A. K.	Objek 1 katësh	50,000	-
	Totali		**3,551,600**	

Burimi: Bashkia Gramsh, IMTV

Sa më sipër, **të ardhurat e munguara nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV në progresiv janë në vlerën totale 3,551,600 lekë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, znj. L. Z., me detyrë, Kryeinspektor i IMTV-së për periudhën janar 2020 - shtator 2021 (KP) dhe z. E. H., me detyrë Kryeinspektor i IMTV, shtator 2021 e në vijim (KP).

Kriteri: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010 òPër kundërvajtjet administrativeò neni 30 pika 4, neni 9, neni 22, pika 1, neni 3, pika 5.
Ndikimi: Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën **3,551,600 lekë**.
Shkaku: Mos ndjekja e hapave ligjore për arkëtimin e gjobave të vendosura nga IMTV.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **3,551,600 lekë**.

2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare për vitin 2020.
Pasqyrat Financiare Vjetore të vitit ushtrimor 2021 janë hartuar dhe depozituar më datën 29.03.2021 në Degën e Thesarit, brenda afatit ligjor.

Bashkia Gramsh me shkresën nr. 1277 Prot., datë 29.03.2021 i ka dërguar Degës së Thesarit.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare
Në fund të periudhës ushtrimore 2020 janë plotësuar 7 Formate, (pasqyra financiare), sipas formularëve standard të miratuara me UMF nr. 08, datë 09.03.2018 òPër procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshmeñ,
Formati 1 ï Pasqyra e Pozicionit Financiar
Formati 2 ï Pasqyra e Performancës Financiare
Formati 3 ï Pasqyra e Flukseve Monetare (Cash Flow)
Formati 4 ï Pasqyra e ndryshimeve në Aktivet Neto/ Fondet Neto
Formati 5- Pasqyra e shënimeve shpjeguese
Formati 6 ï Pasqyra e investimeve dhe e burimeve të financimit
Formati 7/a ï Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me koston historike
Formati 7/b - Pasqyra mbi gjendje dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata me vlerën neto
Formati 8 - Pasqyra mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave

Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike.
Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë e informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.
a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:
Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.
b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve

Pasqyra e pozicionit financiar (F1)
Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 3,067,669,554 lekë.

	Viti 2020
AKTIVET	3,067,669,554
PASIVET(DETYRIMET)	3,067,669,554
AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	0

Burimi: Bashkia Gramsh

Aktivet afatshkurtra
Aktivet afatshkurta më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën 281,010,535 dhe përbëhen nga:
- Llogaritë e Klasës 5 ñMjetet monetare dhe ekuivalentet e tyreò në shumën 135,837,799 lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 ñGjendje inventari qarkulluesò në shumën 40,461,352 lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 ñLlogari të arkëtueshmeò në shumën 71,715,470 lekë dhe
ñTë tjera aktive afatshkurtraò në shumën 32,995,914 lekë.

Llogaritë e Klasës 5 "Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre" përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti i 2020	Diferenca 2021-2020
531	Mjete monetare ne arkë	-	-	-

512	Mjete monetare në bankë	-	-	-
520	Disponibilitete në thesar	135,837,799	95,862,232	39.975.567
50	Letra me vlerë	-	-	-
532	Vlera të tjera	-	-	-
54	Akredeitiva dhe paradhënie	-	-	-
59	Provigjone zhvlerësimi	-	-	-
	TOTALI	135,837,799	95,862,232	39.975.567

Burimi: Bashkia Gramsh

Vlera e llogarisë 520 ñDisponibilitete në thesarò në shumën 135,837,799 lekë, përbëhet nga:
Llog 466 ñKreditorë për mjete në ruajtjeò në shumën 41,799,735 lekë; dhe
Llog 85 ñRezultati i veprimtarisë ushtrimoreò në shumën 94,038,064 lekë;
Llogaria 520 òDisponibiliteti në thesarò paraqet gjendjen e saktë në bilanc.

Llogaritë e Klasës 3 "Gjendje inventari qarkullues", përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
31	Materiale	8,120,506	12,191,599	(4,071,093)
32	Objekte inventari Inventar i imët	32,323,676	30,109,714	2,213,962
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	-	-	-
34	Produkte	-	-	-
35	Mallra	17,170	17,170	-
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmeri	-	-	-
37	Gjendje te pambritura ose pranë të treteve	-	-	-
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	-	-	-
39	Provigjione për zhvlerësim te inventarit(-)	-	-	-
	Totali	40,461,352	42,618,483	(1,857,131)

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë në 31.12.2021 paraqitet në vlerën 40,461,352 lekë dhe përbëhet nga:
Llogaria kontabël 31ñMaterialeò për shumën 8,120,506 lekë;
Llogaria kontabël 32 ñObjekte inventariò për shumën ,32,323,676 lekë;
Llogaria kontabël 35 ñMallraò për shumën 11,170 lekë;
Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (1,857,131) lekë e cila kuadron me llogarinë 63òNdryshimi i Gjendjes së Inventaritò në shumën (1,857,131) lekë.

Llogaria 312 ñMaterialeò ka vlerën 8,120,506 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2021	12,191,599
Hyrjet në magazinë gjatë	45,200,049
Dalje nga magazina gjatë	49,271,142
Gjendja në 31.12.2020	8,120,506

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaria 327 ñObjekte inventariò ka vlerën 32,323,676 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	30,019,714

Hyrje gjatë vitit 2021	2,213,962
Dalje gjatë vitit 2021	-
Gjendja në 31.12.2021	32,323,676

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaria 35 ñMallraò ka vlerën 17,170 lekë dhe përputhet me rezultatin e inventarizimit vjetor dhe nuk ka ndryshime. Lëvizjet e llogarisë 35 ñMallraò paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	17,170
Hyrje gjatë vitit 2021	-
Dalje gjatë vitit 2021	-
Gjendja në 31.12.2021	17,170

Burimi: Bashkia Gramsh

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Titullari i Bashkisë ka nxjerrë Urdhrat e Inventarizimit Nr. 243 datë 08.11.2021 për ñFillimin e procedurës së inventarizimit të vlerave materialeve (aktiveve) pajisjeve/mjeteve në inventar të Bashkisëò dhe për ñFillimin e procedurës së inventarizimit të vlerave materialeve (aktiveve) pajisjeve/mjeteve në inventar të Njësive Administrative të Bashkisëò, ku janë përcaktuar grupi për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve..

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 ñNdryshimi i gjendjeve të inventaritò dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 ñNdryshimi i gjendjeve të inventaritò.

Llogaritë Klasës 4 "Llogari të arkëtueshme" & "Të tjera aktive afatshkurtra" përbëhen nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2021	Viti 2020	Diferenca 2021-2020
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme	-	-	-
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	-	5,553,000	(5,553,000)
431	Tatime e taksa	-	-	-
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog.Pushtetit Lokal	-	-	-
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	-	-	-
435	Sigurime Shoqërore	-	-	-
436	Sigurime Shëndetësore	-	-	-
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	-	-	-
44	Institucione të tjera publike	-	-	-
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	-	-	-
468	Debitorë te ndryshëm	51,258,998	40,199,751	11,086,247
4342	Te tjera operacione me shtetin(debitor)	20,429,472	18,858,905	1.570.567
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	-	-	-
49	Shuma te parashikuara për zhvlerësim(-)	-	-	-
	Totali	71,715,470	64,611,656	7,103,814
	Të tjera aktive afatshkurtra	-	-	-
409	Furnitore (Debitore),parapagime pagesa pjesore	-	-	-

473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	-	-	-
477	Diferenca konvertimi aktive	-	-	-
481	Shpenzime për tâu shpërndarë në disa ushtrime	-	-	-
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	32,995,914	20,412,472	-
	Totali	104,711,384	85,024,128	19,687,256

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaria 468 ñDebitorë të ndryshëmò në fund të vitit 2021 është në vlerën 51,258,998 lekë. Kjo shumë është rritur krahasuar me tepricën e vitit 2020 dhe debitorët e ndryshëm të krijuara ndër vite në shumën 11,086,247 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	40,199,751
Shtesa gjatë vitit 2021 sisetmimi i llogarise 423/429 (D)	5,553,000
Shtesa gjatë vitit 2021 debitoret e qerave mbi asetet te regjistruara rishtazi (D)	6,488,455
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	955,208
Gjendja në 31.12.2021	51,258,998

Burimi: Bashkia Gramsh

Titulli i gjetjes 12: *Mos kontabilizim të debitorëve për taksa dhe tarifa vendore familjare, për taksa dhe tarifa e bizneseve, taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksat e tokës bujqësore, subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizim/ licencë të lëshuar, mos pagesa të kontratave të qirave si dhe nga operatorët ekonomik në llogarinë 468 "Debitorë të ndryshëm".*

Situata: Në gjendjen e llog. 468 ñDebitorë të ndryshëmò nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore familjare në vlerën 15,794,072 lekë, për taksa dhe tarifa e bizneseve në vlerën 18,951,699 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 108,300 lekë, taksat e tokës bujqësore në vlerën 19,339,941 lekë, subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizim/ licencë të lëshuar në vlerën 2,000,000 lekë, mos pagesa të kontratave të qirave në vlerën 1,422,665 lekë (nga diferenca midis vitit 2020 në vlerën 6,488,455 lekë (vlerë e kontabilizuar) dhe vitit 2021 progresive 7,911,120 lekë), nga operatorët ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj bashkisë Gramsh për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki në vlerën 2,750,000 lekë në total 60,366,677 lekë të akumuluara në fund të vitit ushtrimor 2021, vlerë e cila nuk është kontabilizuar.

Kriteri: Udhëzimi e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22

Ndikimi: Mos funksionimi i këtyre llogarive sipas parimeve kontabël të pranuara, përbën risk lidhur me saktësinë e aktiveve të bilancit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat e lindura të konstatuara, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i legjislacionit në fushën e kontabilitetit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog. 468 ñdebitorë të ndryshëmò, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

Llogaria 4342 ñTë tjera operacione me shtetin (debitor)ò, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 20,429,472 lekë dhe kuadron me Llogarinë 7206 ñFinancim i pritshëm nga buxhetiò të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 0 lekë. Vlera prej 20,429,472 lekë përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, si dhe përbëhet nga:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	18,858,905
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	246,708,759
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	245,138,192
Gjendja në 31.12.2021	20,429,472

Burimi: Bashkia Gramsh

Në mënyrë analitike paraqitet:

401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	-
42	Detyrime ndaj personelit	14,527,050
431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	934,533
435	Sigurime Shoqërore	4,368,634
436	Sigurime Shëndetësore	599,255
437,438,	Organizma të tjerë shtetërore	-
467	Kreditore të ndryshëm	-
TOTALI		20,429,472

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaria 486 ñShpenzime të periudhave të ardhshmeò në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 32,995,914 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	20,412,472
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	19,453,829
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	6,870,386
Gjendja në 31.12.2021	32,995,914

Burimi: Bashkia Gramsh

Vlera e kësaj llogarie në shumën 32,995,914 lekë, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor.
Sqarojmë se ne detyrimet e periudhave te mëparshme janë përfshirë edhe detyrime të krijuara në periudhën dhjetor 2021, ne vlerën 19,024,060.
Vlera e detyrimeve te mbartura nga vitet e kaluara është (32,995,914- 19,024,060)=13,971,854 lekë.
Pra gjatë vitit 2021 ka patur një pakësim të kësaj llogarie, pasi janë likuiduar një pjesë e konsiderueshme e këtyre detyrimeve.

Emërtimi i llogarive	Vlera
Shpenzime gjyqësore	-
Shpenzime operative	3,799,141
Shpenzime për investime	2,641,476
Totali	6,440,617

Burimi: Bashkia Gramsh

Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 202, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitë e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera por të pa financuara".

Aktivet afatgjata
Mbi Aktivet Afatgjata jo materiale (AAJM)
Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2020 me vlerën 0 lekë dhe në fund të vitit 2021 në vlerën 0 lekë. Ky seksion i bilancit kontabël për vitet 2020 dhe 2021 është paraqitur në vlerën 0 lekë siç shihet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraardhës
59	25-26	Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhënie e Nënhuadhënie	0	0
61	26	Pjesëmarrje ne kapitalin e vet	0	0

Burimi: Bashkia Gramsh

Titulli i gjetjes 13: *Mbi kontabilizimin e aktiveve afatgjata financiare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021.*
Situata: Bashkia Gramsh, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 05/01/2021 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime Gramsh SHA me NUIS ñJ66702809Rò e cila është shoqëri aksionere me objekt aktiviteti ñShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura. Mirëmbajtja e sistemimeve të ujërave të ndotura, si dhe impianteve të pastrimit të tyreò. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhen direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuara nga legjislacioni në fuqiò. Kapital në vlerë monetare prej 178,620,750 lekë. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Gramsh në ñUjësjellës Kanalizime Gramsh SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, z. A. Sh., Drejtor i Financës.

Kriteri: Baza ligjore mbi të cilën është vlerësuar situata e cila paraqet parregullsi është Urdhri i Ministrit të Financave nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 28 ñInvestime në Pjesëmarrjeò pika 35.

Ndikimi: Mos regjistrimi në kontabilitet dhe deformim i informacionit financiar për sa i përket gjendjes kontabël të paraqitur në Pasqyrat e Pozicionit Financiar për vitin 2021 të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò, gjendje kjo e nën vlerësuar me 178,620,750 lekë.
Shkaku: Mos njohja dhe mos zbatim i ligjit nr. 9228 datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareò, urdhrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò dhe Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit nr. 28 ñInvestime në Pjesëmarrjeò.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të ñUjësjellës Kanalizime Gramshò SHA, me vlerë kontabël 178,620,750 lekë në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.
Llogaritë e Klasës 20 ñAktivet Afatgjata Jo materialeò në vlerën prej 28,715,741 lekë përbëhen nga:
Llog. 202 ñStudime dhe kërkimeò, në vlerën 39,493,675 lekë.
Sipas llogarisë analitike vlera e kësaj llogarie është 39,493,675 lekë.
Diferenca 10,777,934lekë (39,493,675-28,715,741) është vlera e amortizimit të AAJM.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	19,754,057
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	19,739,618
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	0
Gjendja në 31.12.2021 (D)	39,493,675

Burimi: Bashkia Gramsh

Testi substancial
Aktive Afatgjata jo materiale në fund të vitit 2021 rezulton në vlerën neto 28,715,741lekë dhe përbëhet nga Llogaria 202 ñStudime e kërkimeò e cila është dhënë në mënyrë analitike.
Nga verifikimi i analitikëve, konstatohet se vlera e studimeve dhe projektimeve i përkasin objekteve ende të papërfunduara, duke siguruar vlerësimin real të llogarisë 202 dhe AAJM.

Analitikisht llogaria 202 "Studime dhe kërkime" paraqitet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Vl.Kontabël	Amortizimi
1	Projekti Shkollës Kabash	Copë	1	160,000	78,184
2	Projekti Shkolles Lleshaj	Copë	1	160,000	78,184
3	Projetkti për rregullimin e ujit të pijshem	Copë	1	22,600,715	4,328,019
4	Projekti rrugës Sotirë	Copë	1	5,352,000	2,065,203
5	Projekti Rruges Lubinje	Copë	1	1,536,000	592,704
6	Projekti rruges Q.Duzhes ï Tunje	Copë	1	1,950,000	752,456
7	Projekti në toskollare	Copë	1	2,154,000	831,175
8	Projekti rrugës Bulçar ï Lenie	Copë	1	4,644,000	1,792,004
9	Projekti ujësjellesave ,Kabash,Lleshaj,Poroçan,	Copë	1	936,960	260,006
	Totali			39,493,675	10,777,934

Burimi: Bashkia Gramsh

Kjo paraqitje e llogarisë 202 ñStudime e kërkimeò është bërë në përputhje me;
- ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ñPër kontabilitetin dhe pasqyrat financiareñ neni 6,9 dhe 10
- UKM nr. 2, datë 08.05.2003 ñPër klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, pika ñcò, nën pika ñbò.

Mbi Aktive afatgjata financiare
Testet substanciale
Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të viti 2021me vlerën 0 lekë

Mbi Aktivet e afatgjata materiale (AAM)
Llogaritë e Klasës 21 ñAktivet Afatgjata Materiale", AAM sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 3,897,837,613 lekë. me një shtesë të AAM-ve në shumën 293,595,449 lekë, si dhe të pakësimeve të AAM-ve për 2,427,998 lekë që kanë ardhur kryesisht si rezultat i nxjerrjes jashtë përdorimit të AQT në Bashki.

Nr.	Llogaria	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2020	Shtesa	Pakësime	Gjendja me 31.12.2021
1	210	Toka,troje,Terrene	50,742,734	0	0	50,742,734
2	211	Pyje,Kullota Plantacione	11,217,186	0	0	11,217,186
3	212	Ndërtime e Konstruksione	838,279,361	19,006,432	0	857,285,793
4	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,425,288,441	272,730,245	0	2,698,018,686
5	214	Instalime teknike,makineri,pajisje,vegla pune	13,650,999	731,040	0	14,382,039
6	215	Mjete transporti	118,578,558	0	2,427,998	116,150,560
7	218	Inventar ekonomik	148,912,883	1,127,732	0	150,040,615
		TOTALI	3,606,670,162	293,595,449	2,427,998	3,897,837,613

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaria. 210 ñToka, Troje, Terreneò është në vlerën 50,742,734 lekë e pandryshuar dhe në 2021 njëlloj si vitet e mëparshme.

Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2020

NR	Llog.	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2020	Viti 2021	Gjendja me 31.12.2021
	210	Toka Troje Terrene	50,742,734	-	50,742,734

Llogaria 211 ñPyje, Plantacioneò paraqitet e pandryshuar prej 11,217,186 lekë e pandryshuar dhe në 2021 njëlloj si vitet e mëparshme.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	11,217,186
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	-
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	-
Gjendja në 31.12.2021 (D)	11,217,186

I.	Pyje ,Kullota Plantacione	Shuma 2021
1	Njësia Administrative Pishaj	4,428,960
2	Njësia Administrative Kodovjat	3,665,572
3	Njësia Administrative Kukur	480,000

I.	Pyje ,Kullota Plantacione	Shuma 2021
4	Njësia Administrative Tunje	479,120
5	Njësia Administrative Sult	889,900
6	Njësia Administrative Skenderbegas	394,800
7	Njësia administrative Poroçan	479,000
8	Njësia Administrative Lenie	399,834
	Totali i llogarisë (211)	11,217,186

Llogaria e aktivit 212 ñ Ndërtesa dhe konstruksioneò e cila pasqyron gjendjen e aseteve për llogari të Bashkisë, në fund të vitit 2021 rezulton me një kosto historike 857,285,793 lekë .

Titulli i gjetjes 14: *Mbi mos kontabilizimin e Aktiveve afatgjatë materiale, si pasojë e mos pajisjes me titull pronësie.*
Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, përveç objekteve të inventarit të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 919,245,713 lekë (vlerë e kontabilizuar), ka objekte të njësive administrative të cilat nuk janë pajisur me titull pronësie dhe nuk janë kontabilizuar, konkretisht për llog 210 ñToka troje terreneò, llog. 211 ñPyje plantacioneò, llog. 212 ñNdërtesa e konstruksioneò.
Për rrjedhojë ka rezultuar se mos kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, të cilat përfaqësojnë pasuri të paluajtshme, nuk është kryer duke qenë se nuk janë pajisur me një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor).
Kriteri: VKM nr. 510, datë 10.06.2015 ñPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorialò, Kreu VI ñTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeò
Ndikimi: Mungesa e titullit të pronësisë:
është pengesë për kryerjen e transaksioneve të ndryshme me pasuritë e paluajtshme;
është pengesë për menaxhimin e risqeve dhe mbrojtjen ndaj tyre, pasi mungesa e titullit të pronësisë pengon sigurimin e tyre.
ka sjellë që mos kontabilizimin e tyre në librat e kontabilitetit dhe pasqyrat financiare.
Shkaku: Nga ballafaqimi i problematikës, gjatë auditimit në terren, ka rezultuar se shkaqe të kësaj gjendjeje janë:
dokumentacioni i paplotë i trashëguar nga ish-Komunat;
vështirësia e hasur në plotësimin e dosjeve sipas kërkesave të akteve ligjore e nënligjore për regjistrimin e titujve të pronësisë;
kostoja e kryerjes së këtyre veprimeve në Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, e cila është e konsiderueshme referuar numrit të objekteve të cilët duhet të regjistrohen.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Gramsh duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Llogaria 215 ñMjete transportiò paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë më datë 31.12.2021 në shumën 116,150,560 lekë. Krahasuar me vitin e mëparshëm 2020 në vlerën

118,578,558 lekë. Që do të thotë se gjatë vitit 2021 ka patur pakësime në Llogarinë 215 ñMjete transportiò. Në vlerës prej 2,427,998 lekë nga nxjerrjet jashtë përdorimi.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2021	118,578,558
Shtesa gjatë vitit 2021 (D)	-
Pakësime gjatë vitit 2021 (K)	2,427,998
Gjendja në 31.12.2021 (D)	116,150,560

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaria kontabël 218 ñInventar ekonomikò përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative, institucionet e Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare të Bashkisë gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2021 paraqitet në vlerën kontabël 150,040,615 lekë. Krahasuar me vitin 2020 llogaria 218 ñInventari ekonomikò është rritur për vlerën 1,127,732 lekë.

Lëvizjet e Llog. 218 ñInventar ekonomikò për vitin 2020, vlera në lekë	
Çelje me 01.01.2021	148,912,883
Blerje me pagesë (D)	1,127,732
Dalje (K)	0
Amortizimi i vitit i akumuluar 2020	(104,549,167)
Gjendja me 31.12.2020 (D) Teprica Neto	45,491,448

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaria 218 ñInventar ekonomikò amortizimin e akumuluar vjetor sipas amortizimit të kontabilitetit dhe analizës në regjistrin e aktivit paraqitet 45,491,448 lekë duke përdorur normë amortizimi 20%, në përputhje me UMF nr. nr. 8 datë 09.03.2018 ñPër Procedurat e Përgatitjes, Paraqitjes dhe Raportimit të Pasqyrave Financiare Vjetore, pika 36 ku specifikohet ñ Në lidhje me amortizimin e aktiveve afatgjata për sektorin publik, amortizimi i këtyre aktiveve duhet të llogaritet sipas normave të përcaktuaraò.

Titulli i gjetjes 15: Parregullsi në mbajtjen e dokumentacionit për kryerjen e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Gramsh.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Gramsh dhe për Njësitë Administrative. Në kolonën shënime nga komisioni nuk ka vlerësime të aktiveve të veçanta për gjendje jashtë përdorimi. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2021. Nuk është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të Titullarit për ngritjen e komisionit ñPër kryerjen e procesit të inventarizimitò. Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e titullarit nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve. Komisioni i inventarizimit nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj, sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në varësi të llojit të tyre, si dhe grupit

përkatës Brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimi i gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca.
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi, z. A. Sh., Drejtor i Financës.
Kriteri: Veprime në kundërshtim me pikat 30, 73, 74 , pika 81 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò. Veprimet e mësipërme nuk janë në përputhje me përcaktimet ligjore dhe nënligjore të bëra në udhëzimin nr. 30 datë 27.12.2011 ñpër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.
Ndikimi: Kjo mënyrë evidentimi dhe proces inventarizimi, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë.
Shkaku: Nga Drejtoria Ekonomike dhe titullari i Bashkisë nuk janë marrë masat e nevojshme që te kryhet siç duhet procesi i inventarizimit te aktiveve.
Rëndësia: I mesëm
Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh, komisionet e ngarkuara sipas urdhrave të Titullarit, të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit.

Llogaria 219 ñAmortizimi i AAGJM & AAJM: Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë në fund të vitit 2021, paraqitet në vlerën 1,150,672,269 lekë e cila ka ardhur si rezultat:

Pasqyra statistikore nr. 7.b "Akitivet afatgjata me vlerë neto"

Nr. Rrjeshti	Nr. Ref. Llog.	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
			Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
a	B	C	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	20	I. AAGJ/JO MATERIALE	19,754,057	5,710,450	14,043,607	19,739,618	5,067,484	0	0	39,493,675	10,777,934	28,715,741
2	201	Prime te emisionit dhe rimbursimit te huave			0					0	0	0
3	202	Studime dhe kerkime	19,754,057	5,710,450	14,043,607	19,739,618	5,067,484	0	0	39,493,675	10,777,934	28,715,741
4	203	Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme			0					0	0	0
5	21-28	II. AAGJ/ MATERIALE	3,606,670,162	978,663,839	2,628,006,323	293,595,449	163,936,952	2,427,998	2,706,456	3,897,837,613	1,139,894,335	2,757,943,278
6	210	Toka,troje,Terene	50,742,734	0	50,742,734	0	0		0	50,742,734	0	50,742,734
7	211	Pyje,Kullota Plantacione	11,217,186	0	11,217,186	0	0	0	0	11,217,186	0	11,217,186
8	212	Ndertime e Konstruksione	838,279,361	223,352,663	614,926,698	19,006,432	36,181,637	0	0	857,285,793	259,534,300	597,751,493
9	213	Rruge,rrjete,vepra ujore	2,425,288,441	579,084,967	1,846,203,474	272,730,245	105,946,765	0	0	2,698,018,686	685,031,732	2,012,986,954
10	214	Instalime teknike,makineri,paisje,vegla pune	13,650,999	10,826,517	2,824,482	731,040	487,492	0		14,382,039	11,314,009	3,068,030
11	215	Mjete transporti	118,578,558	73,000,287	45,578,271	0	9,171,296	2,427,998	2,706,456	116,150,560	79,465,127	36,685,433
12	216	Rezerva shtetrore			0					0	0	0
13	217	Kafshe pune e prodhimi			0					0	0	0
14	218	Inventar ekonomik	148,912,883	92,399,405	56,513,478	1,127,732	12,149,762	0		150,040,615	104,549,167	45,491,448
15	24	Aktive te Qend.te trupezuara te demtuara			0					0	0	0
16	28	Caktime			0					0	0	0
17		T O T A L I (I + II)	3,626,424,219	984,374,289	2,642,049,930	313,335,067	169,004,436	2,427,998	2,706,456	3,937,331,288	1,150,672,269	2,786,659,019

Burimi: Bashkia Gramsh

Përllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019 ñPër procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia, janë si më poshtë:

ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5 %
inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi)	20 %
për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25%
për mjetet e transportit	20%
për aktivet afatgjata jo materiale (metoda lineare)	15 %

Mbi Investimet

Llogaria 230 dhe 231"Investime" për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2021, paraqiten në vlerën 0 lekë. Ky vlerësim financiar përkon me tabelën analitike të AAGJ materiale dhe jo materiale sipas tabelës më poshtë. Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten në shumën X lekë.

Nr.	Emërtimi i investimit	Vlera
1	Aktive Afatgjata jo materiale	0
2	Aktive Afatgjata materiale	0
3	Totali	0

Burimi: Bashkia Gramsh

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë më 31.12.2010, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2020, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2020, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2021	Viti 2020	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	X	X	X
42	Detyrime ndaj personelit	14,527,050	13,454,399	1,072,651
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	934,533	841,719	92,814
435	Sigurime Shoqërore	4,368,634	4,012,298	356,336
436	Sigurime Shëndetësore	599,255	550,489	48,766
437,438,	Organizma te tjerë shtetërore	X	X	X
466	Kreditore për mjete ne ruajtje	41,799,735	32,412,694	9,387,041
467	Kreditore te ndryshëm	32,995,914	20,412,472	12,583,442
4341/470	Operacione me shtetin(detyrime/Llogari ne pritje - te ardhura për tu mare	51,285,998	45,752,751	5,533,247
	Gjendja më fund të periudhës	146,511,119	117,436,822	29,074,297

Burimi: Bashkia Gramsh

Llogaria 401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò, në fund të vitit 2021 është në vlerën 0 lekë, paraqet gjendjen e faturave të pa likuiduara nga Bashkia më 31.12.2021. Lëvizja e llogarisë 401-408 ñFurnitorë e llogari të lidhura me toò, paraqitet në tabelën si me poshtë:

Llog. 401-408 ñFurnitorë e llogari te lidhura me toò	
Çelje e vitit 2021	0
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	0
Gjendja në 31.12.2021 (K)	0

Burimi: Bashkia Gramsh

Gjendja e llogarisë 401-408 përbëhet nga fatura të pa likuiduara për detyrime të muajit dhjetor, por që likuidohen në vitin pasardhës.

Llogaria 42, ñDetyrime ndaj personelitò, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë Bashkisë, paraqitet në vlerën 14,527,050 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit Dhjetor për tôu paguar në muajin Janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431, ñDetyrime ndaj shteti për tatim taksaò, paraqitet në vlerën 934,533 lekë dhe përfaqëson vlerën për tôu paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për periudhat e kaluara si dhe detyrimet e muajit Dhjetor 2021 të cilat do të paguhen në periudhën pasardhëse.

Llogaria 435, ñSigurime shoqëroreò dhe llogaria 436 ñSigurime shëndetësoreò paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit Dhjetor 2021 si dhe detyrimet e viteve të kaluara përkatësisht në vlerat 4,368,634 lekë dhe 599,255 lekë.

Llogaria 466 ñKreditore për mjete nën ruajtjeò, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 41,799,735 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%.

Llog. 466 "Kreditorë për mjete në ruajtje"	
Celje e vitit 2021	32,412,694
Shtesa	14,217,352
Pakësime	(4,830.311)
Gjendja në 31.12.2021	41,799,735

Burimi: Bashkia Gramsh

Kjo shumë është e njëjtë me tepricën për të cilën ne kemi bërë rakordimin e llogarisë 520.
Një kopje të raporteve të llogarisë 466 dhe nën llogarive përkatëse jepet në aneks.
Paraqiten faturat e pa likuiduara, vendime gjyqësore, investime dhe shërbime të cilat nuk bëhen hyrje dhe për vitin 2021 paraqiten në shumën 32,995,914 lekë. Lëvizja e kësaj llogarie gjatë vitit 2021 paraqitet si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	
Gjendja në 01.01.2021	20,412,471
Shtesa gjatë vitit 2021 (d)	19,453,829
Pakësime gjatë vitit 2021 (k)	(6,870,386)
Gjendja në 31.12.2021	32,995,914

Burimi: Bashkia Gramsh

Vlera e kësaj llogarie në shumën 32,995,914 lekë, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor.
Sqarojmë se ne detyrimet e periudhave te mëparshme janë përfshirë edhe detyrime të krijuara në periudhën dhjetor 2021, ne vlerën 19,024,060.
Vlera detyrimeve e detyrimeve te mbartura nga vitet e kaluara është (32,995,914-19,024,060)=13,971,854 lekë.
Pra gjatë vitit 2021 ka patur një pakësim të kësaj llogarie, pasi janë likuiduar një pjesë e Llogaria 85 ñRezultati i ushtrimitò, paraqitet me tepricë kreditore në vlerën 94,038,064 lekë dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Ajo është e barabartë me vlerën e të ardhurave që Bashkia trashëgon për tôu përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me degën e thesarit mbi fondet që trashëgohen.

Pasqyra e Performancës financiare (F2)
-Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të Bashkisë më datë 31.12.2021 janë të kuadruara me Degën e Thesarit, konkretisht:

Rakordimi të ardhurave

Emërtimi	Vlera sipas Pasqyrës së Performancës
Të ardhurat e krijuara gjatë vitit	77,903,244
Granti nga buxheti	861,633,559
Financim i pritshëm nga buxheti	
Totali të ardhurave	939,536,803

Burimi: Bashkia Gramsh

Rakordimi i Shpenzimeve

Emërtimi	Sipas Situacionit	Sipas Pasyrës së Performancës
600	210,451,993	211,787,466
601	34,874,099	35,109,193
602	124,929,609	124,929,609
604	11,933,897	11,933,897
606	459,881,443	459,881,443
63		1,857,131
Totali	842,071,041	845,498,739

Burimi: Bashkia Gramsh

-Diferenca në shumën 3,427,698 lekë midis shpenzimeve të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe sipas Situacionit përbëhet nga diferenca e vlerës prej 1,857,131 lekë "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" dhe vlerës prej 1,570,567 lekë "ndryshimi i detyrimeve për pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe detyrimet për taksat e muajit dhjetor 2020 dhe dhjetor 2021.
-Në fund të vitit ushtrimor të dy llogaritë e klasës 6 ñshpenzimetò dhe klasës 7 ñtë ardhuratò, janë mbyllur duke debituar dhe kredituar respektivisht llogarinë 85 ñRezultati i veprimtarisë ushtrimoreò, konkretisht:

Rakordimi të ardhura, shpenzime dhe rezultati

	Emërtimi Burimi	Pasqyra	Situacioni	Diferenca
I	Totali të ardhura	939,536,803	939,536,803	0
II	Shpenzime	845,498,739	842,071,041	3,427,698
III	Rezultati i vitit ushtrimor	94,038,,064	97,465,762	3,427,698

Burimi: Bashkia Gramsh

-Në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, llogaria 85 "Rezultati nga veprimtaria" paraqitet në shumën 94,038,064 lekë, e njëjtë me Pasqyrën e Performancës Financiare.
Pasqyra e flukseve monetare (F3)

Pasqyra e Flukseve Monetare, paraqet rrjedhën e likuiditeteve dhe gjendjen më datë 31.12.2021.

Nr. Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(b)	(c)	(1)	(2)
I	Veprimtaritë e shfrytëzimit	11,579,009	11,177,836
II	Veprimtaritë e investimeve	30,095,718	17,174,878
III	Transferta e të tjera	(1,699160)	(71,300)
IV	Teperica në fillim të vitit ushtrimor	95,862,232	67,580,818
V	Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor	135,837,799	95,862,232

Burimi: Bashkia Gramsh

-Nga kontrollet e kryera rezultoi se teprica e llogarisë së likuiditeteve më datë 31.12.2021, e paraqitur në këtë pasqyrë rezulton në shumën 135,837,799 lekë dhe kuadron me tepricën e likuiditeteve të paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, në Aktiv "Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre" e cila paraqitet në shumën 135,837,799 lekë.
Plotësimi i Pasqyrës së Flukseve monetare është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.6 ñRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të flukseve monetareò.

Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4)

		Fonde baze		Fonde te	Rezultatet	Rezultatet	GJITHESEJ
Reference	E M E R T I M I	dhe Grante	Rezerva	Tjera	e Mbartura	e Ushtrimit	Aktive/neto
		Kapitale		te veta	Teprice/Deficit	Teprice/Deficit	Fonde/ Neto
B	C	1	2	3	4	5	6
101	I.AKTIVET NETO/FONDET NETO	2,684,368,413			-	-	2,684,368,413
	II.NDRYSHIMET NE AKTIVET/ FONDET NETO(1+2)	63,449,538	-	144,609,089	-	28,731,395	236,790,022
	1.NGA BURIME TE BRENDSHME	63,449,538	-	144,609,089	-	28,731,395	236,790,022
105,	Nga grantet e brendshme kapitale(+)			309,133,447		-1,857,131	307,276,316
1016, 1059	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0		4,201,620			4,201,620
12	Nga Rezultatet e mbartura(+,-)	0	0				0
85	Nga Rezultatet e vitit ushtrimor(+,-)	63,449,538				30,588,526	94,038,064
1013	Nga konsumi i AAGJ(-)	0		- 166,297,980	0	-	-166,297,980
1015	Nga nxjerrjet jashtë përdorimit dhe dëmtimet(-)	0		- 2,427,998			-2,427,998
	2.NGA BURIME TE JASHTME	0	0	-	0	-	0
106,	Nga grantet e Jashtme kapitale(+)	0					0
1016, 1069	Nga Transfertat e brendshme te AAGJ, Dhurata ne natyre, (+,-)	0					0
	TOTALI I FONDEVE TE VETA(I+II)	2,747,817,951	0	144,609,089	0	28,731,395	2,921,158,435

Burimi: Bashkia Gramsh

-Nga verifikimi i kryer rezultoi se vlera totale e Aktiveve neto/fonde neto të paraqitura në "Pasqyrën e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto", është e barabartë me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e "Pozicionit financiar", në shumën 2,921,158,435 lekë. Në këtë pasqyrë janë paraqitur saktë grantet bazë (çelja e vitit), rezultati i vitit të mëparshëm si dhe rezultatet e ushtrimit.
-Vlera prej 313,335,067 lekë, përfaqëson gjithë shtesat e aktiveve neto/fonde neto gjatë vitit ushtrimor, të pasqyruara në të njëjtën vlerë edhe në Librin e madh në kredi të llogarisë 101 "Fonde bazë".
-Vlera prej 1,66,297,980 lekë, përfaqëson amortizimin vjetor.
-Vlera prej 2,427,998 lekë, përfaqëson nxjerrjet nga përdorimi te mjeteve te transportit.
-Vlera prej 94,038,064 lekë, përfaqëson rezultatin financiar të vitit ushtrimor pasqyruar në llog. 85 dhe llog. 12.
-Nga auditimi rezultoi se fondet neto të pasqyruara në Pasqyrën "Ndryshimi në fondet neto/aktivet neto" në shumën 2,921,158,435 lekë kuadron me pasqyrimin e tyre në pasqyrën e "Pozicionit financiar".
Plotësimi i Pasqyrës së Aktiveve neto/Fonde neto është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019, Kapitulli III, pika 3.5 ñRregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të ndryshimeve në Aktivet neto/Fondet netoò.

2.4 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

1. Auditimi i fundit në Bashkinë Gramsh

Auditimi i fundit në Bashkinë Gramsh është kryer në vitin 2021 për periudhën 01.01.2019-31.12.2020, raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar me shkresën 867/20 datë 05.01.2022. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se, në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej:
- 14 masa organizative, pranuar nga subjekti;
- 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,544,806 lekë, pranuar nga subjekti.
- 1 (një) masë në kundërshtim me principet e 3 E-të, me vlerë 119,431,000 lekë, pranuar nga subjekti;
- 5 masa mungesë të ardhurash në shumën 51,862,113 lekë, pranuar nga subjekti.

2. Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Në zbatim të ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 15, germa j ñhartimi i planit të veprimit për zbatimin e rekomandimeve brenda 20 ditëve nga marrja e raportit përfundimtar të auditimitò, Bashkia Gramsh për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguara me shkresën nr. 53/2 datë 27.01.2022 ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 867/20 datë 05.01.2022, pra brenda afatit ligjor të kthimit të përgjigjes prej 20 ditësh. Bashkia Gramsh ka hartuar Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse sipas llojit të rekomandimit.

3. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës 867/20 datë 05.01.2022 për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve nuk është plotësuar ende afati 6 mujor për të raportuar lidhur me plotësimin e

përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetitò, neni 30, pika 2, ñ*Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna*ò. Raportimi 6 mujor mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve është dërguar në KLSH brenda afateve ligjore.

Titulli i gjetjes 16: *Mos raportim në KB mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së.*

Situata:

4. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH

Sikurse është cituar më lart, Bashkia Gramsh ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 867/20, datë 05.01.2022, *por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak* mbi rezultatet e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 50, pika 5, *"Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij"*.

Kriteri: Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 50, pika 5.

Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit sjell që disa aktivitete në Bashkinë Gramsh të kryhen në kundërshtim me përcaktimet ligjore dhe të kenë ndikime financiare në vijimësi.

Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Gramsh.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

5. Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit në Bashkinë Gramsh

Në përfundim të auditimit janë rekomanduar masat si vijon:

Masa organizative

Në auditimin e fundit KLSH i ka rekomanduar Bashkisë Gramsh 16 masa organizative, të cilat janë pranuar plotësisht.

1. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 buxheti është realizuar në masën 90 % ose nga 1,041,130 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 940,311 mijë lekë, me mosrealizim për vlerën 100,819 mijë lekë, ndërsa për vitin 2020 buxheti është realizuar në masën 93 % ose nga 1,154,093 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 1,076,656 mijë lekë, me mosrealizim për vlerën 77,437 mijë lekë.

Në zërin investime, buxheti për vitin 2019 është realizuar në masën 75% ose nga 298,970 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 223,508 mijë lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 13,395 mijë lekë ose 0.5% të vlerës së investimit, për vitin 2020 është realizuar në masën 84% ose nga 313,956 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 263,073 mijë lekë, nga të cilat financim me grant dhe të ardhurat e veta në vlerën 6,413 mijë lekë ose 0.2%.

Të ardhurat e veta, për vitin 2019 të ardhurat nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar për vlerën 85,409 mijë lekë në fakt ato janë realizuar për vlerën 53,976 mijë lekë, më pak për vlerën 31,433 mijë lekë, për vitin 2020 të ardhurat nga taksat e tarifat vendore janë planifikuar për vlerën

87,346 mijë lekë në fakt ato janë realizuar për vlerën 66,485 mijë lekë, më pak për vlerën 20,861 mijë lekë. Veprime dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò të ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 ñPër vetëqeverisjen vendoreò, UMF nr. 10, datë 28.02.2017, ñPër përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020ò, si dhe UMF nr. 10/1, datë 28 02 2017 ñPër përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendorò; Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, ñPër procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëmò dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

1.1 Rekomandim: Në mënyrë që të mos krijohen diferenca të dukshme midis parashikimit dhe realizimit të buxhetit, Bashkia Gramsh të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se totali i faturave të pa likuiduara në fund të vitit 2020, të llogarisë 486 *"Shpenzime të periudhave të ardhshme"*, llogarisë (401-408) *"Furnitor e llogari të lidhura me to",* detyrime të tjera në llogarisë (467) *"Kreditorë të ndryshëm",* paraqitet në vlerën 39,187,378 lekë, ose 4% e vlerës së buxhetit të vitit 2020.

Me datë 30.06.2021, konstatohet se totali i faturave të pa likuiduara, të llogarisë 486 *"Shpenzime të periudhave të ardhshme",* llogarisë (401-408) *"Furnitor e llogari të lidhura me to",* detyrime të tjera në llogarisë (467) *"Kreditorë të ndryshëm",* paraqitet **në vlerën 20,412,472 lekë,** në totalin e tyre Vendime Gjykate janë për vlerën **8,000,000 lekë.**

Sa më sipër nga Drejtoria e Financës nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr.2 datë 06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të Buxhetitò i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 ñPër financat e Vetëqeverisjes Vendoreò neni 40, 48.

2.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime **në vlerën 20,412,472 lekë**, duke ndjekur radhën e pagesave. Nuk duhet të fillojnë procedura të reja pa mundësuar lidhjen e kontratave të vjetra.

2.2 Rekomandim: Drejtoria e Financës të bashkëpunojë me sektorin e zbatimit të kontratave, me qëllim kontabilizimin në kohë të faturave të lëshuara nga të tretët sipas kërkesave të VKM nr. 783, datë 22.11.2006 ñPër përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabëlò.

3. Gjetje nga auditimi: KLSH ka konstatuar se në gjendjen e *llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm"* nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore në vlerën **43,453,558 lekë** si dhe gjendja e debitorëve për ñdhënien me qiraò e lidhura për objekt për banim dhe objekt biznesi në vlerën **6,488,455 lekë** e akumuluar në fund të vitit ushtrimor 2020, pasi kjo vlerë nuk është kontabilizuar. Këto detyrime duhet të jenë pjesë e detyrimeve të subjekteve ndaj shtetit. Nuk është kryer kontabilizimi i të ardhurave dhe përfshirja ne formatin e performancës financiare të PF i të ardhurave të krijuara është bërë nga evidencat e mbajtura (data baze) nga Drejtoria e taksave dhe tarifave Vendore, ku janë evidentuar të ardhurat sipas llojit në përputhje me klasifikimin e klasës 7 të llogarive.

3.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve për taksat dhe tarifat në llog. 468 debitorë të ndryshëm, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të

mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që PF të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

4. Gjetje nga auditimi: KLSH konstatoi se, gjendja e llogarisë 202 *"Studime dhe Kërkime"* paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 14,043,607 lekë, dhe në mbyllje të vitit 2019 në vlerën 15,584,931 lekë. Diferenca e vitit ushtrimor 2020 me atë paraardhës prej 1,541,324 lekë përfaqëson vlerën e amortizimit prej 15 % e zbritur nga vlera e mbetur gjendje në fund të vitit 2019 në vlerën 2,478,284 lekë si edhe shtesat e krijuara gjatë vitit 2020 në vlerën 936,960 lekë. Vlera e mbetur në fund të vitit 2020 prej 14,043,607 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Kjo vlerë e cila i përket 112 projekt-studimeve nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme.

4.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës së studim-projektimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostossë tij, duke kredituar llog. 202 ñStudime dhe Kërkimeò dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë.

5. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2019 dhe 2020 nga auditimi i procedurës se mbajtjes dhe kontabilizimit te aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore por njësia nuk dispononte një **regjistër analitik aktivesh sipas formatit.**

5.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të kryejë veprimet për krijimin dhe mbajtjen e një regjistri analitik aktivesh sipas formatit**,** ku duhet të përmbajë: datën e hyrjes ose marrjen në dorëzim, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, datën e daljes nga pronësia, në formë analitike.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Gramsh dhe për Njësitë Administrative. Në kolonën shënime nga komisioni nuk ka vlerësime të aktiveve të veçanta për gjendje jashtë përdorimi. Nuk është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të Titullarit për ngritjen e komisionit ñPër kryerjen e procesit të inventarizimitò. Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e titullarit ***nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve***, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve.

6.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh, komisionet e ngarkuara sipas urdhrave të Titullarit, të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në llogari të ndryshme për aktive të veçanta në tabelat e detajuara të aktiveve dhe llogaritjes së amortizimit sipas normave ligjore të amortizimit të përcaktuara, rezultoi se përllogaritjet nuk ishin bërë të sakta. Në vitin ushtrimor 2020 janë

kontabilizuar përllogaritjet e amortizimit të aktiveve jo material dhe material për vlerën 151,975,083 lekë dhe është debituar llog. 2012 ñkonsumi i aktiveve jo materialeò dhe llog. 1013 ñKonsumi i aktiveve materialeò në debi të llogarive: llog. 2190 ñAmortizim Studime projektimeò në vlerën 2,478,284 lekë, llog. 2192 ñAmortizim Ndërtesaò për vlerën 29,531,669, llog. 2193 ñAmortizim Rruge, kanalizimeò për vlerën 91,960,983 lekë, llog. 2194 ñAmortizim Makineri e pajisje, instrumente e veglaò në vlerën 706,120, llog. 2195 ñAmortizim Mjete transportiò në vlerën 15,657,773 dhe llog. 2198 ñAmortizim Inventar ekonomikò në vlerën 11,640,254 lekë.

7.1 Rekomandim: Nëpunësi Zbatues i Bashkisë Gramsh, të marrë masa për kryerjen e sistemimit kontabël, me qëllim pasqyrimin e drejtë të Aktiveve të Qëndrueshme të trupëzuara (AQT) në pasqyrën nr. 8 ñPasqyra e lëvizjes së fondeveò.

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i transaksioneve nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa me urdhër shpenzime mbi afatin 30 ditor të faturave për mallra dhe shërbime, në mosrespektim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, neni 52 në të cilën përcaktohet se: ñ*Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.”.*

8.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike e Bashkisë Gramsh, të marrë masa për kryerjen e likuidimeve te faturave, duke respektuar afatin 30 ditor pas paraqitjes së faturës dhe dokumentacionit justifikues nga operatorët ekonomikë.

9. Gjetje nga auditimi: Në auditimin e 10 procedurave me vlera të larta, kriteret janë të paargumentuara në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprime në kundërshtim me pikën 2 të nenit 61, të VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 ñPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò me ndryshime.

9.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë në cilësinë e Titullari i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Gramsh, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë një grup pune me specialist të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknik dhe kritereve sipas llojit të procedurës, duke dhënë argumente për secilin kriter dhe të bëhen pjesë e dosjes. Argumentimi të bëhet duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve, si dhe të synohet eliminimi i zhvillimit të procedurave me 1 OE, duke vendosur kritere sipas llojit të procedurës dhe dhënë argumente për secilin kriter në zbatim të akteve ligjore/nënligjore të LPP dhe sipas objekteve të prokuruar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 2768 Prot datë 29.07.2020, me objekt ñRikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekinò, me vlerë kontrate 82,960 mijë lekë, dhe kontratës nr. 1916, datë 18.03.2019, me vlerë kontrate 39,999 mijë lekë, u konstatua se nuk është dhënë leja e ndërtimit, në kundërshtim me Ligjin Nr. 107/2014 ñPër planifikimin dhe zhvillimin e territoritò, i ndryshuar, Neni 39, ñLeja e ndërtimitò.

10.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh të merren masa që para fillimit të punimeve, të shqyrtohen të dhënat teknike të objekteve të planifikuara për zbatim dhe të pajisen me lejen e ndërtimit, ku të përcaktohen me detaje kushtet e zbatimit të projektit.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 2768 Prot datë 29.07.2020, me objekt ñRikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekinò, me vlerë kontrate 82,960 mijë lekë, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor nuk janë marrë masa për marrjen e oponencës teknike, në

kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, ñPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, i ndryshuar, neni 6.

11.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh, të merren masa që për objektet me vlerë të preventivuar mbi 100 milion lekë, të kërkohet oponenca teknike nga institucionet e ngarkuara me ligj, me qëllim që projektet të jenë sa më cilësorë dhe lehtësisht të zbatueshëm nga shoqëritë sipërmarrëse.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike të zbatimit të punimeve civile të kontratës me nr. 6093 Prot., datë 01.10.2019, me objekt ñRikonstruksion i rrjetit të brendshëm të ujësjellësit të qytetit Gramshò, me vlerë kontrate 184,348 mijë lekë, u konstatua se punimet nuk kanë mbaruar në afat, në kundërshtim me kontratën e punimeve civile, duke mos arritur në kohë qëllimin për të cilin është planifikuar të ndërtohet ky objekt.

12.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh, të analizohet mosrealizimi në kohë i këtij objekti, të nxirren përgjegjësitë dhe të zbatohen penalitetet sipas kontratës së punëve civile për këtë objekt, për çdo ditë vonesë në dorëzimin e punimeve.

13. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Bashkia Gramsh nuk ka bërë të mundur që pas bashkimit me ish-Komunat sot Nj/ Administrative të saj për pronat e transferuara të kryej procesin e regjistrimit në ZVRPP, ngritjen e komisionit për vlerësimin e pasurive me çmimin e tregut të si: truall, tokë bujqësore, ndërtesa, pyje, kullota etj., me qëllim vënien e këtyre pronave në eficencë për dhënien e tyre me qira për realizimin e të ardhurave nga qiradhënia e tyre dhe për dy Nj/Administrative Tunjë dhe Kukur nuk ka përgatitur dokumentacionin ligjorë për miratimin e listës përfundimtare, të pronave për to.

-Në lidhje me tokat bujqësore, rezulton se ASHK nuk ka vijuar me regjistrimin e tyre, pasi VKM-të me anë të së cilës pronat i janë transferuar Bashkisë në pronësi ose në përdorim, janë të përmbledhura në një numër të vetëm rendor, dhe jo me numra specifikë që ato kanë.

Bashkia Gramsh, në përputhje me nenin 37 pika 1 të ligjit nr. 20/2020 ñPër përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, Kreu IV ñPërditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike, shtetëroreò, ka ngritur urdhrin e punës me nr. 52, datë 23.02.2021 ñPër ngritjen e grupit të punës për përditësimin, inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetëroreò.

-Sipas strukturës organizative, për vitin 2019, asetet mbuloheshin nga një specialiste e Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. Për vitin 2020, u krijua sektor për menaxhimin e aseteve me 3 punonjës, i ndryshuar në strukturën e vitit 2021 duke shkrirë sektorin e aseteve, duke vendosur specialiste në varësi të Drejtorisë Juridike.

13.1 Rekomandim: Komisioni përgjegjës për *"përditësimin, inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore"*, i ngritur në zbatim të urdhrit nr. 52, datë 23.02.2021, të marrë masa për përfundimin brenda afatit 18 mujor të detyrave të përcaktuara sipas urdhrit, kjo për të bërë të mundur regjistrimin pranë ASHK të tokave bujqësore (ara).

13.2 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike, të planifikojë për buxhetin e vitit 2022 fonde të dedikuara për regjistrimin e pronave të transferuara, të cilat disponojnë gjithë dokumentacionin e duhur ligjor.

13.3 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh, të vlerësojë mundësinë e krijimit të një sektori për menaxhimin e aseteve, kjo në përputhje me pikat 9, 10,11,13,14 dhe 21, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001ñPër inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendoreò dhe kreun III- *Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre* të UMF nr. 30 datë 27.12.2011ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

14. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se 68 subjekte për sipërfaqen prej 4882.6 m^2, përdorin këto objekte për qëllim biznesi dhe për banim. Bashkia Gramsh, për këto objekte për periudhën objekt auditimi ka lidhur 53 kontrata për sipërfaqen 3155 m^2 dhe 15 subjekte për sipërfaqen 1278 m^2, i përdorin këto objekte pa kontratë dhe Bashkia ka llogaritur të ardhura në buxhetin e saj. Përllogaritja e tarifës së qirasë për m^2, është bërë në bazë të VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò tabela A ñTarifat dysheme të qirasë mujore për ndërtesat sipas Prefekturave për lekë/m^2.

14.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike, Bashkia Gramsh, të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me 15 subjekte me sipërfaqe 1352.6 m^2 të cilët kanë në përdorim objekte në pronësi të Bashkisë Gramsh.

Masa për shpërblim dëmi

KLSH i ka rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Gramsh, 2 masa për shpërblim dëmi në vlerën 1,544,806 lekë.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ñRikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekinò, Bashkia Gramsh**,** me vlerë të kontratës (me TVSH) 99,552,818 lekë, fituar nga OE ñZ...ò SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera dhe likuiduar në vlerën 1,329,268 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 2768 Prot. datë 29.07.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe OE ñZ...ò SHPK.

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,329,268 lekë pa TVSH** nga shoqëria ñZ...ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2768 Prot., datë 29.07.2020, me objekt ñRikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekinò, Bashkia Gramsh, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me vlerë 47,999,596 lekë (me TVSH), fituar nga OE ñM...ò SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera dhe likuiduar në vlerën 215,538 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1916, datë 18.03.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gramsh dhe OE ñM...ò SHPK.

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **215,538 lekë pa TVSH** nga shoqëria ñM...ò SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1916, datë 18.03.2019, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Masa për uljen e borxhit tatimor

1. Gjetje nga auditimi: Nga puna e pa mjaftueshme e Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave Vendore në Bashkinë Gramsh, janë krijuar debitorë, të cilët në datën 31.12.2020 kanë vlerën progresive **43,453,558 lekë**, e ardhur e munguar për buxhetin e njësisë vendore, nga të cilat;

-57 subjekte të biznesit të madh dhe të vogël në vlerën 4,422,021 lekë,

-3937 familje debitorë për taksen e tokës bujqësore në vlerën 18,203,801 lekë,

-5700 familje debitorë për tarifat vendore në vlerën 14,433,781 lekë,

-Debitor qira objekti në vlerën 6,393,955 lekë..

Mos arkëtimi i plotë i detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përveçse është mos përmbushje e detyrimeve ligjore, sipas detyrës funksionale të punonjësve të kësaj strukture, krijon mungesa

financiare në buxhet dhe për pasojë ulë nivelin e investimeve dhe të shpenzimeve të tjera që njësia vendore ka parashikuar në favor të komunitetit. Mungesa e të ardhurave është ndikim i drejtpërdrejtë në mosrealizimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për periudhën 2019-2020.
Nga Bashkia Gramsh nuk janë ndjekur të gjithë procedurat e nevojshme ligjore në rend shterues, për arkëtimin e debitorëve, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò, nenet 89, 90, 91, të ligjit nr. 9920 òPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, dhe nenin 12 të Udhëzimit te Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore.

1.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurve Vendore të marrë masa për arkëtimin e detyrimeve në vlerën **43,453,558 lekë**. Për këtë, bazuar në nenin 70 pika 3 ñE drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimorò, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar, për të gjitha subjektet e private të nxjerrë njoftim vlerësimet tatimore dhe në vazhdim të marren masat për arkëtimin e këtij detyrimi, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a-Tu dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhrat e bllokimit të llogarive bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ò*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë".*

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në AKSH (për pasuritë e paluajtshme), bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò.

c- Për subjektet të cilët nuk kanë paguar detyrimet tatimore në afat, ndaj tyre të aplikohet llogaritja e gjobës në masën 0.06% të shumës së detyrimit të papaguar për çdo dit gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo më shumë se 365 ditë (gjobë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñ*Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò, të ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 15.12.2014**.**

d- Në rast se bizneset private edhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, pasi të merren masat administrative apo sekuestro, të **bëhet kallëzim penal**, bazuar në Kodin Penal i Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 ñMospagimi i taksave dhe tatimeveò.

e- Për debitorët familjar, në zbatim të udhëzimit plotësues të Ministrisë së Financave nr. 01, datë 17.01.2019 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2019ò, pika 98, të njoftojë nëpërmjet postës familjarët të cilët nuk kanë paguar detyrimet për taksën e tokës, të ndërtesave dhe tarifat familjare dhe të realizojë arkëtimin e detyrimit të miratuar nga Këshilli Bashkiak.

2. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i arkëtimeve të detyrimeve të qirasë për kontratat e lidhura rezultoi se, nuk kanë likuiduar detyrimet e kontratës 22 subjekte, për sipërfaqen 2147.6 m^2 në kundërshtim me nenin 5 ñPagesa dhe regjimi i sajñ të kontratave, në vlerën gjithsej ***6,591,955 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gramsh.*** Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 12 germa g, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 ñPër menaxhimin financiar dhe kontrollinò, të ndryshuar, me pikën 42, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ñPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, të ndryshuar dhe me nenin 5 ñPagesa dhe regjimi i sajñ të kontratave.

2.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike, Bashkia Gramsh, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor për kontratat e lidhura të qirave për objekte në vlerën **6,591,955 lekë.**

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për arkëtimin e vlerës së taksës për lëshimin e Autorizimeve / Licencave për subjektet e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm

të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë në zbatim të me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 ñPër përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të sajò i ndryshuar me VKM nr. 344, datë 19.04.2017, kapitulli II, pika 1; germa ñbò dhe pika 9 të Bashkisë Gramsh, për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 ku **konstatohet se:**
Në Bashkinë Gramsh ushtron aktivitet 1 subjekt debitor në vlerën **1,000,000 lekë,** konkretisht subjekti" S..." shpk me adresë fshati Koçaj, i cili nuk është pajisur me autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënien dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët.
3.1 Rekomandim: Bashkia Gramsh të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës 1,000,000 lekë nga subjekti ñS...ò shpk për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.
4. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, Bashkia Gramsh, për periudhën 01.01.2019-31.12.2020 ka vendosur 15 procesverbale gjobe, në vlerën prej 910,000 lekë nga të cilat janë arkëtuar 10 gjoba në vlerën 270,000 lekë, janë dërguar në gjykatë 2 kërkesë padi për 2 persona për kthimin e gjobës në titull ekzekutiv në vlerën 100,000 lekë, për 1 person është lidhur akt marrëveshje për likuidimin me këste për vlerën 50,000 lekë, i cili rezulton i pazbatuar për diferencën 41,600 lekë dhe për 1 person nuk është kryer asnjë veprim për arkëtimin e vlerës 500,000 lekë. Vlera **541,600 lekë** për 2 persona, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.
4.1. Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtës Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e 2 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 ñShndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutivò dhe neni 30 ñArkëtimi i shumave të detyrimeveò të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 ñPër kundërvajtjet administrativeò dhe arkëtimi i vlerës **541,600 lekë** e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.
5. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Gramsh, nuk është vepruar, për të arkëtuar tarifën e pastrimit, të ndriçimit dhe tarifën e gjelbërimit për subjektet e ndërtimit të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimit me fonde publike, për periudhën e auditimit 01.01.2019-31,12.2020. Subjektet debitorë ñA... Konstruksionò ShPK në vlerën 21,000 lekë, ñR... Companyò ShPK në vlerën 20,170 lekë, ñB...ò ShPK në vlerën 21,000 lekë, ñZ... Konstruksionò ShPK në vlerën 25,200 lekë, ñI...ò ShPK në vlerën 25,200 lekë, ñZ...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë, ñV... I...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë dhe ñB...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë sipas Vendimit të Këshillit të Bashkisë Gramsh nr. 99 datë 18.12.2018 dhe vendimit nr. 96 datë 30.12.2019 ñ*Për Miratimin e Paketës Fiskale*ò, dhe Ligji nr. 9920 datë 19.05.2008 ñ*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*ò i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe udhëzimit përkatës nr. 24, datë 02.09.2008 i ndryshuar 43.1. Këto subjekte janë debitorë në vlerën **275,000 lekë, gjë që ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Gramsh.**
5.1 Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës **275,000 lekë**, për subjektet debitorë ñA... Konstruksionò në vlerën 123,000 lekë, ñR... Companyò ShPK, në vlerën 20,170 lekë, ñB...ò ShPK, në vlerën 21,000 lekë, ñZ... Konstruksionò ShPK, në vlerën 25,200 lekë, ñI...ò ShPK në vlerën 25,200 lekë, ñZ...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë, ñV... Investò në vlerën 20,170 lekë dhe ñB...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë në kundërshtimin të ligjit nr.

9920 datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 43/1.

5.2 Rekomandim: Bashkia Gramsh, të marri masa për regjistrimin dhe hapjen e Nipt-eve sekondare për të gjitha subjektet që kanë fituar në procedurat e prokurimit publik por nuk kanë seli në Bashkinë Gramsh, në përputhje me nenin 43 pika 1/1 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò

Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimin e 22 procedurave me vlerë kontrate 641,698 mijë lekë, janë konstatuar me shkelje të akteve ligjore/nënligjore të LPP 9 procedura me vlerë kontrate 119,431 mijë lekë ose 18 % e vlerës së kontratave të lidhura, në të cilat ofertat ekonomike të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues, nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E-të) **119,431 mijë lekë**, **respektivisht**:

1- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Ndërtimi i tregut të qytetit"*, me fond limit 8,333 mijë lekë, me fitues BOE ñB...ò ShPK & ñM...ò ShPK me vlerë të ofertës 7,998 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **7,998 mijë lekë.**

2- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Sistemim asfaltim i lagjes Kocaj"*, me fond limit 41,666 mijë lekë, me fitues OE ñM...ò ShPK me vlerë të ofertës 39,999 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **39,999 mijë lekë.**

3- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i rrugëve në Njësitë Administrative"*, me fond limit 11,937 mijë lekë, me fitues BOE ñR... Companyò ShPK & ñM...ò ShPK me ofertë 11,379 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **11,379 mijë lekë.**

4- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Ndërtim ujësjellësa në NjA Skënderbegas dhe NjA Lenije"*, me fond limit 6,249 mijë lekë, me fitues OE ñB...ò ShPK me ofertë 6,027 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **6,249 mijë lekë.**

5- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Rikonstruksion i kanalit ujitës Galigat – Cingar Sipër - Drizë"*, me fond limit 28,043 mijë lekë, me fitues BOE ñAl-M...ò ShPK & ñB... N...ò ShPK me ofertë 27,202 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **27,202 lekë.**

6- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Ndërtim trotuari nga kisha katolike në fshatin Pishaj"*, me fond limit 9,996 mijë lekë, me fitues BOE ñG... Z...ò ShPK & ñV... Konstruksionò ShPK me ofertë 9,515 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **9,515 mijë lekë.**

7- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Blerje dru zjarri për nevojat e çerdheve, kopshteve, shkollave dhe konviktit të shkollës së mesme për vitin shkollor 2020-2021 si dhe zyrat e njësive administrative"*, me fond limit 5,819 mijë lekë, me fitues OE ñI...ò ShPK me ofertë 5,781 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **5,781 mijë lekë.**
8- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet të varfra dhe të pa favorizuara"*, me fond limit 5,479 mijë lekë, me fitues OE ñZ... Konstruksionò ShPK me ofertë 5,469 mijë lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **5,469 mijë lekë.**
9- Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt *"Ndërtim i varrezave të qytetit"*, me fond limit 8,328 mijë lekë, me fitues OE ñI...ò ShPK me ofertë 6,056 lekë, ku ka rezultuar se KVO ka vlerësuar dhe shpallur fituesin në kushtet e mos plotësimit të kërkesave për kualifikim të DT, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike për vlerën **6,056 lekë.**
Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ñPër prokurimin publikò, i ndryshuar, neni 1 ñObjekti dhe qëllimiò pika 2, shkronja (a), (b), (d) dhe (dh), neni 2 ñParimet e përzgjedhjesò shkronja (a), (b) dhe (c), nenin 46 ñKualifikimi i ofertuesveò pika 1, dhe nenin 55 ñShqyrtimi i ofertaveò pika 3.
1.1. Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh, të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë prokurim të fondeve publike pa ekonomicitet, eficencë dhe efektivitet (3-E$^{-të}$), **119,431 mijë lekë** pa TVSH.

Titulli i gjetjes 17: *Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e fundit.*
Situata: Raporti përfundimtar dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Gramsh me shkresën 867/20 datë 05.01.2022, pra nuk janë bërë ende 6 muaj nga data e dërgimit. Pavarësisht afatit grupi i auditimit zhvilloi auditimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i fundit i KLSh-së ku rezulton se, nga Bashkia Gramsh kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve. Përkatësisht:
- Është nxjerrë urdhri nr. 09, datë 12.01.2022 ñPër marrjen e masave organizative dhe për shpërblim dëmi referuar Raportit Përfundimtar të KLSH-sëò, duke ngarkuar strukturat përkatëse dhe personat përgjegjës për të marrë të gjitha masat e nevojshme më qëllim zbatimin e rekomandimeve.
Masa organizative
2.2 Rekomandim: *Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës, në mbledhjet e Këshillit Bashkiak për miratimin e buxheteve vjetore, të paraqes një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, dhe të hartojë grafik për shlyerjen e detyrime* ***në vlerën 20,412,472 lekë****, duke ndjekur radhën e pagesave. Nuk duhet të fillojnë procedura të reja pa mundësuar lidhjen e kontratave të vjetra.*
- Është hartuar plani i shlyerjes së stokut për tre vitet në vijim ku për vitin 2022 është planifikuar të likuidohet vlera 5,000,000 lekë në zbatim të masës organizative 2.1. **Në proces.**
12.1. Rekomandim: *Nga Bashkia Gramsh, të analizohet mosrealizimi në kohë i këtij objekti, të nxirren përgjegjësitë dhe të zbatohen penalitetet sipas kontratës së punëve civile për këtë objekt, për çdo ditë vonesë në dorëzimin e punimeve.* **Rekomandimi është zbatuar.**

Fondet për realizimin e objektit dhe mbikëqyrjes së objektit" "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh", janë financuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve"(AKUM). Lidhur me kolaudimin e objektit nga komunikimet me AKUM-in me shkresën nr. 1309 Prot. datë 15.06.2021 "Mbi kolaudimin e objekteve nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve", AKUM-i njofton se do të marrë masat për procesin e kolaudimit të punimeve të objektit. Për këtë arsye Bashkia Gramsh nuk ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt kryerjen e shërbimit të kolaudimit. Me shkresën nr. 1886 Prot. datë 04.10.2021 AKUM-i udhëzon që kolaudimi i objekteve të realizohet nga vetë Autoritetet Kontraktore. Pas kësaj shkrese, nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Gramsh, u zhvillua procedura e prokurimit me objekt "Kolaudimi i punimeve në objektin "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh", dhe pas përfundimit të tyre është lidhur kontrata e kolaudimit nr. 4401 datë 22.11.2021 me kolaudatorin "...& .... Construksion" shpk.

13.1 Rekomandim: *Komisioni përgjegjës për "përditësimin, inventarizimin, transferimin dhe regjistrimin e pronave të paluajtshme publike, shtetërore", i ngritur në zbatim të urdhrit nr. 52, datë 23.02.2021, të marrë masa për përfundimin brenda afatit 18 mujor të detyrave të përcaktuara sipas urdhrit, kjo për të bërë të mundur regjistrimin pranë ASHK të tokave bujqësore (ara).* **Në proces.**

13.2 Rekomandim: *Drejtoria Ekonomike, të planifikojë për buxhetin e vitit 2022 fonde të dedikuara për regjistrimin e pronave të transferuara, të cilat disponojnë gjithë dokumentacionin e duhur ligjor.* **Nuk është zbatuar.**

13.3 Rekomandim: *Kryetari i Bashkisë Gramsh, të vlerësojë mundësinë e krijimit të një sektori për menaxhimin e aseteve, kjo në përputhje me pikat 9, 10,11,13,14 dhe 21, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001"Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" dhe kreun III- Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes se tyre të UMF nr. 30 datë 27.12.2011"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".*

- Rekomandimi është **zbatuar**. Me Vendimin nr. 15, datë 18.02.2022 për ñMiratimin e Strukturës Organizative për Bashkinë Gramsh dhe Njësive Vartëse të saj për vitin 2022ò është ngritur Sektori Juridik dhe i Aseteve në zbatim të masës organizative 13.3.

14.1 Rekomandim: *Drejtoria Juridike, Bashkia Gramsh, të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me 15 subjekte me sipërfaqe 1352.6 m^2 të cilët kanë në përdorim objekte në pronësi të Bashkisë Gramsh.*

- Janë lidhur 10 kontrata për asetet e dhëna me qira me personat që kishin në përdorim asetet e bashkisë mbeten ende për tâu lidhur edhe 5 kontrata qiraje, në zbatim të rekomandimit 14.1 të masave organizative. **Në Proces.**

Masa për shpërblim dëmi

1.1. Rekomandim: *Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej* ***1,329,268 lekë pa TVSH*** *nga shoqëria "Z..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 2768 Prot., datë 29.07.2020, me objekt "Rikonstruksion i rrugës fshati Çekin dhe zëvendësimi i tubacionit kryesor të Ujësjellësit Çekin", Bashkia Gramsh, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

2.1. Rekomandim: *Nga Bashkia Gramsh të merren masa për arkëtimin e vlerës prej* ***215,538 lekë pa TVSH*** *nga shoqëria "M..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1916, datë 18.03.2019, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

- Janë njoftuar për të shlyer detyrimin OE ñZ...ò ShPK me shkresën nr. 324 Prot, datë 26.01.2022 për shumën 1,329,268 lekë dhe OE ñM...ò ShPK, me shkresën nr. 325 Prot, datë 26.01.2022 për shumën 215,538 lekë. **Në proces.**

Masa për uljen e borxhit tatimor

2.1 Rekomandim: *Drejtoria Juridike, Bashkia Gramsh, të marrë masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimit kontraktor për kontratat e lidhura të qirave për objekte në vlerën* ***6,591,955 lekë.***

- Janë marrë masa për të paguar detyrimet nga kontratat e qirave, përkatësisht për 22 subjekte me vlerë të detyrimit 6,591,955 lekë kanë paguar detyrime të pjesshme ose të plota 15 subjekte me vlerë totale 597,675 lekë dhe mbeten ende për tâu arkëtuar 5,949,280 lekë, në zbatim të rekomandimit 2.1 për marrjen e masave për uljen e borxhit. **Në proces.**

3.1 Rekomandim: *Bashkia Gramsh të marri masa të menjëhershme për arkëtimin e shumës 1,000,000 lekë nga subjekti "S..." ShPK për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë.*

- Është lidhur akt marrëveshja me nr. 4541/1 Prot, datë 07.12.2021 me subjektin ñS...ò ShPK lidhur me pagesën e detyrimit për pajisjen me autorizim/licencë për tregtimin me pakicë të lëndëve djegëse në vlerën 1,000,000 lekë. Pagesa do të bëhet me 4 këste ku kësti i parë në shumën 400,000 lekë është paguar në momentin e lidhjes së marrëveshjes ndërsa kështet e tjera me vlerë prej 200,000 lekë secili do të paguhen për tri vitet në vijim. Afati i llogaritjes së licencës ka filluar që nga data 11.12.2020 datë kur duhej të bëhej rinovimi, në zbatim të rekomandimit nr. 3.1 për marrjen e masave për uljen e borxhit. **Zbatuar.**

4.1. Rekomandim: *Inspektorati i Mbrojtës Territorit (IMT) në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Gramsh, të kërkojë në Gjykatë, shndërrimin e 2 vendimeve të kundërvajtjes në titull ekzekutiv në përputhje me nenin 24 "Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv" dhe neni 30 "Arkëtimi i shumave të detyrimeve" të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative" dhe arkëtimi i vlerës* ***541,600 lekë*** *e cila përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Gramsh.*

- IMTV ka dërguar pranë Gjykatës Administrative Durrës kërkesën për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për subjektin H... L... me vlerë gjobë 500,000 lekë, shkresa nr. 249 Prot, datë 20.01.2022 si dhe ka njoftuar subjektin Z... G... për shlyerjen e detyrimit të gjobës me vlerë 41,600 lekë. **Në proces.**

5.1. Rekomandim: *Bashkia Gramsh të marrë masa të menjëhershme për arkëtimin e vlerës* ***275,000 lekë****, për subjektet debitorë "A... Konstruksion" në vlerën 123,000 lekë, "R... Company" ShPK, në vlerën 20,170 lekë, "B..." ShPK, në vlerën 21,000 lekë, "Z... Konstruksion" ShPK, në vlerën 25,200 lekë, "I..." ShPK në vlerën 25,200 lekë, "Z..." ShPK në vlerën 20,170 lekë, "V... Invest" në vlerën 20,170 lekë dhe "B..." ShPK në vlerën 20,170 lekë në kundërshtimin të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 43/1.*

- Kanë paguar detyrimin në vlerën 213,660 lekë për afatin e kontratës së investimit 5 subjekte debitorë: ñA... Konstruksionò në vlerën 123,000 lekë, ñZ... Konstruksionò ShPK, në vlerën 25,200 lekë, ñI...ò ShPK në vlerën 25,200 lekë, ñV... Investò në vlerën 20,170 lekë dhe ñR... Companyò ShPK, në vlerën 20,170 lekë, nuk kanë paguar detyrimet në vlerën **61,340 lekë** 3 operatorë ñB...ò ShPK, në vlerën 21,000 lekë, ñZ...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë, dhe ñB...ò

ShPK në vlerën 20,170 lekë, në zbatim të rekomandimit 5.2 për marrjen e masave për uljen e borxhit. **Në proces.**

Në përfundim rezulton se:
- **Janë zbatuar gjithsej 3 rekomandime**, 2 rekomandime organizative (12.1 dhe 13.3) dhe 1 rekomandim për marrjen e masave për uljen e borxhit, (3.1).
- **Nuk janë zbatuar 2 rekomandime,** 1 organizativ, përkatësisht me numër 13.2 dhe pika E lidhur me vlerësimin e shkeljeve dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse.
-**Janë në proces zbatimi 8 rekomandime**, 3 rekomandime organizative 2.2, 13.1, 14.1 dhe 2 rekomandime për shpërblim dëmi, 1.1 dhe 1.2 dhe 3 rekomandime për uljen e borxhit, 2.1,4.1 dhe 5.1.
- Lidhur me rekomandimet e tjera referuar afateve të zbatimit dhe çështjeve që adresojnë janë trajtuar gjatë auditimit të pikave të programit të auditimit sikurse janë rekomandimet që lidhen me hartimin e pasqyrave financiare, rekomandimeve që lidhen me uljen e borxhit tatimor apo rekomandime që duhet të mbahen parasysh në vijimësi gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi, K. T. me detyrë Kryetar i Bashkisë Gramsh, z. A. Sh. me detyrë Sekretar i Përgjithshëm. z. A. Sh. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, z. A. J. me detyrë Drejtor i Tatim Taksave, znj. Dh. Ç. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Aseteve dhe z. E. H. me detyrë Kryeinspektor i IMTV-së Gramsh.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2914 ñPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetitò, neni 15, germa j dhe neni 30 pika 2.
Ndikimi: Mos zbatimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e fundit ka sjellë mungesë të ardhurash në Bashkinë Gramsh.
Shkaku: Mos angazhim sa duhet i strukturave të Bashkisë Gramsh.
Rëndësia: E lartë
Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat si dhe të vijoj me ndjekjen e masave që ka marrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH si vijon:
- Të lidhë kontratat e qirasë me personat që kanë në përdorim asetet e bashkisë;
- Të ndjekë të gjitha hapat ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve nga OE ñZ...ò për shumën 1,329,268 lekë dhe OE ñM...ò ShPK, për shumën 215,538 lekë;
- Të marrë masa për të paguar detyrimet nga kontratat e qirave, me vlerë totale **5,949,280 lekë;**
- Të ndjekë të gjitha hapat ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve në vlerën **61,340 lekë** nga operatorët ñB...ò ShPK, në vlerën 21,000 lekë, ñZ...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë, dhe ñB...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë.

Për sa është trajtuar më sipër, nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Gramsh me shkresën nr. 2332/1 Prot, datë 28.06.2022 është paraqitur observacioni i administruar në KLSH me nr. 376/4 Prot, datë 29.06.2022 si më poshtë:

Pretendimet e subjektit:

Në pikën 12.1 të rekomandimeve, është kërkuar: "Nga Bashkia Gramsh, të analizohet mosrealizimi në kohë i këtij objekti, të nxirren përgjegjësitë dhe të zbatohen penalitatet sipas kontratës së punëve civile për këtë objekt, për çdo ditë vonesë në dorëzimin e punimeve, për objektin "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh", sqarojmë se ky rekomandim është përmbushur, duke argumentuar si më poshtë:

- Së pari, në kohën e zhvillimit të auditimit për periudhën 01.01.2019-31.12.2020, dosja e zbatimit të projektit nuk ka qenë dorëzuar në Bashkinë Gramsh, nga ana e mbikëqyrësit të punimeve. Dosja e zbatimit është dorëzuar pas përfundimit të auditimit dhe Bashkia Gramsh, ka dorëzuar dokumentacionin dhe kundërshtimet përkatëse pranë audituesve.

- Më datë 01.10.3019 është lidhur kontrata e punëve civile me objekt "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh", nr. 6093 Prot. datë 01.10.2019 mes palëve: Bashkia Gramsh dhe BOE "M... " ShPK & "A... Konstruksion" ShPK, përfaqësuar me prokurë nga "M..." ShPK me prokurën nr. rep. 4470, nr..kol..1697 datë 07.09.2019. Afati për kryerjen e punimeve është 365 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Më datë 02.10.2019 është bërë dorëzimi i sheshit të ndërtimit, piketimi i objektit proces verbali për fillimin e punimeve dhe njoftimi për fillimin e punimeve.

- Më datë 15.09.2020, mbikëqyrësi i punimeve "A... MK" ShPK ka bërë kërkesë për shtyrjen e afatit të punimeve, me 90 ditë, me afat përfundimi më 31.12.2020. Më datë 19.10.2020 është lidhur amendament kontrate nr. 6093/5 Prot, me afat përfundimi më datë 31.12.2020. Më datë 24.12.2020 mbikëqyrësi i punimeve "A... MK" ShPK me nr. 4927 Prot, regjistrohet në Bashkinë Gramsh, "Njoftim për përfundimin e punimeve".

- Më datë 22.11.2021 është lidhur kontrata nr. 4401 Prot. Për kolaudimin e punimeve në objektin "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh".

- Më datë 25 11.2021 hartohet akti i kolaudimit nga shoqëria "... & ... Construction" ShPK dhe më datë 03.12.2021 nga Komisioni i monitorimit të kontratës hartohet certifikata e marrjes së përkohshme në dorëzim të punimeve, nr. 4582 datë 03.12.2021.

*Fondet për realizimin e objektit dhe mbikëqyrjes së objektit" "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh", janë financuar nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve"(AKUM), para se të fillonin procedurat e prokurimit me kode projekti të veçanta për realizimin e objektit dhe mbikëqyrjes së punimeve. Sa i përket kolaudimit të objektit nga komunikimet me AKUM-in si dhe me shkresën nr. 1309 Prot. datë 15.06.2021 "Mbi kolaudimin e objekteve nga Agjencia Kombëtare e Ujësjellës Kanalizimeve", AKUM-i njofton se do të marrë masat për procesin e kolaudimit të punimeve të objektit, si dhe fondi për realizimin e shërbimit të punimeve në ndërtim do të çelet me kod më vete nga AKUM-i. Për këtë arsye Bashkia Gramsh nuk zhvilloi procedurën e prokurimit me objekt kryerjen e shërbimit të kolaudimit për këtë objekt. Me shkresën nr. 1886 Prot. datë 04.10.2021 AKUM-i udhëzon që kolaudimi i objekteve të realizohet nga vetë Autoritetet Kontraktore. Pas kësaj shkrese, nga ana e Autoritetit Kontraktor, Bashkia Gramsh, u zhvilluan procedurat e prokurimit me objekt "Kolaudimi i punimeve në objektin "Rikonstruksion i rrjetit të brendshëm i ujësjellësit të qytetit Gramsh", dhe pas përfundimit të tyre është lidhur kontrata e kolaudimit nr. 4401 datë 22.11.2021 me kolaudatorin "...& ...*Construksion" ShPK.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjes së zbatimit të objektit si më sipër, konstatohet se punimet kanë përfunduar brenda afatit përfundimtar të kontratës. Bashkëngjitur dokumentacioni i përshkruar më sipër.

Qëndrimi i Audituesve të KLSH:

Grupi i auditimit shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Bashkia Gramsh dhe merr parasysh argumentimet e dhëna duke i reflektuar ato në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së është konstatuar se:

Mjedisi i kontrollit: Në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë nuk është ngritur asnjë komision nga titullari aktual për inventarizimin e dosjeve, procedurave apo praktikave në proces të personelit që është larguar apo marrjen me procesverbal sintetik të dosjeve dhe punës të personelit që kanë filluar ushtrimin e detyrës. Nuk është hartuar ñHarta e procesit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzoreò, nuk ka një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve, përveç trajnimeve që kryhen nga ASPA, si dhe nuk janë kryer trajnime për anëtarët e GMS-së në fushën e Menaxhimit të Riskut, mbi MFK-në për GMS. Burimet Njerëzore kanë një data bazë me emrat e punonjësve dhe trajnimet e kryera për periudhën e auditimit. Në vitin 2021 kanë kryer trajnime 18 punonjës të bashkisë. Nuk ka plan- veprime vjetore për arritjen e objektivave, qëllimeve të politikave afatmesme (PBA) që të përmbajnë veprime, afate dhe persona konkretë përgjegjës për çdo veprim të parashikuar.

Menaxhimi i riskut: Bashkia Gramsh e ka përgatitur po nuk ka miratuar ñStrategjinë e Riskutò për vitin 2021. Nuk janë zhvilluar mbledhje të dokumentuara të Grupit të punës për Menaxhimin Strategjik (GMS) për të diskutuar rreth çështjeve që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 ñPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollinò neni 27, me Udhëzimin nr. 16 datë 20.07.2016 ñPër përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të MFK në Njësitë Publikeò pika 2/2,4.

Aktivet e kontrollit: Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 ñPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 13 dhe si rrjedhojë, nuk ka takime të dokumentuara midis Komitetit të Auditimit dhe drejtuesve të NJAB-sëò.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Gramsh të merren masa për të rritur njohuritë mbi Menaxhimin Financiar dhe të Kontrollit si dhe për zbatimin e të gjithë komponentëve të saj. Burimet njerëzore të kenë një plan afatmesëm ose vjetor të trajnimeve dhe një data bazë me emrat e punonjësve, të ngrihen komisione nga titullari mbi inventarizimin e dosjeve në procesin e largimeve dhe marrjes në detyrë, të miratohet Strategjia e Riskut për vitin 2021, të zhvillohen mbledhje të dokumentuara të GMS-së si dhe të ngrihet Komiteti i Auditimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Njësia e Auditit të Brendshëm nuk mbulon me auditim të gjitha fushat/sistemet e njësisë publike duke mos i dhënë prioritet fushave/sistemeve të përzgjedhura, sipas nivelit të riskut, veprime në kundërshtim me përcaktimet e Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ñPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëmò, Strategjinë e auditimit të brendshëm, bazuar në tre klasifikimet e mëposhtme, duhet të konsiderojë një frekuencë auditimi si vijon:

i - Fusha me risk të lartë ï e këshillueshme një herë në vit;

ii - Fusha me risk të mesëm ï e këshillueshme një herë në dy- tre vite;

iii - Fusha me risk të ulët ï e këshillueshme jo më shumë se pesë vite.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 15-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandim: Njësia e Auditit të Brendshëm të hartojë program pune për auditimin e fushave më me risk në veprimtarinë e institucionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga procesi auditimit u konstatua se në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 80 datë 28.12.2020, òPër miratimin e programit buxhetor për vitin 2021ò është planifikuar fondi rezervë në shumën 2,000,000 lekë. Ky fond është përdorur për ndihma dhe shpërblime ndaj qytetarëve të ndryshëm të Bashkisë Gramsh, të cilët kanë paraqitur kërkesa për ndihmë dhe mbështetje. Përkatësisht gjatë vitit 2021 Këshilli Bashkiak ka miratuar 32 vendime me objekt dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për probleme të ndryshme të cilat arrijnë vlerën totale 2,000,000 lekë. Nga Drejtoria e Financës të Bashkisë Gramsh janë likuiduar gjatë vitit 2021 gjithsej 29 vendime, të miratuara nga Këshilli Bashkiak Gramsh në vlerën totale 1,775,000 lekë. Veprimet e mësipërme të marra nga KB Gramsh janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar neni 6, ligjin nr. 137/2020 datë 16.11.2020 ñPër buxhetin e vitit 2021ò, Aneksi nr. 2, Udhëzimin nr. 4 datë 25.01.2021 ñPër zbatimin e buxhetit të vitit 2021ò, pika 108. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Gramsh nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masat që për çdo kërkesë të paraqitur për ndihmë dhe mbështetje financiare pranë bashkisë, të bëhen verifikimet e duhura dhe të plotësohet dokumentacioni që argumenton nevojën dhe pamundësinë financiare të qytetarëve përpara se dosja të dërgohet për miratim në Këshillin Bashkiak. Drejtoria e Financës të ndërpresë likuidimin e praktikave që nuk kanë dokumentacionin e plotë dhe të duhur, si dhe gjatë përdorimit të fondit rezervë të vlerësojë nevojën reale për përdorimin e tij me qëllim që të mos ketë efekte negative në buxhetin e bashkisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.2 Rekomandim: Këshilli Bashkiak Gramsh të ndërpresë marrjen e vendimeve me efekte financiare në buxhetin e bashkisë në rastet kur kërkesa për ndihmë dhe mbështetje financiare nuk shoqërohet me të gjithë dokumentacionin e duhur. Këshilli Bashkiak përpara marrjes së vendimeve për ndihmë dhe mbështetje financiare ndaj qytetarëve në nevojë, të shqyrtojë me korrektësi dokumentacionin e dosjeve dhe në rastet kur dokumentacioni nuk është i plotë dhe i besueshëm të kthejë praktikat në strukturat përkatëse të bashkisë për plotësim.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua mos realizim në treguesit e buxhetit, veçanërisht për sa i përket të ardhurave vendore, mos realizim i cili ka krijuar detyrime të pa likuiduara të prapambetura ndaj të tretave, duke paraqitur një risk për buxhetin e vitit në vazhdim të njësisë vendore, sepse buxheti i vitit ushtrimor do të përdoret jo për të financuar nevojat reale, por për të likuiduar detyrime të prapambetura për investimet, mallrat e shërbimet, apo dëmshpërblim nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, ku gjendje progresive e detyrimeve në vite është si më poshtë:

-Detyrime për investime, mallra e shërbime në datë 31.12.2021 në vlerë 32,995,914 lekë.

Vlera 32,995,914 lekë është e trashëguar sipas periudhave si në vijim:

-mbartur nga vitet 2010-2015, vlera 10,372,922 lekë,

-krijuar në vitet 2016-2018, vlera 2,139,549 lekë dhe vlera 2,641,476 lekë detyrim nga FZHR

-krijuar gjatë viti 2021, vlera 19,901,314 lekë;

Veprime në mospërputhje me nenin 50, neni 52, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 ñPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, neni 56, ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, pika 62, UMFE nr. 2 datë

06.02.2012 ñPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetitò; UMF nr. 5 datë 27.12.2014 ñPër shlyerjen e detyrimeve të prapambeturaò, UMFE nr. 4 datë 25.01.2021 ñPër buxhetin e vitit 2021ò, pikat 115-125 ñDetyrimet e prapambetura të Njësive të Vetëqeverisjes Vendoreò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
4.1 Rekomandim: Bashkia Gramsh, Drejtoria e Financës, të paraqesë në mbledhjen e këshillit bashkiak, një material mbi gjendjen e faturave të pa likuiduara në vite, të hartojë një grafik duke zbatuar radhën e pagesave për vlerën **32,995,914 lekë**, të analizojë situatën dhe të ndërpresë krijimin e detyrimeve të prapambetura duke nxjerrë përgjegjësitë e të marrë masa për të mos patur angazhime të reja buxhetore pa fonde në dispozicion.

Në mbledhjen me të afërt të Këshillit Bashkiak

5. Gjetje nga auditimi: Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë në Bashkinë Gramsh kryhet në programin Excel. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk kryen regjistrim manual të të dhënave dhe çdo informacion që grumbullon nga njësitë administrative dhe nga vetë strukturat e Bashkisë Gramsh i administron në Excel në mungesë të një sistemi të mirëfilltë për administrimin e taksave dhe tarifave vendore. Administrimi i taksave dhe tarifave vendore është detyrim i ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër Sistemin e Taksave Vendoreò i ndryshuar; neni 4, zbatimi i sistemit tatimor në Republikën e Shqipërisë pika 7, ñ*Pranë çdo bashkie krijohet regjistri i taksave vendore dhe taksapaguesve vendorë*ò. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
5.1 Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa që të ngrejë një sistem për administrimin e taksave dhe tarifave vendore me qëllim automatizimin e procesit, ruajtjen e të dhënave dhe gjenerimin e faturave për taksat dhe tarifat vendore të bashkisë, krijimin e listës së subjekteve sipas njësive administrative, identifikimin e subjekteve debitorë duke llogaritur borxhin, kamatëvonesat etj.

Qershor 2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi krijimin e të ardhurave nga dhënia me qira e aseteve të Bashkisë Gramsh u konstatua se, janë dhënë me qira asete për të cilat nuk janë lidhur kontratat përkatëse në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi. Përkatësisht, janë 8 subjekte/qytetarë që përdorin pasuri të bashkisë pa lidhur një kontratë qiraje, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet e VKM-së nr. 54, datë 5.2.2014 ñPër përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetëroreò, e ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
6.1 Rekomandimi: Sektori Juridik dhe i Aseteve të marrë masa për lidhjen e kontratave të qirasë me subjektet/personat që kanë në përdorim objekte/prona/sipërfaqe në pronësi të Bashkisë Gramsh.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në gjendjen e llog. 468 ñDebitorë të ndryshëmò nuk janë përfshirë gjendja e debitorëve për taksa dhe tarifa vendore familjare në vlerën 15,794,072 lekë, për taksa dhe tarifa e bizneseve në vlerën 18,951,699 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 108,300 lekë, taksat e tokës bujqësore në vlerën 19,339,941 lekë, subjektet që ushtrojnë aktivitet të pajisur me autorizim/ licencë të lëshuar në vlerën 2,000,000 lekë, mos pagesa të kontratave të qirave në vlerën 1,422,665 lekë (nga diferenca midis vitit 2020 në vlerën 6,488,455 lekë (vlerë e kontabilizuar) dhe vitit 2021 progresive 7,911,120 lekë), nga operatorët ekonomik që nuk kanë

paguar detyrimet vendore që lindin ndaj Bashkisë Gramsh për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki në vlerën 2,750,000 lekë në total 60,366,677 lekë të akumuluara në fund të vitit ushtrimor 2021, vlerë e cila nuk është kontabilizuar në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh të mbajë evidencën kontabël për të ardhurat dhe të kryejë veprimet kontabël për evidentimin e debitorëve në llog. 468 ñdebitorë të ndryshëmò, në mënyrë që përfshirja e të ardhurave në pasqyrat financiare të mos bëhet nga jashtë port ë ndjekë logjikën kontabël, duke i pozicionuar saktë në llogaritë përkatëse me qëllim që Pasqyrat Financiare të ofrojnë një informacion të saktë mbi të drejta dhe detyrimet e të tretëve ndaj shtetit për taksa dhe tarifa vendore.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

8. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh, në Qendrën Kombëtare të Biznesit, më 05.01.2021 paraqitet si aksionere me 100% të aksioneve të Ujësjellës Kanalizime SHA Gramsh e cila është shoqëri aksionere me objekt aktiviteti ñShërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm i konsumatorëve dhe shitja e tij. Kjo vlerë e kapitalit me 100% aksione në pjesëmarrje të Bashkisë Gramsh në ñUjësjellës Kanalizime Gramsh SHA, në asnjë rast nuk paraqitet në aktivet afatgjata financiare të Bilancit kontabël 2021, më konkretisht në llogarinë 26 ñPjesëmarrje në kapitalet e vetaò në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 ñPër shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuaraò me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 ñAktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materialeò pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 ñTrajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrjeò. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: Nga Bashkia Gramsh, nëpërmjet Nëpunësit Zbatues, të merren masa për të bërë sistemimet në kontabilitet dhe regjistrimin e pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të ñUjësjellës Kanalizime Gramshò SHA, me vlerë kontabël 178,620,750 lekë në debi të llogarisë 26 ñPjesëmarrje në kapitalin e vetò dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, përveç objekteve të inventarit të pasurive të paluajtshme në vlerën kontabël neto 919,245,713 lekë (vlerë e kontabilizuar), ka objekte të njësive administrative të cilat nuk janë pajisur me titull pronësie dhe nuk janë kontabilizuar, konkretisht për llog. 210 ñToka troje terreneò, llog. 211 ñPyje plantacioneò, llog. 212 ñNdërtesa e konstruksioneò. Për rrjedhojë ka rezultuar se pasuritë e paluajtshme nuk janë kontabilizuar në aktivet afatgjata materiale, me qenë se nuk janë pajisur me një titull pronësie (certifikatë pronësie apo vërtetim hipotekor), në kundërshtim me kërkesat e VKM-së nr. 510, datë 10.06.2015 ñPër miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve, të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo- territorialò, Kreu VI ñTransferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshmeò. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

9.1 Rekomandim: Bashkia Gramsh duhet të marrë masa të menjëhershme, dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ZRPP dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës

të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimit dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Gramsh dhe për Njësitë Administrative. Në kolonën shënime nga komisioni nuk ka vlerësime të aktiveve të veçanta për gjendje jashtë përdorimi. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2021. Nuk është kryer inventarizimi i magazinës së institucionit në bazë të urdhrave të Titullarit për ngritjen e komisionit ñPër kryerjen e procesit të inventarizimitò. Nga komisioni i inventarizimit i ngritur me urdhrin e titullarit nuk është përpiluar një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara nëse ka, dhe së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t'ia dorëzonte për veprime të mëtejshme Nëpunësit Autorizues të institucionit, veprime në kundërshtim me pikën 85/c të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011. Mungon një raport analize, me të dhënat sipas viteve të krijimit të aktivit, apo mallrave e materialeve. Komisioni i inventarizimit nuk ka bërë një vlerë totale me listë të bashkëngjitur, se sa ka gjendje fizike institucioni, për pajisje informatike, për pajisje zyre të ndarë në artikuj, si dhe mjete transporti në dispozicion etj, sipas formatit të regjistrit të aktiveve, i cili hartohet në varësi të llojit të tyre, si dhe grupit përkatës Brenda llojit dhe më pas të bëhej krahasimi i gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të regjistruara në kontabilitet, për të vërtetuar nëse ekzistojnë apo jo diferenca. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 45-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandim: Drejtoria Ekonomike në Bashkinë Gramsh, komisionet e ngarkuara sipas urdhrave të Titullarit, të marrin masa për kryerjen e procesit të inventarizimit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se, raporti përfundimtar i auditimit të fundit dhe rekomandimet janë dërguar në Bashkinë Gramsh me shkresën nr. 867/20 datë 05.01.2022. Nga Bashkia Gramsh kanë filluar të merren disa masa lidhur me zbatimin e rekomandimeve por duhet të merren ende masa të tjera si dhe duhet të bëhet ndjekja intensive e masave të marra, si vijon:

- Janë lidhur 10 kontrata për asetet e dhëna me qira me personat që kishin në përdorim asetet e bashkisë mbeten ende për tû lidhur edhe 5 kontrata qiraje.
- Janë njoftuar për të shlyer detyrimin OE ñZ...ò ShPK me shkresën nr. 324 Prot, datë 26.01.2022 për shumën 1,329,268 lekë dhe OE ñM...ò ShPK, me shkresën nr. 325 Prot, datë 26.01.2022 për shumën 215,538 lekë.
- Janë marrë masa për të paguar detyrimet nga kontratat e qirave, përkatësisht për 22 subjekte me vlerë të detyrimit 6,591,955 lekë kanë paguar detyrime të pjesshme ose të plota 15 subjekte me vlerë totale 597,675 lekë dhe mbeten ende për tû arkëtuar **5,949,280 lekë**.
- Nuk kanë paguar detyrimet në vlerën **61,340 lekë** 3 operatorë ñB...ò ShPK, në vlerën 21,000 lekë, ñZ...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë, dhe ñB...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 61-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masat si dhe të vijoj me ndjekjen e masave që ka marrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH si vijon:
- Të lidhë kontratat e qirasë me personat që kanë në përdorim asetet e bashkisë;
- Të ndjekë të gjitha hapat ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve nga OE ñZ...ò për shumën 1,329,268 lekë dhe OE ñM...ò ShPK, për shumën 215,538 lekë;
- Të marrë masa për të paguar detyrimet nga kontratat e qirave, me vlerë totale **5,949,280 lekë;**
- Të ndjekë të gjitha hapat ligjor për të bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve në vlerën **61,340 lekë** nga operatorët ñB...ò ShPK, në vlerën 21,000 lekë, ñZ...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë, dhe ñB...ò ShPK në vlerën 20,170 lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Bashkia Gramsh ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 867/20, datë 05.01.2022, por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ñPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, neni 50, pika 5. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 61-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandim: Bashkia Gramsh të marrë masa për të kryer raportimin periodik në Këshillin Bashkiak lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfundim të çdo auditimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA - TË ARDHURA TË MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë konstatohet se, për vitin 2021 nuk ka paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë z. Xh. D. në vlerën **108,300 lekë** duke sjellë të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh. Veprim ky në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 95/2018 ñ Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, ñPër sistemin e taksave vendoreò, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 ñ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizimò, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Projekt Raportit të Auditimit).*

1.1 Rekomandim: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për ñTaksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimetò dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga z. Xh. D. në vlerën **108,300 lekë** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Gramsh të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kontratave të qirave rezulton se, 22 qiramarrës nuk kanë zbatuar kushtet e kontratave të qirasë duke mos paguar detyrimin për vitin 2021 në vlerën totale prej **7,911,120 lekë** që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e kushteve të kontratave të qirasë përkatësisht me nenin 3 ñPagesa dhe regjimi i sajò.
(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).
2.1 Rekomandim: Sektori Juridik dhe i Aseteve në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masat dhe të ndjekin të gjitha hapat ligjorë që 22 qiramarrësit që nuk kanë zbatuar kushtet e kontratës së qirasë të paguajë detyrimet përkatëse secili që në vlerën totale janë **7,911,120 lekë.** Gjithashtu, në vijimësi Sektori Juridik dhe i Aseteve të ndjekë me përpikmëri zbatimin e kushteve të kontratave të qirasë me të gjithë qiramarrësit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Detyrimet për taksat dhe tarifat vendore që taksapaguesit kanë ndaj Bashkisë Gramsh në datën 31.12.2021 janë në vlerën **54,085,792 lekë** nga të cilat vlera prej 18,951,699 lekë i përket 62 subjekteve private, vlera prej 15,794,072 lekë i përket kategorisë së taksapaguesve familjarë dhe vlera prej 19,339,941 lekë është detyrimi për taksën e tokës bujqësore, duke sjellë **të ardhura të munguara** në buxhetin e Bashkisë Gramsh.
Në vitin 2021, borxhi tatimor i krijuar është në vlerën totale **16,363,890** lekë, i përbërë nga taksat dhe tarifat e bizneseve në shumën 11,022,712 lekë, taksat dhe tarifat familjare në shumën 2,807,774 lekë dhe taksa e tokës bujqësore në shumën 2,533,404 lekë. Rezulton se, Bashkia Gramsh nuk ka aplikuar masat e duhura ligjore për subjektet që nuk kanë paguar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore, në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ñPër Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisëò i ndryshuar, nenet 89,90,91,93. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1 Rekomandim: Drejtoria e Tatim Taksave Vendore Bashkia Gramsh, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **54,085,792 lekë**, *si më poshtë vijon***:**
a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.
b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).
c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e Tatim Taksave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.
d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Drejtorisë Tatim Taksave dhe Drejtorisë Juridike, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
e- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Gramsh, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Gramsh ushtrojnë aktivitet të pa pajisur me autorizim/licencë për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë 2 subjekte, përkatësisht subjekti ñG...ò

dhe subjekti ñB...ò, në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyreò, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 ñPër disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, ñPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyreò, të ndryshuar, neni 4, neni 15, neni 20-Autorizimet pika 2, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 2,000,000 lekë.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve dhe Sipërmarrjes në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore të marrin masa që subjektet ñG...ò dhe ñB...ò, që ushtrojnë aktivitet në kundërshtim me dispozitat ligjore të pajisen menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit duke paguar vlerën 1,000,000 lekë secili ndaj Bashkisë Gramsh.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Gramsh janë 4 operatorë ekonomik që nuk kanë paguar detyrimet vendore që lindin ndaj bashkisë për periudhën e ushtrimit të aktivitetit në këtë bashki, duke sjellë **të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Gramsh në vlerën 203,500 lekë**. Drejtoria Juridike nuk ka dërguar informacion periodik në DTTV lidhur me operatorët e shpallur fitues në procedurat e prokurimit me qëllim që kjo e fundit të bënte ngarkesën përkatëse të tyre sipas përcaktimeve të paketës fiskale. Mos pagesa e detyrimeve vendore nga operatorët ekonomik është në kundërshtim me përcaktimet e ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ñPër sistemin e taksave vendoreò i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 ñPër procedurat tatimore në republikën e shqipërisëò, i ndryshuar, neni 43 pika 1/1, Udhëzimit të MF nr. 24, datë 02.09.2008 ñPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, i ndryshuar pika 40.1, 43.1.1 dhe VKB nr. 96 datë 30.12.2019 ñPër Miratimin e Paketës Fiskale Vendoreò në Bashkinë Gramsh. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandim: Drejtoria Juridike të njoftojë periodikisht Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore lidhur me operatorët ekonomikë që shpallen fitues në procedurat e prokurimit në Bashkinë Gramsh. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bëjë ngarkesën e të gjitha subjekteve për detyrimet vendore që lindin me lidhjen e kontratës, si dhe të marrë të gjitha masat për pagesën e rregullt të taksave dhe tarifave vendore në përputhje me përcaktimet e paketës fiskale, nga secili operator ekonomik që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Gramsh.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Gramsh për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 ka vendosur 10 masa administrative ñ*Dënim me gjobë*ò, me vlerë totale 3,500,000 lekë. Për gjobat e vendosura në vitin 2021, janë paguar në mënyrë vullnetare 3 gjoba në vlerën totale 600,000 lekë, janë në proces gjyqësor 3 gjoba në vlerën 2,000,000 lekë dhe nuk janë marrë masa për arkëtimin e 4 gjobave në vlerën 900,000 lekë. Rezulton se, për vitin 2021 **të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga IMTV janë **në vlerën totale 2,900,000 lekë.** Përveç gjobave të vendosura gjatë vitit 2021 dhe që nuk janë paguar, IMTV ka edhe gjoba të tjera të vendosura më herët që nuk janë arkëtuar dhe janë në proces gjyqësor. Përkatësisht, janë në proces gjyqësor 4 gjoba me vlerë 610,000 lekë dhe për një gjobë është nënshkruar marrëveshje dhe ende mbetet për tû likuiduar vlera 41,600 lekë. Pra, gjoba të vendosura para vitit 2021 në proces gjyqësor dhe me marrëveshje të pa arkëtuara në total janë në **vlerën 651,600 lekë**. **Të ardhurat e munguara** nga mos arkëtimi i gjobave të vendosura nga

IMTV në progresiv janë **në vlerën totale 3,551,600 lekë.** (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 22-45 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandim: Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrë të gjitha masat ligjore me qëllim arkëtimin e gjobave të vendosura për shkeljet e konstatuara në zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e pa ligjshme për të bërë të mundur arkëtimin e të gjitha gjobave në vlerën **3,551,600 lekë**.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASAT DISIPLINORE

KLSH mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 ñ*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*ò, neni 15 germat b, c dhe ç, ligjin nr. 152/2013 ñ*Për nëpunësin civil*ò, i ndryshuar, neni 59 ñ*Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore*ò, pika 1 dhe pika 4 germa b, VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 ñ*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1996 ñ*Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë*ò, neni 37, ñ*Masa disiplinore*ò, **i rekomandon Kryetarit të Bashkisë Gramsh** tõ kërkojë Komisionit Disiplinor pranë institucionit, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo nëpunës të adresuar dhe të sigurojë marrjen e masave disiplinore përkatëse.

V. ANEKSET

Aneksi nr. 1: Struktura e Bashkisë Gramsh dhe njësive në varësi për vitin 2021

Nr.	Emërtimi	Nr. Punonjësve
1	Kryetari	1
2	Kabineti	3
3	Sekretar i Përgjithshëm	1
4	Sekretar Këshilli Bashkiak	1
5	Audit i Brendshëm	3
6	Sektori për koordinimin e Integrimit Europian, Ndihmës së Huaj dhe Turizmit	2
7	Zyra e Shërbimit me një ndalesë	1
8	Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit	2
9	Drejtoria e të ardhurave, zhvillimit ekonomik dhe menaxhimit financiar	19
10	Drejtoria e shërbimeve me sipërmarrje, transporteve, strehim dhe emergjencave civile	4
11	Drejtoria e planifikim, zhvillim territori, burimeve natyrore	47
12	Drejtoria e infrastrukturës rrugore	37
13	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	8
14	Policia Bashkiake	6
15	Drejtoria e arsimit, kulturës dhe sportit	147
16	Drejtoria juridike	3
17	Gjendja civile	2
18	Sporteli I QKB Gramsh	2
19	Sektori i shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi	14
20	Drejtoria e shërbimit pyjor, bujqësisë, mbrojtjes së konsumatorit	18
21	Njësia Administrative Pishaj	5
22	Njësia Administrative Kodovjat	5
23	Njësia Administrative Porocan	4
24	Njësia Administrative Sult	4
25	Njësia Administrative Skenderbegas	4
26	Njësia Administrative Lenie	4
27	Njësia Administrative Tunje	5
28	Njësia Administrative Kukur	5
29	Njësia Administrative Kushove	4
	Totali	**361**

Aneksi nr. 2: Pasqyra e realizimit të treguesve të zërave të buxhetit për viti 2021 000/lekë

Nr.	E M E R T I M I	Viti 2021		
		Plani Vjetor (me ndryshime)	Fakti progresiv viti 2021	%
1	Llog.(600)-Paga	212,715	203,224	96%
2	Llog.(601)-Sig.shoq.Shënd	36,704	33,938	92%
3	Llog.(602)Shpenz.opera	140,029	124,722	89%
4	Llog.(230-231) Investime	266,616	174,815	66%
5	Llog.(604)	15,444	1,660	11%
6	Llog.(606)	2,683	2,652	99%
7	Llog.(609)	375	0	0%
8	Llog.(600) funk.deleguara	7,622	7,229	95%
9	Llog.(601) funk.deleguara	937	936	100%
10	Llog.(602) funk.deleguara	216	208	96%
11	Llog.(604) funk.deleguara	10,567	10,274	97%
12	Llog.(606) bonus strehimi	2,346	2,346	100%
13	Llog.(606) ndihmë e bursa pa	466,535	454,883	98%
14	Llog.(231) Investime	138,984	134,318	97%
15	Llog 466 takse pulle	0	1,699	
16	Llog 466 garanci obj të dala	0	4,830	100%
	Totali	**1,301,773**	**1,157,734**	89%

Shënim: Të dhënat janë të disponuar nga Drejtoria e Financës me programimet buxhetore

Aneksi nr. 3: Lista e VKB-ve për dhënie shpërblimi nga fondi rezervë dhe likuidimet e bëra nga Drejtoria e Financës

Nr.	Vendimi i Këshillit Bashkiak	Shuma	Likuidimi	Komente
1	VKB nr. 24 datë 02.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për dëmtimin e banesës nga rrëshqitja e tokësñ konfirmuar akti më datë 19.04.2021 nr.prot. 508/1	100,000	USH nr. 956 datë 14.05.2021	Ka kërkesë, ka studim gjeologjik, shpallur e pabanueshme. Nuk ka relacion shpjegues.
2	VKB nr. 25 datë 02.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve për kurimin me terapi intensiveò konfirmuar akti më datë 19.04.2021 nr.prot. 509/1	100,000	USH nr. 956 datë 14.05.2021	Ka kërkesë, ka analiza, nuk ka relacion.
3	VKB nr. 26 datë 02.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve për kurimin me terapi intensiveò konfirmuar akti më datë 19.04.2021 nr.prot. 510/1	50,000	USH nr. 956 datë 14.05.2021	Ka kërkesë, ka analiza, nuk ka relacion.
4	VKB nr. 27 datë 02.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve për mjekim si pasojë e ndërhyrjes së tre operacioneveò konfirmuar akti më datë 19.04.2021 nr.prot. 511/1	50,000	USH nr. 956 datë 14.05.2021	Ka kërkesë, ka analiza, nuk ka relacion.
5	VKB nr. 28 datë 02.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve për kryerjen e një operacioniò konfirmuar akti më datë 19.04.2021 nr.prot. 512/1	50,000	USH nr. 956 datë 14.05.2021	Ka kërkesë dhe vërtetim që trajtohet me PAK. Nuk ka relacion, nuk ka asnjë dokument tjetër që të provojë ndërhyrjen kirurgjikale për të cilën kërkon ndihmë financiare.
6	VKB nr. 29 datë 02.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për trajtimin me fizioterapi të fëmijës K. H.ò konfirmuar akti më datë 19.04.2021 nr.prot. 513/1.	50,000	USH nr. 956 datë 14.05.2021	Ka kërkesë, ka analiza, nuk ka relacion.
7	VKB nr. 30 datë 02.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për përballimin e shpenzimeve të mjekimeve (4 diagnoza)ò konfirmuar akti më datë 19.04.2021 nr.prot. 514/1.	50,000	USH nr. 956 datë 14.05.2021	Ka kërkesë, ka analiza, nuk ka relacion.
8	VKB nr. 60 datë 30.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për trajtimin me mjekim (të nënës)ò konfirmuar akti më datë 10.05.2021 nr.prot. 595/1.	50,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka vetëm kërkesë. Nuk ka relacion dhe nuk ka asnjë dokumentacion justifikues për kërkesën që ka paraqitur.
9	VKB nr. 61 datë 30.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për trajtimin me mjekim (të nënës)ò konfirmuar akti më datë 10.05.2021 nr.prot. 596/1.	50,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka vetëm kërkesë. Nuk ka relacion dhe nuk ka asnjë dokumentacion justifikues për kërkesën që ka paraqitur.
10	VKB nr. 62 datë 30.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për trajtimin me terapi intensiveò konfirmuar akti më datë 10.05.2021 nr.prot. 597/1.	50,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka kërkesë dhe ka dokumentacion justifikues. Nuk ka relacion.
11	VKB nr. 63 datë 30.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për trajtimin me mjekimò konfirmuar akti më datë 10.05.2021 nr.prot. 598/1.	50,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka kërkesë dhe ka dokumentacion justifikues. Nuk ka relacion.
12	VKB nr. 64 datë 30.04.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për trajtimin me terapi intensiveò konfirmuar akti më datë 10.05.2021 nr.prot. 599/1	50,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka kërkesë dhe ka dokumentacion justifikues. Nuk ka relacion.
13	VKB nr. 69 datë 28.05.2021 ñPër dhënie shpërblim për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerit O. B. Sh.ò konfirmuar akti më datë 01.06.2021 nr.prot. 708/1.	50,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, ka relacion.
14	VKB nr. 70 datë 28.05.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për trajtimin me mjekim ò konfirmuar akti më datë 17.06.2021 nr.prot. 707/1.	25,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, nuk ka relacion.
15	VKB nr. 71 datë 28.05.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për trajtimin me mjekim (të vajzës)ò konfirmuar akti më datë 17.06.2021 nr.prot. 706/1.	25,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, nuk ka relacion.
16	VKB nr. 72 datë 28.05.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për rimëkëmbje pas djegies së biznesit privatò konfirmuar akti më datë 0106.2021 nr.prot. 705/1.	200,000	USH nr. 1392 datë 13.07.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, ka vërtetim për rënie zjarri, nuk ka relacion, nuk ka aktin e ekspertimit të zjarrit.
17	VKB nr. 79 datë 29.06.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për dëmshpërblim për	200,000	USH nr. 1606 datë 05.08.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues,

	ndërhyrje kirurgjikaleò konfirmuar akti më datë 14.07.2021 nr.prot. 819/1			nuk ka relacion.
18	VKB nr. 80 datë 29.06.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezerve për mobilimin me orendi jetike shtëpinë e z. R. Sh. i fshatit Kushove me kerkese te znj.F. A. (përfaqësuese e motrave vicenciane)ò konfirmuar akti më datë 14.07.2021 nr.prot. 818/1	100,000		Ka vetëm kërkesë.
19	VKB nr. 96 datë 26.07.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Z. V. D. për mbështetje financiareò konfirmuar akti më datë 03.08.2021 nr.prot. 907/1	25,000	USH nr. 1999 datë 11.10.2021	Ka kërkesë, nuk ka dokumentacion justifikues, nuk ka relacion.
20	VKB nr. 100 datë 31.08.2021 ñPër dhënie shpërblimi për përballimin e shpenzimeve të varrimit të të ndjerës F. D. S.ò konfirmuar akti më datë 10.09.2021 nr.prot. 1028/1	50,000	USH nr. 2194 datë 09.11.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, ka relacion.
21	VKB nr. 102 datë 31.08.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Zj.F. K. për mbështetje financiare për shpenzimet e varrimit të bashkëshortitò konfirmuar akti më datë 10.09.2021 nr.prot. 1030/1	50,000	USH nr. 2194 datë 09.11.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues të pjesshëm, nuk ka vërtetim që trajtohet me ndihmë ekonomike, nuk ka relacion.
22	VKB nr. 104 datë 30.09.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Znj. V. P. për mbështetje financiare për shpenzimet e varrimit të motrësò konfirmuar akti më datë 13.10.2021 nr.prot. 1136/1	50,000	USH nr. 2194 datë 09.11.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues të pjesshëm, nuk ka vërtetim që trajtohet me PAK, nuk ka relacion.
23	VKB nr. 105 datë 30.09.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Znj. D. B. për kurim me terapi intensive të bashkëshortitò konfirmuar akti më datë 13.10.2021 nr.prot. 1135/1	50,000	USH nr. 2194 datë 09.11.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, nuk ka relacion.
24	VKB nr. 106 datë 30.09.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Z.K. Q. për kurim me terapi intensiveò konfirmuar akti më datë 13.10.2021 nr.prot. 1134/1	50,000	USH nr. 2194 datë 09.11.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, nuk ka relacion.
25	VKB nr. 107 datë 30.09.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Znj. B. F. për mbështetje financiare për kryerjen e një operacioniò konfirmuar akti më datë 13.10.2021 nr.prot. 1133/1	50,000	USH nr. 2194 datë 09.11.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, nuk ka relacion.
26	VKB nr. 112 datë 25.10.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Znj.B.Xh. për mbështetje financiare për trajtimin me mjekim dhe një ndërhyrje në syò konfirmuar akti më datë 12.11.2021 nr.prot. 1222/1	50,000	USH nr. 303 datë 05.04.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, nuk ka relacion.
27	VKB nr. 113 datë 25.102021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezerve për znj.R. K. për mbështetje financiare për trajtimin me mjekim të sëmundjeve shoqërueseò, konfirmuar akti më datë 12.11.2021 nr.prot. 1221/1	25,000		Ka kërkesë dhe një vërtetim mjeksor, nuk ka relacion.
28	VKB nr. 119 datë 26.11.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Z.V. Xh. për mbështetje financiare për shpenzimet e varrimit të djalit të tijò konfirmuar akti më datë 14.12.2021 nr.prot. 1316/1	50,000	USH nr. 203 datë 09.03.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues të pjesshëm, nuk ka vërtetim që trajtohet me ndihmë ekonomike, nuk ka relacion.
29	VKB nr. 120 datë 26.11.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Znj.M. B. për mbështetje financiare për kurim me mjekimò konfirmuar akti më datë 14.12.2021 nr.prot. 1317/1	50,000	USH nr. 203 datë 09.03.2021	Ka kërkesë dhe një vërtetim mjeksor, nuk ka relacion.
30	VKB nr. 122 datë 26.11.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Znj.N. Zh. për mbështetje financiare për shpenzimet e varrimit të nënës së sajò konfirmuar akti më datë 14.12.2021 nr.prot. 1319/1	50,000	USH nr. 332 datë 11.04.2021	Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues të pjesshëm, nuk ka relacion.
31	VKB nr. 123 datë 26.11.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezervë për Z.B. O. për mbështetje financiare për gjendjen e vështirë ekonomikeò konfirmuar akti më datë 14.12.2021 nr.prot. 1320/1	50,000	USH nr. 203 datë 09.03.2021	Ka kërkesë, dhe vetëm një vërtetim Administratori i Njësisë, nuk ka relacion.
32	VKB nr. 137 datë 29.12.2021 ñPër dhënie shpërblimi nga fondi rezerve për znj.R. M. për mbështetje financiare për gjendjen e vështirë ekonomikeò, konfirmuar akti më datë 14.01.2022 nr.prot. 30/1	100,000		Ka kërkesë, ka dokumentacion justifikues, nuk ka relacion.
	SHUMA (në lekë)	**2,000,000**	**1.775.000**	

Burimi: Bashkia Gramsh, përpunoi Grupi i Auditimit

Aneksi nr. 4: Faturat e pa likuiduara gjendje në datën 31.12.2021 "Për Investimet"

Nr.	Emërtimi i Objektit	Emërtimi i Subjektit	Kontrate	Fatura e shitjes		Vlera e kredise (detyrimit) ne 31.12.2020	Shtesat gjate periudhes 2021	Shlyerjet gjatë periudhes 2021	Vlera e detyrimit deri me 31.12.2021
				Nr, date	Nr, serial				
1	KUZ CEKIN (Detyrim nga FZHR)	.....	Ska	66 date 26.01.2015	18127081	2,641,476			2,641,476
2	Projek sistemim asfaltim rruga N.Zhupani	.....	Ska	149 date 07.12.2010	42912649	128,000			128,000
3	Suprevizim	.....	Ska	100 date 07.10.2011	85287413	13,800			13,800
4	Supervizim	.....	Ska	23 date 11.06.2015	14604173	10,000			10,000
5	Supervizim	.....	Ska	11 date 11.06.2015	5619492	10,000			10,000
6	Supervizim objektesh	.....	Ska	24 date 30.04.2014	85287428	240,000			240,000
7	Mbikqyrje punimesh ne objektin rikonstruksion i rrjetit te brendshem te ujesjellesit	.....	6342 date 10.10.2019	33 date 03.12.2019	80532133	475,454			475,454
8	Ujesjellesi i qytetit	.....	6093 date 01.10.2019	33 date 12.11.2020	82950745	259,572		259572	0
9	Mbikëqyrje "KUZ Llapushaj"	.....	2643 date 20.07.2020	40 date 31.12.2020	74709642		132000	132000	0
10	Mbikëqyrje "Varrezat e qytetit"	.....	2644 date 20.07.2020	36 date 28.12.2020	74709637		256504	256504	0
11	Kolaudim "Varrezat e qytetit "	.....	3999 date 19.10.2020	27 dt 29.12.2020	82402282		20574	20574	0
12	Blerje soba zjarri	.....	Ska	305/2021 date 06.12.2021	fiskalizim		576000		576,000
13	"Sistemim -Asfaltim ish Reparti Ushtarak"	.....	1931 date 28.05.2021	137/2021 date 29.10.2021	fiskalizim		17623060		17,623,060
14	"Studim projektim fshati Pishaj "	.....	4466 date 24.11.2021	37/2021 date 17.12.2021	fiskalizim		825000		825,000
	SHUMA					**3,778,302**	**19,433,138**	**668,650**	**22,542,790**

Gjithsej 14 fatura të pa likuiduara për investime në shumën 3,778,302 lekë nga të cilat 3,043,276 lekë janë detyrime e fatura të pa likuiduara që i përkasin periudhës 2010-2015 (ku vlen të theksojmë se një faturë në shumën 2,641,476 lekë është detyrim nga FZHR) dhe 735,026 lekë detyrime të raportuara në periudhën 2016-2020 dhe detyrime të reja për vitin 2021 në shumën 19,433,138 lekë. Janë likuiduar deri më 31.12.2021 detyrime në shumën 668,650 lekë. Janë likuiduar deri më 31.03.2022 detyrime në shumën 18,448,060 lekë. Shuma totale e mbetur për likuidim nga faturat për investime deri më 31.03.2022 është 4,094,730 lekë ku siç u përmend më sipër 2,641,476 lekë nga kjo shumë është detyrim nga FZHR.

Aneksi nr. 5: Fatura pa likuiduara gjendje në datë 31.12.2021 "Për mallra e shërbime":

Nr.	Emërtimi i Objektit	Emërtimi i Subjektit	Kontrate	Fatura e shitjes		Vlera e kredise (detyrimit) ne 31.12.2020	Shtesat gjate periudhes 2021	Shlyerjet gjatë periudhes 2021	Vlera e detyrimit deri me 31.12.2021
				Nr, date	Nr, serial				
1	Sherbim Noterie	.....	Ska	52 date 02.12.2010	84206052	4,000			4,000
2	Sherbim Noterie	.....	Ska	32 date 31.03.2011	84206095	600			600
3	Sherbim Noterie	.....	Ska	221 date 09.07.2012	3278285	5,000		5000	0
4	Larje automjetesh	.....	Ska	25 date 28.06.2011	2110725	2100			2,100
5	Siguracione Kasko	.....	Ska	180 date 15.09.2010	360404	44,400			44,400
6	Siguracion automjeti	.....	Ska	174 date 23.06.2010	352068	14,600			14,600
7	Siguracion automjeti	.....	Ska	173 date 22.06.2010	352067	14,600			14,600
8	Siguracion automjeti	.....	Ska	52 date 20.06.2011	70664851	28800			28,800
9	Siguracion automjeti	.....	Ska	217 date 28.03.2011	383591	15,500			15,500
10	Siguracion automjeti	.....	Ska	223 date 18.06.2011	383597	11100			11,100
11	Siguracjon automjeti	.....	Ska	114 date 17.03.2015	1539154	24,660			24,660
12	Kalendar per Zyrat	.....	Ska	18 date 07.01.2011	3367187	145000			145,000
13	Koktel	.....	Ska	1 date 07.01.2011	2161	25,000			25,000

14	Metrazhe	.....	Ska	1 date 07.01.2011	6849	13080		13080	0
15	Kancelari	.....	Ska	6 date 26.08.2011	2122	96,000		96000	0
16	Kancelari	.....	Ska	73 date 22.07.2015	2370	14675		14675	0
17	Kancelari	.....	Ska	46 date 29.12.2012	3953	29,250		29250	0
18	Kancelari	.....	Ska	41 date 28.11.2012	3948	22370		22370	0
19	Kancelari	.....	Ska	40 date 28.11.2012	3946	16,680		16680	0
20	Kancelari	.....	Ska	39 date 28.12.2012	3945	4700		4700	0
21	Kancelari	.....	Ska	36 dhe 36/1 date 30.08.2012	3941	46,475		46475	0
22	Kancelari	.....	Ska	33 dhe 33/1 date 10.08.2012	3937	107325		107325	0
23	Kancelari	.....	Ska	34 date 10.08.2012	3938	118,590			118,590
24	Sherbim Automjeti	.....	Ska	25.07.2011	7131	4000			4,000
25	Materiale elektrike	.....	Ska	239 date 15.10.2013	6813	9200			9,200
26	Materiale hidraulike	.....	Ska	258 date 15.01.2014	6834	9,850			9,850
27	Materiale ndertimi	.....	Ska	238 date 02.10.2013	6812	9950			9,950
28	Transport kimikatesh	.....	Ska	7 date 15.02.2013	5318122	120,000			120,000
29	Sherbime	.....	Ska	4 date 19.01.2012	88054120	1200			1,200
30	Gaz per gatim	.....	Ska	1891 date 15.07.2013	3491891	39,100			39,100
31	Gaz per gatim	.....	Ska	1308 date 01.11.2013	3491328	29700			29,700
32	Karburante	.....	Ska	1877 date 17.05.2013	3491877	66,600		66600	0
33	Karburante	.....	Ska	9732 date 10.03.2015	15329732	63360			63,360
34	Gaz per gatim	.....	Ska	9034 date 15.06.2015	21369034	38,400			38,400
35	Ekspert i jashtem pastrim/gjelb/dekor	.....	Ska	219 date 21.05.2015	19106065	96000			96,000
36	Sherbim dhe Mirmbajtje Varrezave	.....	nr 1617/4 date 20.08.2012	3 date 31.03.2013	6350120	70,480		70480	0
37	Sherbim dhe Mirmbajtje Varrezave	.....	nr 1617/4 date 20.08.2012	3 date 30.11.2012	6350114	61930		61930	0
38	Sherbim dhe Mirmbajtje Varrezave	.....	nr 1617/4 date 20.08.2012	1 date 31.01.2013	6350117	61,930		61930	0
39	Sherbim dhe Mirmbajtje Varrezave	.....	nr 1617/4 date 20.08.2012	2 date 28.02.2013	6350119	61930		61930	0
40	Sherbim dhe Mirmbajtje Varrezave	.....	nr 1617/4 date 20.08.2012	4 date 31.12.2012	6350115	78,190		78190	0
41	Sherbim dhe Mirmbajtje Varrezave	.....	nr 1617/4 date 20.08.2012	4 date 30.04.2013	6350121	61930		61930	0
42	Shtypshkrime	.....	Ska	24 date 18.03.2012	6754	14,080		14080	0
43	Kancelari	.....	Ska	42 date 10.05.2012	6772	23400			23,400
44	Blerje basem	.....	Ska	49 date 28.05.2012	1804888	2,600			2,600
45	Blerje basem	.....	Ska	47 date 11.04.2012	1804885	2450			2,450
46	Pajisje per ngrohje	.....	Ska	1 date 02.12.2012	10629	4,000			4,000
47	Kancelari	.....	Ska	47 date 25.12.2012	2650	18960		18960	0
48	Kancelari	.....	Ska	47 date 22.12.2012	1503	6,050		6050	0

49	Kancelari	.....	Ska	11 date 27.02.2014	2402	7973			7,973
50	Pako ushqimore	.....	Ska	13 date 05.05.2014	2409	100,100			100,100
51	Materiale pastrimi	.....	Ska	50 date 28.11.2012	1506	4650			4,650
52	Buk per kopsht - çerdhe	.....	Ska	28 date 02.02.2015	18217664	9,468		9468	0
53	Buk per kopsht - çerdhe	.....	Ska	84 date 31.03.2015	20329520	6154		6154	0
54	Buk per kopsht - çerdhe	.....	Ska	47 date 28.02.2015	18217683	9,665		9665	0
55	Ilaçe per Klubin e Sportit	.....	Ska	210 dt.01.08.2012	775514	15150			15,150
56	Ilaçe per Klubin e Sportit	.....	Ska	211 date 01.08.2012	775515	21,457			21,457
57	Ilaçe per Klubin e Sportit	.....	Ska	212 date 01.08.2012	775516	64811			64,811
58	Ilaçe per Klubin e Sportit	.....	Ska	224 date 30.09.2012	775528	13,600			13,600
59	Siguracion automjeti	.....	Ska	2335 date 24.07.2013	602360	24608			24,608
60	Sherbim ekspert i jashtem	.....	Ska	14 date 16.06.2015	7576964	80,510			80,510
61	Format Bilanci	.....	Ska	2 date 24.01.2013	5557	3840			3,840
62	Materiale Ndertimi	.....	Ska	39 date 19.02.2013	474302	11,700			11,700
63	Materiale Ndertimi	.....	Ska	91 date 11.04.2013	474354	12021			12,021
